

## PROF. DR. MIMOZA HAFIZI:

Përmes romaneve të mi  
fantastikoshkencorë transmetoj  
dijen dhe si personazhe kam  
lëvruesit e dijes

Bisedoi Andreas Dushi



## SHËNIME MBI LIBRAT

DRITARJA E HAPUR  
E JETËS DHE POEZISË SË  
VLLASOVA MUSTËS

Nga Enver Kushi (fq. 5)

(16.01.1947 - 01.12.2020) në një "FAQE LIBRI"...  
e në një "SHENJËZIME"

KONTRIBUTET E  
HASAN HASANIT

Nga Xhahid Bushati (fq. 6)

Primo Shllaku, "Pesha e padurueshme e pafajësisë"

NË KËRKIM  
TË NJË TJETËR LIRIE

Nga Vlora Ademi (fq. 8)

Mira Meksi, "Parisi vret"

MIDIS TË VËRTETËS  
HISTORIKE DHE TË  
VËRTETËS LETRARE

Nga Josif Papagjoni (fq. 10)

Poezia e Sadik Bejkos

LEXIMI I POEZISË  
"LETËR HAMURABIT"  
SI MONOLOG DRAMATIK

Nga Alisa Velaj (fq. 14)

Libri "Arsimi në demokracinë e brishtë" i Bardhyl Musait

NJË LIBËR I ÇMUAR PËR  
EDUKIMIN DHE ARSIMIN

Prof. dr. Enver Bytyçi (fq. 15)

Rilexim "Rikardi, nuk kam asnjë peng"

ME RIKARDIN  
PËRMES LIBRIT

Nga Enver S. Morina (fq. 12)



Akademiku 90-vjeçar Ali Aliu  
që na nderon mes nesh

I PANGJASHËM  
MES TË NGJASHMËVE

Nga Zija Çela

Në veprën e Ali Aliut gjenden referenca, por zakonisht të natyrës pohuese, mbështetëse dhe informuese. Duke mënjanuar frymën e debatit dhe të polemikës, ai përqendrohet sidomos në faktorët e tij të analizës, në thellimin e argumenteve dhe depërtimin shpesh kapilar. Si fryt i punës së Ali Aliut, ndër të tjera, në librin voluminoz "Don Kishoti shqiptar", që sapo është ribotuar i plotësuar, sot kemi një tablo plot ngjyra mbi krijimtarinë e disa prej poetëve e prozatorëve më të spikatur bashkëkohorë. (fq. 4)

Përkthyer nga Anna Kove  
dhe botuar nga "Aleph"

Peter Stamm vjen në Tiranë  
me dy romane "Agnesa" dhe  
"Shpërfillja e ëmbël e botës"

Autori vjen në Tiranë për lexuesin shqiptar ditën e  
hënë, më 08 prill, ora 18:30, në Qendrën Kombëtare  
të Librit dhe Leximit. (fq. 18)

JEHONAT  
E PËRJETËSISË:  
Zbulimi i magjisë në romanin  
"Shihemi në gusht"

Nga Manuel Marino  
Përktheu David Hudhri



## BIBLIOTEKË

Jani Malo (fq. 17)

Miza në kabinën time

Ndue Ukaj (fq. 16)

Si ftohen stinët

Doruntinë Ramadani (fq. 13)

Tre skica

Shazim Mehmeti (fq. 11)

Dhjetë proza të shkurtra

Fernando Pessoa (fq. 20)

Dashnori kundrues

përktheu nga origjinali Gazmend Bërlajoli

Arben Meksi (fq. 9)

Karikatura e të shtunës

## LETËRSIA SHQIPE NË BOTË

Nga kritika gjermane për  
romanin e Stefan Çapalikut  
"Mbyllur për pushime"

nga Marko Martin (fq. 15)

Romani "Perëndia mbrapsht dhe e dashura"  
i Visar Zhitit, në rumanisht

Tragedia e thekshme që dëgjimi  
nuk e percepton

Nga Adrian Lesenciuc (fq. 21)



**A.D.:** Pas një karriere të gjatë akademike e cila vijon akoma në fushën e astrofizikës, vendosët që një pjesë të përvojës tuaj ta shprehni nëpërmjet letërsisë. Kjo, për mua që ju njeh prej disa vitesh, kohë kur mbanit veshur petkun e politikanes, ishte befasi e po njëlloj, edhe për të tjerët, besoj. Cila qe shtysa e parë që ju nxiti ta ndërmerri këtë iniciativë?

**M.F.:** Është e këndshme të vërej se pyetja juaj ka përfshirë brenda vetes edhe fjalën kyç të përgjigjes sime: politikën. Mund t'ju konfirmoj se romani im i parë e ka shtruar rrugën e vet përmes turbullirave të një zhgënjimi politik, i cili arriti kulmin kur pashë të më shembej para syve partia ime politike me emrin Libra. I kisha falur energji të pakursyera për ta krijuar. Por, gjithë ajo ëndërr, gjithë ajo shpresë që mblodhi rreth vetes me qindra njerëz të rinj e që fitoi në pak kohë besimin e disa dhjetë mijë shqiptarëve, ra nën peshën e rëndë të realitetit tonë politik, ku hileja dhe intriga janë shndërruar në norma funksionimi.

Goditja e kësaj ngjarjeje më tronditi, më mbushi me hidhërim, me zemëratë e me gjithfarë emocione të këtij lloji, që duhej medoemos t'i shkarkoja diku. Sigurisht jo përmes inatit, urrejtjes e mllëfit. Duhej të kryeja një akt pozitiv.

Asokohe, më shumë se kurdoherë, faqet e revistave shkencore nuk reshtnin nga lajmet mbi zbulimin e planeteve të reja jashtë sistemit diellor, që ndryshe quhen dhe ekzoplanete. Këto objekte aq të vështira për t'u gjetur dhe aq të kërkuara prej nesh, po shfaqeshin përherë e më interesante. I tillë qe dhe Proxima b, ekzoplaneti më pranë nesh në të gjithë galaksinë. Duhej që ishte shumë afër mundësive për të zhvilluar jetë.

Edhe media shqiptare po tërhoqej nga këto lajme. Herë pas here më ftonin në emisionet e tyre për të shpjeguar.

- Në Proxima b mund të mos ketë natë. - Ky qe mendimi i parë që më erdhi në ato ditë trishtimi. - Nuk ka natë as në shumë planete që gravitojnë rreth disa yjeve të tjera, në ato planete që duke u sjellë rrotull, e kanë arritur ekuilibrin e duhur për t'i kthyer yllit të tyre gjithë kohën të njetën faqe. Ashtu si Hëna na kthen në vetëm një rreth të saj. Kjo do të thotë se në gjysmën e sipërfaqes së këtyre planeteve nuk ka natë. Ka vetëm ditë.

Dita dhe nata! Në jetën time politike kisha arritur të njoh edhe karaktere njerëzore të zinj si nata-ky është krahasimi në fjalorin popullor.

- Po si mund të jetë një qenie e lindur në një qytet pa natë? - qe mendimi i dytë që më pushtoi tërësisht.

Pikërisht ky mendim arriti të mbidhte rreth vetes shumë energji të shpirtit së trazuar e t'i derdhte në fjalë, fjali, paragrafë e kapituj që mëtuam të shprehim më të bukurën e asaj çka njeriu ka zbuluar në këtë fushë të kërkimit shkencor. Këto energji u trupëzuan në personazhe që punojnë për të kuptuar Tokën, qiellin, Universin.

Përmes atyre planeteve të largëta e të larmishme që mendja njerëzore ka arritur t'i kuptojë, unë bashkë me personazhet e mia do të meditoja edhe për gjurmët që dita dhe nata tokësore, e nxehta dhe e ftohta, acari dhe përvëlimi, errësira dhe drita kanë lënë mbi njerëzit dhe karakteret e tyre.

Kështu lindi 'Pika Trëndafil', romani im i parë, i cili më bëri të jem dhe autorja e romanit të parë shkencor në gjuhën shqipe. Ai iu dedikua zbulimit të planeteve jashtë sistemit diellor. Mbante emrin e Proxima b - Pika Trëndafil në stilin letrar.

Vala e dhimbjes kishte kaluar bashkë me daljen e tij në dritë.

**A.D.:** Më së pari, ju keni një angazhim akademik. Së dyti, sikundër e ceka fare pak më lart, dhatë një kontribut si politikane. Tani shkruani dhe dijet akademike i paraqisni në mënyrë të thjeshtuar për të gjithë, por sigurisht më tepër për të rinjtë

# MIMOZA HAFIZI

## Përmes romaneve të mi fantastiko- shkencorë transmetoj dijen dhe si personazhe kam lëvruesit e dijes

*Bisedoi Andreas Dushi*

e fëmijët. Te cila prej këtyre tri lamieve të ndryshme nga njëra-tjetra ndiheni më mirë?

Aktualisht ndihem më mirë me të tretën, letërsinë shkencore, se është më e reja për mua dhe ende jo krejt e eksploruar. Gjithashtu, në këtë fazë të jetës sime dhe të botës ku po jetojmë, letërsinë shkencore e përfshij edhe si angazhimin tim më të dobishëm. Sepse në epokën e informacionit që qarkullon brenda sekondës e pa asnjë barrierë, e vërteta dhe e gënjeshtër shfaqen kaq pranë, sa njerëzit e kanë përditë e më të vështirë t'i shquajnë nga njëra-tjetra. E kam fjalën për të vërtetën shkencore, e cila mbi gjithçka tjetër i përfaqëson së vërtetës absolute. Në këto kushte, e ndiej si detyrë, si mision, që këtë të vërtetë t'ia ofroj të tjerëve me aq sa mundem e me aq sa kam kompetencë. Dhe fantazia letrare më duket

si rruga më tërheqëse për këtë komunikim. Shkenca e thjeshtëzuar e ka mundësinë të shkojë pa vështirësi te grupe më të mëdha njerëzish, mjafton që ata të jenë kureshtarë e të interesuar.

**A.D.:** Në vijim të arsytimit tuaj, për astrofizikën dhe shkencat ekzakto në përgjithësi, një problematikë shumë e madhe është njësimi i kuriozitetit me dijen. Kështu, shpesh, një libër me kuriozitetet trajtohet me po atë seriozitet si të ketë të njëjtën peshë me një libër që teçon dije të përnjëmendtë. Sa mendoni se kontribuon letërsia shkencore për fëmijë dhe të rinj në qartësimin e këtij dallimi thelbësor dhe orientimin e lexuesit nga dija, jo kuriozitetet?


**M.F.:** Kureshtja është një nga prirjet themelore të njeriut, ajo është shtysa e parë



që e çon njeriun drejt studimit të natyrës e drejt zbulimeve të vogla e të mëdha. Por, sigurisht që ajo nuk mjafton. Njeriu, kërkuesi shkencor, duhet të shpenzojë shumë energji e të punojë paqëndruesisht që kureshtjen ta kthejë në dije. Natyra nuk i fal sekretet e saj. Ajo ia dorëzon vetëm atyre që i meritojnë, që u përkushtohen, që i besojnë dhe i respektojnë. Në këtë marrëdhënie mes kureshtjes dhe dijes, letërsia shkencore për fëmijë e të rritur mund të shihet si një lidhje ndërmjetese. Ajo i shpie njerëzit tek e panjohura në një mënyrë të tillë që ta ndiejnë e të kenë dëshirë ta kuptojnë.

Letërsia shkencore na ka munguar në Shqipëri. Shpresoj të fillojë të shkruhet edhe nga specialistë të fushave të tjera, ndonëse e di se sa e vështirë është për t'u zhvilluar. Më besoni se është pafundësisht më e thjeshtë të shprehësh një rezultat shkencor përmes formulave matematike, sesa përmes metaforave, epiteteve, krahasimeve, e mjeteve të tjera letrare. Por, ia vlen ta bësh këtë përpjekje, që të tjerët ta kenë të mundur t'i kapin pa u lodhur ato që konsiderohen dije të vështira.

**A.D.:** Planeti tokë ngërthen brenda vetes mjaft mistere, aq më tepër në raport me pafundësinë e universit. Ky fakt i bën të gjithë kureshtarë të dijnë më shumë, por sidomos fëmijët që kërkojnë të njohin





përherë e më tepër, duke sfiduar shpesh edhe të rriturit. Romani juaj Duke pritur Supernovën, është një burim informacioni real për to, vendosur në sfondin e një historie të trilluar. Një konceptim i tillë i librit, mendoni se e bën më të thjeshtë për fëmijët të kuptojnë të kështilla çështje, shpesh të komplikuar edhe për të rriturit?

Romani 'Duke pritur Supernovën' është përpjekja ime e parë për të shkruar për moshat e nxënësve të nëntëvjeçares. Kam hezituar gjatë ta ndërmarra këtë përpjekje. Nuk kisha besim te vetja se mund t'i përafrohem gjuhës dhe mendimit të këtij brezi. Gjithë jetën kam punuar në universitet, me studentë që e kanë kapërcyer adoleshencën. Edhe fëmijët e mi janë prej shumë kohësh të rritur.

- A do të di të gjej gjuhën me këtë brez?- kam pyetur veten me frikë.

- Le ta provoj, - iu përgjigja një ditë vetes dhe atyre që më nxitnin. - Po pata gabuar e kam zgjidhjen, nuk e fus fare librin në botim.

Mirëpo miqtë që e lexuan të parët, ish-studentë të mi që japin mësim prej vitesh në shkollat nëntëvjeçare, më qetësuan e më siguruan se librin është i përshtatshëm për qëllimin e vet.

Në këtë libër astronomët parathënë se një supernova mund të ndodhë së shpejti. Një yll i ri do të shfaqet në qiell. Ai do të shkëlqejë më fort se të gjitha yjet e tjera. Ka katër shekuj që një ngjarje e tillë nuk ka ndodhur. I ka ardhur koha. Njerëzimi po e pret. Po e presin edhe Hana e Martini, bashkë me shokët e tyre. Por, ata nuk rrinë duarkryq. Janë hedhur në një aventurë drithëruese për të zbuluar e kuptuar disa mistere të historisë së shkuar të supernovave dhe të asaj që po afron. Duan të jenë pjesë e kësaj historie, që padyshim do të përfillet në mijëra vitet e ardhshme. A do të jenë pjesë e saj?

Mund ta zbuloni në faqet e librit.

**A.D.:** Profesoreshë, mund të shërbejnë romanet tuaja si një lloj udhëzuesi për fëmijët që të krijojnë një marrëdhënie të shëndetshme me ambientin përherë e më kibernetik që po krijohet rreth tyre?

**M.F.:** Të gjithë ndodhemi tashmë të zhytur këmbë e kokë në mjedisin kibernetik, celularë, facebook, instagram, linkedin, tiktok, gazeta online ...

Sot makina dhe programimi i saj po tentojnë t'i përafrohen modelit të inteligjencës njerëzore, dhe kjo është njëra nga risitë më spektakolare të epokës sonë. Çdo makinë e programuar në mënyrë përherë e më të sofistikuar na bën krenarë, në fakt, sepse është vepër e jona, e njerëzve; çdo produkt i ri i këtij tipi na mahnit me përkryerjen e vet. Së fundmi po flitet edhe për Inteligjencën Artificiale Kuantike, e cila mund të përshpejtojë e të rrisë ndjeshëm potencialet e teknikave të inteligjencës artificiale. Por, që në krye të herës, nuk ka njeri, të ditur a të paditur, të shkolluar apo jo, që të mos e ketë vrarë mendjen e të ketë pyetur veten apo të tjerët: Deri ku do të shkojnë kapacitetet e kësaj inteligjence artificiale?

Si akademike më mundon përherë pyetja nëse inteligjenca artificiale do ta prekë identitetin njerëzor. Unë vërej se njëfarë përtacie intelektuale na ka pushtuar, ngaqë disa prej aktiviteteve të mendjes na i kryen makina. Në dy-tri dekadat e fundit më duket se sofistikimi i makinave është shoqëruar me ulje të ambicieve të shkollës për të formuar nxënës me aftësi të spikatura në matematikë dhe shkenca. Dikur mësonim të shumëzohjëm, të pjesëtojmë me mend, të mbledhim e të zbrisim. Shpejtësia e veprimeve dhe saktësia e rezultatit na jepte prestigj mes shokëve dhe shoqeve. Sot këto veprime i bëjnë makinat. Dikur zgjidhja e problemave të vështira na e vinte trurin përballë sfidave të forta: derivate e integrale, limite, ekuacione trigonometrike, polinome e grafikë. Tani, të gjitha këto mund të na i



zgjidhë falas, shpejt e mirë, dikush tjetër. Por, deri në çfarë niveli kemi të drejtë të jemi përtacë në të menduarit? Deri ku na lejohet të mos e lodhim trurin me ato procese, për të cilat ky organ kryesor i joni, truri, ka qenë i angazhuar prej më së paku mijra vitesh. Ne po i vemë në gjumë këto procese. A mos ky delegim detyrash po i atrofizon aftësitë tona të të menduarit?

Në këtë kontekst, lloji i letërsisë sime ka dhe një argument më shumë për t'u konsideruar i dobishëm. Ai në një farë mënyre nxit të menduarin shkencor. Ky është qëllimi për të cilin këto vepra letrare janë krijuar.

**A.D.:** Si profesoreshë me përvojë shumë të gjatë dhe kontribut të dalluar, mendoni se lexuesi, studenti apo kushdo e kap më mirë një material shkencor nëse jepet nëpërmjet letërsisë apo nëse jepet si leksion?

**M.F.:** Thjeshtëzimi është njëri nga hapat që të çon drejt dijes. Ai zgjon kureshtjen, mpreh mendjen, rrit sigurinë, formon arsyetimin. Por sigurisht, shkenca për profesionistin mësohet në shkollat, në auditore dhe në laboratore, aty ku gjithçka shprehet përmes matematikës, mbretëreshës së logjikës e arsyetimit, pa të cilën asgjë s'do mund të kishte përparuar.

**A.D.:** Raporti i njeriut me pafundësinë përbën një ndër linjat e rrëfimit në romanin tuaj Infiniti Blu. Mendoni se njeriu është gati të përballlet me pafundësinë dhe të panjohurat e saj?

**M.F.:** Ka qenë gjithmonë gati për t'u përballur. Po t'i kthehem historisë, njeriu ka dashur që në krye të herës ta kuptojë pafundësinë. A është e pafundme Bota? Apo veç një strukturë gjigante, që sosit diku. E si mbaron? Sa larg e kemi mundur ta shohim me instrumentet tona? A ka patur dikur një fillim? A do të ketë dikur një fund? Apo Bota ka qenë e do të jetë e përjetshme. Sa imët mund ta copëtojmë lëndën? Po hapësirën? Pafundësisht? Apo ka një stad ku copëzimi ndalet. Sa thellë ka depërtuar imagjinata dhe dija shkencore? A MUNDËT MENDJA JONË TA KUPTOJË INFINITIN? Apo jemi veç sqimatarë të pandreqshëm. Dhe mëkatë të mëndjelehtë.

Këto pyetje i kam formuluar në faqet e para të romanit 'Infiniti Blu', në një stil që përafrohem me mënyrën se si njëri nga fizikanët më në zë të shekullit tonë, Stephen Hawking, i ka shtruar. Ato pyetje, në fakt, ekzistojnë prej mijëra vitesh, por pata dëshirë që lexuesve t'u përafroj variantin Hawking, për arsye të madhështisë që ky shkencëtar shfaq në sytë e mi. Me mënyrën

se si shpirti i tij ka arritur të dominojë trupin, më duket si një sintezë e përpjekjes së llojit tonë, njerëzve, për të kapërcyer vogëlsinë dhe brishtësinë e planetit tonë drejt pafundësisë drithëruese.

Shënimet historike tregojnë se mendimi për pafundësinë është zhvilluar edhe përpara Aristotelit, dijetarit të famshëm grek të 2400 viteve të shkuara. Por ky i përmbodhi në mënyrë didaktike dhe bëri dallimin e qartë mes dy kategorive të infinitit, infinitit potencial dhe infinitit aktual. Këto dy kategori i mbijetuan zhvillimit të shkencave, kryesisht të matematikës, në dy-tre mijë vite pasuese.

Si përballen me pafundësinë njerëzit e shekullit XXI dhe personazhet e Infiniti Blu? Këtë mund ta zbuloni nëpër faqet e romanit.

**A.D.:** Profesionet tuaja kanë kërkuar përherë një përdorim të qartë të gjuhës, të përshtatshme për studentët. Kur shkruani, si ja dilni ta mbani narracionin në nivelin që i përshtatet lexuesve të vegjël dhe të rinj?

**M.F.:** Më ndihmon frymëzimi nga faktet që dua të shpreh e të komunikoj. Gjithsesi, secila nga veprat ka qenë një sprovë më vete. E para, Pika Trëndafil, më siguroi se unë mundem të jem shkrimtare. Fitoi edhe çmimin kombëtar të letërsisë për të rinj, i cili më dha një gëzim të pamatë, ngaqë më bindi se sprova e parë kaloi me sukses. Libri i dytë kishte në vetvete sprovën e pafundësisë. Libri i tretë kishte sprovën e moshës së vogël të lexuesit.

Ndiej se pa patur sfida, të shkruarit nuk do të më tërhiqte dhe nuk do ia dilja për të mbyllur një vepër, madje as për ta nisur.

**A.D.:** Si mendoni, profesoreshë, është më e madhe bota brenda fëmijës apo ajo jashtë tij?

**M.F.:** Bota e fëmijës fillimisht është e vogël e pastaj rritet papushim, ndërtohet sipas një arkitekture që ia ofrojmë ne, familja, shoqëria, por edhe universi rrethues që pashmangshëm i hyn përmes të gjitha shqisave. Bota e njeriut është në ndërtim ndërsa bota jashtë, ajo universalja, është gjigande e mjaft e strukturuar. E ne kërkojmë që këtë botë të madhe ta nxërë ajo e vogla. Duket si detyrë e pamundur, por historia e njerëzimit thotë se jo. Ajo ka treguar se ne, njerëzit, jemi të jashtëzakonshëm. Një mrekulli e natyrës. Mënyra se si prej mijëra vitesh jemi munduar të kapërcëjmë hapësirat e pakufi, duke shtruar pyetje e kërkuar përgjigje, është e mahnitshme. Mes njëri-tjetrit mbase ndjehemi të zakonshëm.

Por, në dimensionet e një bote gjigante, të cilën po arrijmë ta njohim ditë pas dite, shfaqen tiparet tona të jashtëzakonshme.

**A.D.:** Në mbyllje, sa e vështirë ka qenë për ju të shkruani libra fantastiko-shkencor, duke pasur parasysh se në letërsinë shqipe nuk kemi një traditë të pasur në këtë zhaner?

**M.F.:** Nuk ka qenë e vështirë, sepse në çdo rresht kam qenë e frymëzuar nga bukuria e pamatë e asaj që kam dashur të shpreh. Progresi aktual i shkencës është marramendës në të gjitha fushat, e veçanërisht në njohjen e Universit dhe në përpjekjen kurajoze për ta dominuar atë. Shekulli që jetojmë po shënohet me vulën e makinave hapësinore, të cilat shqyrtojnë sinjalet më të hershme, mbërritur nga origjina e botës; të instrumenteve me saktësi përtej çdo limiti të imagjinuar. Arritjet janë kaq emocionuese, sa kushdo prej nesh që i rrok ato dimensione, mund t'i shijojë tërësisht vetëm nëse i ndan me të tjerët.

Shkencëtarët më në zë janë përpjekur e përpjekur të shkruajnë libra të shkencës popullore, të popshkencës. Në këtë linjë ndodhen edhe librat e mi. Kam zgjedhur t'i shkruaj në formë romani, sepse përmes faqeve të tij mund të transmetoj dijen e të kem njëkohësisht si personazhe lëvruarit e dijes. Ata janë njerëz realë, që jetojnë sot apo kanë jetuar në epokë të tjera, ose njerëz imagjinarë, të cilët punojnë në qendra reale shkencore. Liria e këtij zhanri artistik më lejon të endem nëpër përsiatje e refleksione që i përshtaten karaktereve të ndryshme, formimeve të ndryshme; më lejon të ndërthur bashkë me shkencën dhe histori personale njerëzore, ku secili mund të gjejë diçka nga jeta e vet. Ndiej kënaqësi pafund kur takoj njerëz që më thonë se librat e mi u kanë pëlqyer.

**A.D.:** Dhe për ta përfunduar me një pyetjeje të para, pas "tre jetëve", asaj prej akademikeje, politikaneje dhe shkrimtareje, ju pret një e katërt me ndonjë angazhim krejt të ri?

**M.F.:** Të ardhmes nuk i dihet asnjëherë. Por, sa më shumë rrjedhin vitet, aq më pak mundësi mbetet për të bërë diçka tjetër. Koha në dispozicion zvogëlohet shpejt e pa u ndalur. Për më tepër, unë ende nuk e kam shterruar eksplorimin në ato tri jetët që përmendët. Ndërkohë jam bërë gjyshe e po përjetoj e mrekulluar këtë fazë tjetër të jetës, e cila është një risi më vete, aq e tillë sa nuk e kisha imagjinuar. Kush e ka provuar më jep të drejtë.



Kur më erdhi ftesa për këtë tryezë, megjithëse dimër, dita kishte plot dritë dhe vetiu m'u kujtua çfarë i kisha thënë njëherë Ali Aliut. I kisha thënë se gjatë vitit Prishtina vërtet ka tërheqje, por edhe Tirana ka shumë ditë me diell. Nuk e di pse, përveçse si albanolog i shquar, edhe si personalitet njerëzor Ali Aliu më vjen në mend sidomos në ditë me diell. E kështu ndodhi që ky vegim m'u bë nxitje për t'i hedhur lirshëm ca shënime edhe në letër.

1.

Akademiku 90-vjeçar, që na nderon mes nesh, ka njëzakon të pashqitshëm. Kur është duke shkruar, ai sikur e këndon nën zë tekstin që po kompozon. Dhe kjo ndodh prej fjollave të frymëzimit. Nga Katër Stinët e Vivaldit, ndoshta për harenë e saj, do ta vija gishtin te Pranvera.

Ali Aliu i përket kritikës dhe filozofisë pozitiviste. Kur bën objekt studimi krijimtarinë e një shkrimtari, ai hedh dritë në anët më të forta të autorit, i analizon njëpër një, por me lupë në dorë nxjerr në pah edhe sythe që ose janë në zhvillim, ose premtojnë të zhvillohen. Në shkrimet e tij nuk ka asgjë toksike. Ai nuk helmon as me dashje, as pa dashje, përkundrazi, vihet në krah të shkrimtarit të cilit i dhuron vlerësim dhe ndjesi gëzimi. Nuk ka autor që mund të ankohet se Ali Aliu ia ka ngrënë hakun, siç nuk kam dëgjuar ta ketë pohuar dikush mbipeshën, kur mund t'i jetë dhënë më tepër.

2.

Ali Aliu e ka të lindur Dashninë për leximin dhe Pasionin e fjalës për letërsinë. Pa e patur fare qëllim, madje pa i shkruar asfare në mend, çfarë ka patur tëbrendshme e ka shpallur si kryemotiv qysh në fillimet e veta. Ja si mund të lexohen të bashkuar tre titujt e tre librave të tij të parë: "Kërkime e Shtjellime në Rrjedha të Letërsisë". Tre titujt në një, kredo e plotë.

Ali Aliu është studiuesi në simbiozë me zekth që ka përditshmëria e kritikut. Ky është tharmi që, ashtu siç nuk e ka lënë në rini, nuk e lë rehat as në moshën e patriarkut. Kur i ka ardhur për të folur, atij nuk i ka ngrirë lapsi në dorë, madje me raste nuk është stepur për ta trajtuar një vepër edhe si kryevepër, pa manipuluar me heshtjen si element i estetikës së reagimit apo si koncept i dilemës etike. Romancierët ndoshta s'janë aq bujarë sa poetët, të cilët jo rrallë ngopen me aromën e lavdërimeve, ndërkohë qëprozatori ndalet ndër paragrafë e detaje, duke kërkuar argumentin në shumësinë e tyre. Nuk po i shtyj më tej reagimet e palës së shkrimtarëve, por po them se ndodh diçka e çuditshme me palën tjetër. Në vend të presëmirenjohje nga autorët e librave që ka pëlqyer, Ali Aliu sillet vetë i pari falënderues ndaj tyre.

3.

Sigurisht, me sy të lirë askujt nuk i duken shenjat e botës së brendshme. Por askush që merr guximin të shkruajë, sado të përpiqet, për një sy të stërvitur nuk mund ta fshejë transplantin e zemrës në tekstin e tij, në terma tëkardiologjisë, ritmin, aritminë, suficencën, insuficencën, etj. Ashtu si për çdo krijimtari, në rreshta e midis rreshtave shpirti i kritikut pulson në tekst, duke dëshmuar si ndihet fjala aty, vjen si harmoni, vjen si llogaritje matematike, rënkon nga mungesa apo kërcet nga teprimi.

Modalitetet e shqyrtimit kritik janë nga më tëndryshmet, rekomandohet

Akademiku 90-vjeçar Ali Aliu  
që na nderon mes nesh

# I PANGJASHËM MËS TË NGJASHMËVE

Nga Zija Çela

objektiviteti. Mirëpo kur e kanë patur prirje, edhe kritikë e studiues të shquar nëbotë ia kanë dalë ta arrijnë objektivitetin jo vetëm përmes dijes, kulturës e kapacitetit mental, por edhe ndihmës së urtësisë shpirtërore. Më duket se kjo urtësi e karakterizon tekstin e Aliut. Në pjesën e shkrimeve kritike ai nuk është i shkarkuar plotësisht nga barra emocionale, porse emocioni i ngarkohet vetë zbulimit të një thelbi, bie fjala, thelbit të përgjigjes se çfarëështë e re në librin e këtij apo atij autori. Dhe nuk mund të mohohet, për vetë natyrën e tij zbulimi është ngritje e velit, njëfarë dasme e përjetshme, ai e ka nëaksionin e vet emocionin.

4.

Në veprën e Ali Aliut gjenden referenca, por zakonisht të natyrës po-huese, mbështetëse dhe informuese. Duke mënjanuar frymën e debatit dhe të polemikës, ai përqendrohet sidomos në faktorët e tij tëanalizës, në thellimin e argumenteve dhe depërtimin shpesh kapilar. Si fryt i punës së Ali Aliut, ndër të tjera, në librin voluminoz "Don Kishoti shqiptar", që sapo është ribotuar i plotësuar, sot kemi një tablo plot ngjyra mbi krijimtarinë e disa prej poetëve e prozatorëve më të spikatur bashkëkohorë. Herë në rolin e historianit e herë tëpropozuesit për historianët e letërsisë, në këtë antologji vetjake të mendimit kritik gjejmë problematika tërëndësishme të estetikës dhe përgjithësisht të teorive letrare. Aty shtrohen pyetje e jepen përgjigje

për çështje bazike të prozodisë, individualitetit dhenarracionit, raportit të reales me irealen, gjuhës sëtekstit e të nëntekstit, etj.

5.

Njëherë, teksa bisedonim për një shkrim të botuar në gazetë, vëreja se Aliut i kishte mbetur peng përse redaktori kishte ndajshuar pranë emrit të tij ofiqin e akademikut. Dhe këtë nuk mund ta merrje as si shtirje, as si trill, aq më pak si rastësi. Ai gjithnjë nuk ka kërkuar ndonjë potencim me statuset zyrtare, për ta lënë lexuesin të lirë në gjykimin e tekstit, duke ia respektuar mendimin e pavarur dhe mënyrën e leximit. Tekefundit, tërë jetën edhe vetë është treguar një lexues i hatashëm, nga ata të thekurit, të cilët lënë sytë mbi shkronjat e tjetërkujt.

6.

Por si lexon Ali Aliu? Kam krijuar një përshypje nga biblioteka e tij private. Me gjasë, me t'iu ndezur ndonjë shkëndijë përgjatë lëçitjes, ai hedh shënime nëmargjinat e librit, në ato hapësirat e bardha sa njëpentagram. Si ta përfundojë leximin, do të këqyrëpikërisht këto nota të shpejta. Nëse ka mundur tënxjerrë esenca, ndihet thujse gati për shkrimin; nëse ende jo sa duhet, i rikthehet librit pjesërisht. Përndryshe, me kalimin e kohës ato shkëndijat ftohen dhe shënime nuk dalin nga raftet.

Mes mënyrave të larmishme, pse jo, mua më pëlqen gjithashtu ky qëndrim,

që afron me krijimtarinë e mirëfilltë: të punosh jo vetëm për të kënaqur të tjerët, por së pari për të ndier kënaqësi vetë gjatë procesit tëshkrimit.

Ali Aliu ka lexuar shumë libra të rëndësishëm. Por ma do mendja nuk ka profesionist që të ketë lexuar sa ai edhe libra të parëndësishëm. Nëpër vite, për t'i dhënë skenë emrin që ka, kam parë si i "vërsulen" në panairë duke i dhuruar libra prej kahmos. Siç është e pritshme, nuk mungojnë autorë të afirmuar, por nuk mungon sidomos bylyku i fillestarëve, amatorëve të vonuar e maniakëve tëshkrimit. Si drejtin e ndiejnë këta se kanë gjetur "babaxhanin" e duhur?! Sepse Aliu, me torbat plot, shkon pastaj përtej mirësjelljes: i lexon thujse të gjithë ato libra, madje cili është me fat edhe recensionohet.

Kam menduar ndonjëherë se Aliu nuk është fort i rreptë si kontrollor. Por më mirë genuin, sesa ta lidhte veten duke u bërë autocensor. Natyrisht, ne do të kishim edhe ashtu një profil letrar, por jo kaq tëpersonalizuar prej shenjave të tij, domethënë njëpersonalitet të pangjashëm midis të ngjashmëve, ose tëngjashëm me të pangjashmit. Shkurt fjala, një kritik kaq empatik.

7.

Në përvojën time, kur shkruaj një roman, synoj tëkaloj në katër nivele, që nuk është rasti të përmenden. Por ekziston edhe një i pestë. Ky është niveli, kur kritika letrare zbulon në veprën e shkrimtarit çfarë s'e ka ditur më parë vetë autori i saj. Kështu ndodh edhe me kritikët e studiuesit, jo rrallë dinë për veten më pak se të tjerët dinë për ata. Dhe sa mirë kur kolegët janë tëgatshëm t'ia thonë.

8.

Dhashtë Zoti që, një ditë, të jemi çli-ruar përfundimisht nga bizantinizmi i trashëguar, ai i llojit që, siç thotë Brodskij, sa më afër qëllimit të ndritur tëjetë dikush, aq më të mjegullta ia bëjmë mundësitë e arritjes. Afërmendsh, auditori më i drejtpërdrejtë për çfarë shkruhet sot janë bashkëkohësit. Por unë besoj se do të mbizotërojnë interesat e pastra, të cilat punën e çmuar të studiuesve tanë do t'ia përcjellin edhe sëardhmes.

9.

Ah, edhe diçka në fund, meqë pajtohem se çka është e mjaftueshme, mbetet gjithnjë e pamjaftueshme. Po, gjatë vitit Prishtina ka vërtet tërheqje, por edhe Tirana ka shumë ditë me diell...

(Vijon në 100-vjetorin e lindjes.)





Nuk e kam të lehtë të shkruaj për Vllasova Mustën, në 75 vjetorin e lindjes, si poete, personalitetin e saj si grua dhe nënë, si dhe për kontributin që ka dhënë ajo në Kinostudion "Shqipëria e Re", në dhjetëra filma dokumentarë, filma vizatimorë etj. Kam patur fatin ta njoh atë nga afër gjatë 4 viteve, kur ishim bashkëstudentë, në degën e gjuhës dhe letërsisë, të Universitetit të Tiranës. Kemi punuar bashkë disa vite, në një nga institucionet më të mëdha të filmit shqiptar dhe më pas, para se të dilte në pension, në një zyrë në katin e tretë të Muzeut Historik Kombëtar, ku drejtor ishte i paharruari, Moikom Zeqo.

Përpiqem të kthej kohën pas, të rikthej vitet tona studentore në Tiranë, që kanë qenë nga më të bukurat e jetës time. Mbaj mend, se ishte shtatori i vitit 1967, një ditë vjeshte plot dritë e Tiranës, kur zbrita nga treni, që vinte nga Rrogozhina, qyteti im i vogël. Pastaj bulevardi i Tiranës, sheshi i madh dhe Rruga e Elbasanit. Akoma ndjej aromën e trëndafilave, që vinin nga kopshtijtë dhe shtëpitë e kësaj rruge, që të çonte në Fakultetin e Filologjisë dhe Qytetin Studenti. Godina hijerëndë e fakultetit, studentë që hynin dhe dilnin, profesorë, emrat e të cilëve do të bëheshin të njohur nga unë dhe brezi im, si personalitetet e gjuhës, letërsisë, historisë, gjeografisë... Regjistrimi dhe ngjitja me valixhen e vogël në dorë për në Qytetin Studenti, kati i dytë i godinës dhe dhoma, ku fati e desh që të jem me poetin lirik nga Elbasani, Shefki Karadaku, Moikom Zeqon, poetin e ri nga Durrësi, Niko Kacalidhën, që vinte nga një fshat minoritar e që quhej Leshnicë, Tomorr Domin, elbasanasin e mirë.

Nuk isha më shumë se 18 vjeç. Vija nga një qytet i vogël, siç ishte Rrogozhina dhe një familje e thjeshtë nga Çamëria. Në ato vite isha i ndrojtur, romantik dhe shumë i ndjeshëm. Ne ishim një brez ëndërrimtarësh, të pastër e të pasur shpirtërisht, përtej ideologjisë së kohës, izolimit. Brezi im e ëndrra, me libra dhe tepër aktive. Ne lexonim shumë, veçanërisht poezinë e poetëve shqiptarë të kohës, si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Dhori Qirjazi, Musa Vyshka etj. etj. Lexonim dhe atë të përkthyerin nga poezia e madhe ruse, apo europiane.

Ka të drejtë Vllasova Musta, ku në intervistë, dhënë gazetares Zenepë Luka, më 13.10.2011, mes të tjerash flet për rininë e saj të bukur e të shëndetshme dhe se ka qenë rini me ëndrra, me libra dhe tepër aktive. Ne lexonim shumë, veçanërisht poezinë e poetëve shqiptarë të kohës, si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Dhori Qirjazi, Musa Vyshka etj. etj. Lexonim dhe atë të përkthyerin nga poezia e madhe ruse, apo europiane.

Brezi im adhuronte Kadarenë. Unë lexoja çdo gjë që ai botonte në shtypin letrar të kohës. Unë përpjia si i etur për ujë në shkretëtirë, poezinë dhe prozën moderne të Kadaresë.

Vllasova Musta i përket këtij brezi të shkëlqyer idealist dhe romantik. Ajo vinte nga Gjirokastra. Nga ky qytet i Jugut të Shqipërisë vinte edhe Thanas Dino, që sot është personalitet i njohur në fushën e prozës shqipe. Gjithashtu vinte dhe Parime Puto, një vajzë e qeshur. Vajzat e kohës sonë kishin një sharm dhe bukuri tjetër. Vllasova Musta ishte një nga këto. Ajo kishte lindur më 8 prill të vitit 1949, në qytetin e çudtshëm mitik dhe mistik të Gjirokastrës, ku erërat, shirat, dëborat, mjegullat vinin dhe pasi uleshin mbi kalanë hijerëndë, zbrisnin poshtë kalldrëmeve dhe futeshin në shtëpitë e gurta të këtij qyteti. Atje çdo gur i kalldrëmeve apo sokakëve, çdo shtëpi e gurtë flet, ka gjuhën e vet. Kadareja ynë i madh e ka njohur nga afër këtë gjuhë, simbolet e saj dhe në kryeveprën e tij botërore, "Kronikë në Gur", u ka dhënë shqiptarëve e të huajve zërat mitikë e mistikë të këtij qyteti. Vllasova Musta, pra vinte nga ky qytet i çuditshëm dhe befasues.

Nuk e kam njohur babain e saj, të cilin ajo e adhuronte për kulturën që kishte dhe risjell në kujtesë dashurinë e veçantë për librin.

Babait Vllasova i ka kushtuar disa poezi dhe një tekst të mrekullueshëm, që e ka titulluar "Xhaketa e Kuqe". Kompozitori i madh gjirokastrit, Feim Ibrahim i bëri këngë këtë tekst, që u këndua nga Justina Aliaj dhe Liljana Kondakçi, në mos gaboj në Festivalin e parë të Këngës së ushtarit, në vitin 1970 dhe që fitoi Çmimin e parë. Nëse

# DRITARJA E HAPUR E JETËS DHE POEZISË SË VLLASOVA MUSTËS

Nga Enver Kushi

një ditë për përkujtimin e 9 majit, Ditën e Fitores mbi Fazhizmin dhe Nazizmin në Europë do të organizohet ndonjë festival për rezistencën Antifashiste, jam i bindur që kënga "Xhaketa e Kuqe" e kompozitorit Feim Ibrahimit me tekst të Vllasova Mustës, do të vlerësohet nga çdo juri profesioniste. Kam njohur Teftën, nënën e saj. Edhe ajo ishte një grua me kulturë. Tefta në Gjirokastrë kishte miqësi me Hatixhenë, ose Haxhekon, siç e thërrisnim ne. Hatixheja ishte e lidhur shumë me familjen time dhe unë e kisha gati-gati si në vend të hallës sime. Ajo ishte mbesa e myftiut të Filatit, ndërsa nga babai ishte mbesa e Haxhi Murat Saqes nga Spatari im. Hatixheja ishte martuar me Petrit Vehbiun, ushtarak karriere dhe njeri i mrekullueshëm.

Nuk është e rastit, që po të lexosh poezinë e Vllasova Mustës zë vend aq të gjerë qyteti i saj i lindjes, prindërit, atmosfera e kohës dhe më pas kjo poezi do të pasurohet me motive të tjera. Në intervistën dhënë gazetares Zenepë Luka, në vitin 2011, ku në këtë shkrim një pjesë prej kësaj interviste, do t'i fus si rrëfime të Vllasovës, ajo në fund thotë: "Jeta ime është një dramë e trishtë. Njerëzit kanë nevojë për gjëra të bukura". Nuk e mbaj mend se kush e ka thënë, por me siguri një nga njerëzit e mënçur të kësaj bote, mes të tjerash ka folur për dhimbjet njerëzore, veçanërisht ato që shoqërojnë jetën e krijuesve të fushave të ndryshme. Këto dhimbje, ka thënë ky njeri i mençur, bëjnë që krijimtaria që ata lënë pas të jetë jo vetëm e trishtë, por e bukur në dhimbjet e saj.

## Poezia e Vllasova Mustës

Vllasova Musta, është një emër i njohur i Letrave Shqipe, veçanërisht i botës së madhe të poezisë. Them i botës së poezisë, sepse ajo ka një jetë të tërë, që i është kushtuar asaj. Ajo ka lindur me poezinë dhe që në rininë e hershme. Vllasova Musta mbetet e re dhe e freskët në frymëzimin e saj. Një nga gjenitë e letërsisë dhe kulturës botërore, Bohesi ka thënë: "Poezia është një ndër mundësitë, që kemi ne njerëzit për t'u ndjerë të lumtur". Vllasova e ka patur këtë fat, që të lindë, përkundet dhe madhohet në shtratin e poezisë. Ajo ka dhe një fat tjetër, sepse ka lindur dhe kaluar rininë në qytetin e Gjirokastrës, dhe siç nënvizua më lart, në qytetin aristokrat të dhjetra personalitetëve, ku mes tyre do veçoja Ismail Kadarenë e madh. Po të lexoni poezinë e Vllasova Mustës do të prekeni dhe ndjeni, dritën, qiellin blu, gëzimet, por edhe mjegullat, shirat e papritur, trishtimin, dhimbjen, zërat e të vdekurve, vetminë dhe prapë dritën, që vjen pas rrebesheve, siç ndodh në qytetin e saj të lindjes. Edhe në këtë cikël, që do të lexoni, duket që nëpërmjet thjeshtësisë së vargut, metaforave, apo përqasjeve dhe gjetjeve befasuese, është edhe gëzimi, edhe dhimbja, edhe drita, edhe e qeshura, edhe loti, edhe trishtimi gri. Poezija e saj është e qelqtë, e brishtë, e delikate. Duket sikur po ta prekësh, befas do thërmohen gërmat, fjalët, vargjet...

## Rrëfimi i parë

Babai im, pas Gjinnazit të Gjirokastrës, kreu studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Milanos. Më pas, në vitin 1949 shkoi në Akademinë Frunze, në ish Bashkimin Sovjetik e në vitin 1961 përfundoi Akademinë Voroshilov, në Moskë, që ishte niveli më i lartë i studimeve ushtarake. Pra, ishte një oficer karriere, me profesionalizëm të admirueshëm, me përkushtim dhe korrektesë absolute në çdo aspekt jetësor. Kishte një dashuri të veçantë për librin dhe mua si fëmijë, prej tij më ka mbetur në kujtesë mënyra se si lexonte: përherë i ulur në tav-



olinë, me librin dhe me një tregues në krahu të librit, që e përdorte kur ndërpriste leximin, kurrë nuk e përthente faqen e librit! Nëna ime kishte kryer Shkollën Tregtare në Vlorë, e donte librin, lexonte, por edhe kishte kënaqësi të fliste për të. Ishten 80 vjeç kur u nda nga kjo jetë, por iku duke pasur një libër në dorë. . .

Rinia ime ka qenë e bukur, e plotë, e shëndetshme. Ka qenë rini me ëndrra, me libra, dhe tepër aktive. Fillova të shkruaj herët dhe poezinë e parë e kam botuar kur isha gjinnaziste. E kujtoj fare mirë, më ka mbetur në kujtesë, ka qenë ditë e diel, nëntor dhe në gazetën "Drita" ishin botuar poezitë e mia! Në qytetin e Gjirokastrës, ku jetoja në ato vite, kishte një dëshirë të veçantë për librin dhe dijen në përgjithësi. Dola për të blerë gazetën, si zakonisht, dhe veç kur fillojnë e më urojnë të njohur e të panjohur. U mrekullova dhe rrugën deri në librari e kam bërë jo duke ecur, por thaujse fluturoja. Gati, gati nuk po e besoja as vetë. Kaq shpejt i botuan! I kisha dërguar para pak ditësh dhe sinjerisht nuk e prisja. Ajo ditë ka qenë e magjishme, nga më të mrekullueshmet, e veçantë dhe e paharrueshme. . . Me gazetën në dorë randa për në shtëpi dhe atë ditë gjithçka më dukej më e madhe, më e bukur, më me ngjyra. Të nesërmen, në shkollë, për shokët dhe shoqet e mia unë isha "personazhi i ditës". Ishte vërtet bukur! Pas kësaj, vazhdoja të botoja herë pas here dhe krahas botimit të poezive filluan të më vinin letra me urime nga të rinj e të reja nga gjithë Shqipëria. Ishte koha kur letra kishte tjetër dimension dhe tjetër vlerë.

Librin e parë e kam botuar kur isha në gjinnaz dhe titullohej "Pa kopertinë".

## Rrëfimi i dytë

Unë isha vetëm 19 vjeç, kur një ditë u gjenda përballë Kujtim Spahivoglit në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Ai më pa dhe shtangu, unë e pashë dhe ngriva! Ai pyeti dikë se "kush është ajo vajza?". I thanë si quhesha dhe kaq mjaftoi, më thirri sikur më njihte prej kohësh. Unë iu avita dhe s'po flisja. Ai më shihte, qeshte i gjithi dhe më përqafoi sikur më rigjeti pas kaq e kaq kohësh! Nisëm të bisedonim sikur të ishim miq të vjetër e jo të sapo njohur. . . Nga ai çast ishim përherë bashkë për një kohë të gjatë, dhe martesa erdhi krejt natyrshëm. Unë asnjëherë nuk ia kërkova martesën, asnjëherë, ne e donim njeri-tjetrin, por unë nuk doja që ai të ndihej i detyruar për ta bërë atë hap, për të cilin kish hezituar vite e vite me radhë, para se të njiheshim bashkë. Një ditë, në fillimvjeshtë, teksa më prishte në vendtakimin tonë, (do të shkonim tek miqtë e tij, Skënder dhe Vitore Sallaku), unë mbërrita, dhe ai më përfshin të tërën e tek më mbante përqaftuar, befas i shqetësuar më largoi, për të më parë edhe më mirë e më tha: "Ç'e ke këtë drithërimë"? "Po, ja mjafton mendimi që po vija drejt teje dhe më kap emocionin...", munda t'i them, por më tepër se sa fjalë ishin mërmërimë dhe dorën e mbaja afër zemrës se më bëhej sikur po më dilte vendit. Ai qeshi me zërin e tij kumbues dhe më tha: "Ja, për këtë drithërimë të shpirtit kam pasur nevojë, asgjë tjetër nuk do të kërkoja!". Pas këtij momenti u gjendëm në bulevard dhe teksa po ecnim, si në përumbje ndjeva se krahu i tij më kish

(Vijon në faqen 7)



## 1.

Po të gjurmosh në jetën artistike të Hasan Hasanit, nuk është e vështirë të mësohesh se ai është poet, prozator e publicist. Por kohët e fundit po e shenjzohet profilin e tij si studiues e kritik letrar. Duke u ndalur në këtë të fundit, mendoj që nuk është as e papritur e as rastësi kjo ardhje e tij. Rrezja paralajmëruese është dukur moti më parë, gjatë botimeve të tij në periodikë e revista të ndryshme. Si një 'parathënie' i prin kontributi i çmueshëm në lëmin e letërsisë shqipe, si autor i *Leksikoni i Shkrimtarëve Shqiptarë (1501-2001)*<sup>1</sup>. Ndërsa librat, që tashmë kemi në duar titullohen: "Faqe Libri"<sup>2</sup> e "Shenjzime"<sup>3</sup>. Ato hedhin vështrime mbi ecurinë e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, shqyrtojnë e studiojnë copëza zhvillimi të kësaj letërsie, edhe pse kanë kaluar, shpesh herë, më shumë se tri apo katër dekada nga botimi i tyre. Shenjzimi i veprës dhe bilanci artistik janë kurdoherë të nevojshëm dhe të domosdoshëm për vlerat e proceset e një letërsie.

Komunikimi me lëndën e ofruar të librave të bën të njohesh me konceptet dhe strukturat e tyre, të cilat janë ndërtuar në dy blloqe: në shënime letrare për vepra të letërsisë për të rritur, dhe në shënime letrare për vepra të letërsisë për fëmijë e të rinj. Libra të kësaj natyre që, në tekstin e tyre kanë si objekt shqyrtimi dhe analize vepra të letërsisë për të rritur dhe të letërsisë për fëmijë e të rinj bashkërisht brenda një hapësire, janë **shenjzime mbarësie (këtu, tani, është fjala për Letërsinë për fëmijë e të rinj)**, pasi një mozaik i tillë nuk është dhe aq i shpeshtë. Duke marrë shkas nga profili i këtyre librave, është e nevojshme të rikujtojmë se, koncepti i unikes në letërsi lidhet pazgjidhshmërisht me plotërinë e portretit të saj, pavarësisht specifikave dhe veçorive që mbart letërsia në vetvete. E parë në këtë këndvështrim, pohojmë seriozitetin dhe misionin e vërtetë të studiuesit Hasanit për ta parë zhvillimin e letërsisë, procesin e saj në tërësi, në shumë rrafshje, në shumë qasje e në shumë marrëdhënie. Këtë e lidhim edhe me fjalën e autorit, që në parathënien e librit thotë: "E quajta "Faqe Libri", meqë të gjitha këto njësi janë shkruar për libra të ndryshëm letrarë, portrete të ndryshme letrare, autorë apo përvjetorë, qoftë të letërsisë për të rritur, qoftë të letërsisë për fëmijë, apo edhe për ndonjë figurë letrare të veçantë, si De Rada, Noli apo Migjeni. Të gjitha këto shkrime janë të botuara në gazeta dhe revista në Prishtinë gjatë një periudhe të gjatë kohore, (brenda viteve 1969-2006), pjesa më e madhe e të cilave janë botuar në revistën "Fjala" gjatë viteve shtatëdhjetë-tetëdhjetë, ndërsa pjesa tjetër në "Jeta e re", "Zëri i rinisë", "Bota e re", "Rilindja", "Gazeta e pionierëve" dhe "Shkëndija", dhe paraqesin fillimet e mia duke filluar nga vitet e studimeve e deri në ditët e sotme, kur edhe po sheh dritën ky libër. ... Libri është i ndarë në tri pjesë: \*Përshtypje të hershme, \*Faqe libri për të rritur, dhe \*Faqe libri për fëmijë ... Shpresoj se **Faqe libri** do të paraqesë përshtypjet dhe angazhimin tim për gati dyzet vjet në jetën kulturore e letrare në Kosovë."<sup>4</sup>

## 2.

Vështrimi im do të ndalet në kapitullin e librit, që përmban vetëm vepra të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Janë tituj që u takojnë periudha të ndryshme vitesh dhe kohe botimi. Edhe pse të botuara me largësi vitesh, Hasan Hasani nuk e ka humbur kohën dhe hapësirën e kësaj letërsie. Ndjekja në proces, zbërthimi i kodeve letrare, evidenton dhe pasuron karakterin njohës, informues, problemor, stadin zhvillimor dhe edukativ të librave në fjalë. Në optikën e studiuesit na serviren libra me shumëllojshmëri gjinish e zhanresh letrare, me struktura të larmishme, me prirje konvencionesh e rrëfimesh lineare e jolineare, të cilat pasqyrojnë problematikën e tematikën të zhvillimit dhe të ecjes së kësaj letërsie, të subjekteve që i flasin kohës, të mesazheve që përcjellin, etj.

Autori gjatë analizave (shpesh herë mes recensionit e përpjekjes së një realizimi drejt një studim të mirëfilltë) evidenton profilesh krijuesish, qasje brenda një veprë a të një shumësie veprash brenda qerthullit të shkrimtarit, njohje të psikologjisë e pasqyrim të botës fëmijërore, përcjelle vlerash në rrafshje krahasimtare, jehona e tyre në hapësirë dhe në kohë, nënvizon koncepte e hedh për diskutim disa parashtrësia që paraqet kjo letërsi në rrugën e zhvillimit të saj duke u ballafaquar me kërkesat që shtron koha dhe realiteti i përditshëm.

Në kapitullin që trajtohen veprat e Letërsisë për fëmijë e të rinj 'frymojnë' artistikisht 24 autorë. Nga këta: 19 autorë janë shqiptarë, botime të Kosovës e të Shqipërisë, dhe 5 autorë janë të huaj. "Gjeografia" e veprave realizohet si pasojë e frytit të leximeve vetjake të studiuesit dhe parapëlqimeve të tij. Janë vepra që paraqesin një dimension të gjatë kohor dhe plotësojnë segmente të pastuduara të tablosë së zhvillimit të letërsisë për fëmijë e të rinj, gjë që i japin mundësinë e zvogëlimit të kësaj zbrastë. Gjithash-tu, kënaqësia estetike e të lexuarit dhe grishja që i bën vepra e shkrimtarit studiuesit Hasan Hasani nuk është e 'parcelizuar', por e njëjtësuar, duke i dhënë frymëmarrje më të gjerë veprës në interpretim, veçanërisht në përcaktimin e vlerave artistike që mbart secili libër.

Studiuesi Hasan Hasani merr në shqyrtim këto vepra: "Vargje të mira edukative" (Mark Krasniqi: "Posta e porositur", 1964, Prishtinë, f. 203); "Fytyrë e njomë trimërore" (Selman Vaqari: "Debatik", 1971, Prishtinë, f. 212); "Mes përrallës e romanit" (Qamil Batalli: "Princesha dhe bariu", 1971, Prishtinë, f. 221); "E vërteta kurdoherë del në shesh" (Abdyl Bunjaku: "Djaloshi pas plepit", 1976, Prishtinë, f. 229); "Jeta e gërshetuar nëpërmjet rrëfimeve" (Arif Demolli: "Pëllumbat e kujtimeve", 1978, Prishtinë, f. 231); "Sintezë e një epoke e gërshetuar përmes rrëfimit" (Frederik Reshpja: "Trimi i fshatit Bardhë", 1968, Tiranë, f. 234); "Kah poezia intelektuale për fëmijë" (Agim Deva: "Me temlik u nisa në botë", 1978, Prishtinë, f. 238); "Demitizimi i Gjergj Elez Alisë" (Rushit Ramabaja: "Gjergj Elez Alia", 1978, Prishtinë, f. 241); "Edhe një legjendë e bukur për fëmijë" (Nuhi Vinca: "Legjenda e peshkatarit", 1978, Prishtinë, f. 243); "Roman tërheqës humoristik" (Ymer Shkreli: "Bali Katravella", 1978, Prishtinë, f. 245); "Nga pësimet gjithnjë nxirren mësim" (Kiço Blushi: "Beni ecën vetë", 1979, Tiranë, f. 247); "Gjurmët e kohës në faqet e një libri" (Zejnullah Halili: "Vendlindja shihet në zemër", 1984, Prishtinë, f. 256); "Poezi me mesazhe kohe e shprese" (Kismete Hyseni: "Më prit harabel", 1995, Prishtinë, f. 266); "Vargje të ëmbla për fëmijë" (Ndre Mjeda: "Përmbledhje vjershash për fëmijë", 1995, Prishtinë, f. 271); "Dashuri për Atdeun, Shkollën, Familjen" (Qamil Guranjaku: "Xixëllonjat e vogla", 1973, Lubjanë, f. 274); "Historia e një trembëdhjetëvjeçari" (Sotir Andoni: "Pranvera e madhe", 1973, Prishtinë, f. 278); "Poezi që burojnë nga jeta" (Rifat Kukaj: "Arushi piktor", 2005, Prishtinë, f. 281); "Dy vjersha të Vehbi Kikajt", f. 284); "Vepër për fshehtësinë nënujore" (Zyl Vern: "Njëzet mijë milje nën det", 1988, Prishtinë, f. 289); "Njerëzit: Bota e kompleksuar" (Svetlana Makareviq: "Zemrak", 1973, Lubjanë, f. 294); "Nëna ishte dhe mbeti Nëna" (Maksim Gorki: "Nëna", 1973, Prishtinë, f. 296); "Vepër e bukur dhe humane" (Video Podgorec: "Jevgu i bardhë", 1975, Prishtinë, f. 299); "Fati i një fëmijë fatkeq" (Viktor Hygo: "Gavrosi", 1975, Prishtinë, f. 303); "Ymer Elshani - shkrimtari më tragjik në botë", (2005), f. 307.

## KONTRIBUTET E HASAN HASANIT (16.01.1947 - 01.12.2020) në një "FAQE LIBRI" ... e në një "SHENJËZIME"


Nga Xhahid Bushati



Studiuesi Hasan Hasani heton imtësisht veprën letrare, teksta kumton problematikën dhe dukuritë e saj. Ai komunikon me lëndën drejt thellësisë së fjalës. E dokumenton veprën në pikëpamje të vlerave dhe riafirmton kujtesën, shpesh, të humbur të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Mund të përmend disa stacione, ku studiuesi Hasanit në raport me veprën parashtrohet (analizon) objeksionet e tij në një shumësi pamjesh, si: \*Moralizimi dhe didaktika. \*Gjinia, zhanri, gërshetimi mes tyre. \*Mënyra e rrëfimit të autorit. \*Koha e librit, gjurma e tij dhe shenja e realitetit. \*Intelektualiteti i poezisë si mision. \*Elementet fëmijërore si pjesë e botës së tyre në krijimet parashkollore. \*Mesazhet e veprës., etj.

## 3.

Studiuesi ka pranuar në të shumtën e rasteve të 'bashkëbisedojë' me një vepër të autorit. Veprat që merren në shqyrtim datojnë në këto vite botimi: 1964, 1968, 1971, 1973, 1978, 1979, 1984, 1995, 2005. Duke pranuar dendësinë e një date dhe përafëritë e saj, Hasan Hasani me vrotimet e hulumtimet e tij ka sjellë një kronikë të besueshme dhe realiste të zhvillimit të kësaj letërsie në këto periudha. Botimi i librit me studime edhe pse i distancuar nga dalja në dritë e veprave, gjatë analizës së tij në evidentimin e vlerave, u ka dhënë veprave një 'rizgjim', një 'rijetim', ku krahas faktit artistik, prania e kujtesës së librit gjallon e nuk fiket.



Laryshia e këndvështrimeve ka sfiduar njëtrajtësinë. Megjithatë, është një skedë në këtë "Faqe libri" që bashkon në disa pika përciptimin e librave. Konfiguracioni i kësaj skede është bazuar mbi kompozicionin e shkrimeve, që mendojmë se përvijohet në këtë mënyrë: \*Prezantim i profilit artistik të autorit dhe kontributit të tij në letërsinë për fëmijë e të rinj. \*Zbërthimi i veprës, kryesisht në fushën përmbajtësore. \*Përfundimi: njohja dhe rrezatimi i autorit, si dhe mesazhi i veprës.

Një skemë e tillë është e njohur. Por studiuesi nuk ka mbetur në këto caqe. Risetë i gjejmë në paraqitjen e tipareve autoriale, të shprehimësisë së tyre, pasurimit të elementëve në formë e përmbajtje, të veçorive dalluese, të figuracionit letrar, etj., të cilat bashkëlidhen pas një studimi të thelluar të një veprë a të disa veprave të autorit, të cilat, sigurisht, Hasan Hasani i merr në shqyrtim, në të cilat: \*Zbulon elemente poetike përmes shtjellitimit përrallor, të cilat gjenden të fshehura tek gjërat e fenomenet, të cilat na bëjnë të njohim kodin e substancën e poezisë së Mark Krasniqit. \*Veçantë dukuritë e poezisë intelektuale, rrezatimin e saj përmes motiveve të atdhedashurisë, socialitetit, didaktikës e lojës te poezia e A. Devës. \*I mëshon zbërthimit të personazhit kryesor te romani "Debatiku" i S. Vaqarit. \*Konfiguron qartazi periudhat historike, fikson kohën me përmaset e saj përmes pasqyrimit të reales dhe ircleales te "Trimi i fshatit Bardhë" të F. Reshpjes. \*Operon përmes nocioneve e raporteve të gjinive, dhe qasjes me veprat e të njëjtit autor, te romani "Princesha dhe bariu" i Q. Batallit. \*Vlerëson marrëdhëniet vepër-aktualitet (kohësia e veprës), të komunikimit brenda tekstit letrar dhe mënyrave e formave të të rrëfyerit, te "Djaloshi pas plepit" i A. Bunjakut e "Pëllumbat e kujtimeve" të A. Demollit. \*Thekson vlerat e legjendave, gojëdhënave si urë marrëdhënieje të vazhdimësisë së historisë dhe të ruajtjes së mesazhit aktual, te "Gjergj Elez Alia" të R. Ramabasë e "Bali Katravella" të Y. Shkreli. \*Vendlindja dhe fëmijëria, si gjurmë kujtese, bëhen objekt analize të poezive të Z. Halilit. \*Bashkëkohësia në vepër, elementet transformuese dhe ndikimi i dukurive në psikologjinë e personazhit, i ka "diktuar" dhe i zbërthen hollësisht te "Beni ecën vetë" të K. Blushit. \*Meditativja, imagjinativja, loja, humania, e përditshmja etj., si reflektim e mishërim në poezitë e R. Kukajt e K. Hysenit.

Në këtë polifoni shqyrtimesh dhe interpretimesh, gjejmë pasqyrim edhe rrugët e zhvillimit të gjinive e zhanreve të letërsisë për fëmijë e të rinj, ndërtim e struktura kompozicionale, mënyra ligjërimi e rrëfimi, dukuri të njohura e të reja në embrion, zhvillim e pasurim, etj., me një fjalë një skedë me një paraqitje të lakmueshme e me kompetencë shkencore. Ndaj, dhe nuk mund t'i harrojmë analizat shenjzuese të veprave të M. Krasniqit, Q. Batallit, A. Demollit, F. Reshpjes, A. Devës, Z. Halilit, K. Blushit, të cilat bëjnë dallim nga simotrat. Për rrjedhojë, kapitulli i emërtuar "Faqe Libri" gdhend qartë përmes një gjuhe profesionale një pjesë të fyturës së letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj me problematikën e saj, në periudha të ndryshme ecurie e zhvillimi.

## 4.

Katër vite më vonë, studiuesi Hasan Hasani boton librin "Shenjzime" (Përshtypje letrare). Sipas autorit Hasan Hasani motivi është ky: "Po vij para jush me një libër përshtypjesh letrare, titulluar "Shenjzime", ku gjetën vend njëzet e pesë vështrime librash, prej tyre njëmbëdhjetë libra për fëmijë."<sup>5</sup> Këto vështrime librash, këto qasje personale janë thjeshtë përshtypjet e mia për librat në shqyrtim; janë libra që i kam lexuar pa ndonjë imponim as obligim, por vetëm e vetëm nga dëshira dhe njëherësh hodha në letër atë që më bëri përshtypje, atë që la mbresa tek unë si lexues i pasionuar.<sup>6</sup> ... Mbes me shpresë se lexuesit do të më kuptojnë dhe gjykojnë drejt në paraqitjen e këtij libri, shkrime këto që për mua janë jo vetëm disa shenjzime dhe vizione për botën magjike të librit."<sup>7</sup>

Duke ruajtur komunikimin me librin artistik në disa plane të gërshetuara njëherësh, si në atë të krijuesit, studiuesit e lexuesit që funksionojnë dhe janë të paraqitura si shqyrtim letrar në shërbim të vlerave; Hasan Hasani nënvizon disa etapa të kësaj marrëdhënieje të çmueshme që paraqiten sipas kësaj skeme: - përshtypje letrare., - mbresa., - shenjzime., - vizione (apo përspektivë).

Libri "Shenjzime" mbart si strukturë të njëjtën fizionomi si ai i mëparshmi, i titulluar "Faqe Libri". Në mes tyre ka një ndryshim shqyrtues. Nuk kemi të bëjmë me vështrim recensionit që deri diku ishte tipar i librit të parë, tek "Shenjzime" kemi thellim në njohje, zbërthime e evidentime dukurish, analiza të hollësishtme në shërbim të kodeve të krijimtarisë të secilit krijues që merr

5 Hasan, Hasan: Shenjzime, FAIK KONICA, Prishtinë, 2011., Dy fjalë lexuesve, f. 5.

6 Po aty, f. 5.

7 Po aty, f. 6.

1 Hasan, Hasan: Leksikoni i Shkrimtarëve Shqiptarë (1501-2001), FAIK KONICA, Prishtinë, 2003.

2 Hasan, Hasan: Faqe Libri, FAIK KONICA, Prishtinë, 2007.

3 Hasan, Hasan: Shenjzime, FAIK KONICA, Prishtinë, 2011.

4 Hasan, Hasan: Faqe Libri, FAIK KONICA, Prishtinë, 2007., Dy fjalë rreth librit, f. 5 - 6.



në shqyrtim, ku vendin kryesor e zënë vëllimet poetike. Pikërisht, vetëm, për këta libra poetikë po shfaq disa mendime:

- Jo vetëm te "Kopshti i ëndrrave" që mbetet produkt analize, por studiuesi shkon më tej, shpërfaq tiparet e krijimtarisë së poetit Bardhosh Gaçe, tashmë një individualitet i spikatur në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj. Poetikën e tij e sheh te Vendlindja dhe rrënjët e saj, te epizmi dhe lirizmi, te metaforat e simbolet, te peizazhet dhe personazhet, etj. Është i drejtë mendimi se trunghi i kësaj poezie është i veshur me degë e gjethe ulliri, krahë pulëbardhash, brigje deti, valë, stërkala, hënë, qiell, guaska deti, rërë, etj.

- Ndonëse shkrimtari Qamil Batalli nga Kosova mbetet një emër i rëndësishëm në tregimin për fëmijë, kësaj radhe objekti i dëshmisë është libri "Zemërrarta". Kontributi i tij poetik në rrafshin e letërsisë parashkolllore paraqet interesa dhe çmueshmëri lidhur me mënyrën e qasjes dhe të paraqitjes. Gërshetimi i motiveve patriotike me ato edukative, të lojës me argëtimin, mbeten tharmi jetësor jo vetëm i prozës së tij por edhe i këtij libri, por edhe i atij me titull "Nisuni, pëllumbat e mi".

- Duke vështruar profilin e saj, aktualisht, Shahbaze Vishaj vjen si një triptik në letërsi. Ajo shkruan poezi për të rritur, merret me studime dhe është aktive në letërsinë për fëmijë, kryesisht me vëllime poetike. Studiuesi është ndalur te libri "Shegë vjeshte". Ai konstaton, veçanërisht disa tipare, si ajo e marrëdhënies me vjershën, me çdo ind të saj. Në këtë aspekt e përmbushje mesazhi, autorja ka një përputhshmëri shpirtërore brenda hapësirave të saj, me të vetmin qëllim që, lexuesve të vegjël t'u dhurojë të vërtetën e kohës. E kur flasim për të vërtetën e kohës, autorja tematikisht rreket të trajtojë dhe të flasë: për vetëdijen e lexuesit të vogël, për kujtesën historike dhe krenarinë kombëtare, për dashurinë për Vendlindjen e prindërit, të gjyshërve, nipave e mbesave, etj. Breznitë janë një poetikë e veçantë e krijimtarisë së saj. Mendoj që në këto vatra mbruhet magjia e poezisë së saj, e ndërtuar me një sistem të caktuar figurativ e ndërtim vargëzues herë me varg të regullt e herë me varg të bardhë.

- Këto vitet e fundit, shkrimtari Pandeli Koçi (pseudonimi letrar Sazan Goliku) me krijimtarinë e tij, veçanërisht në poezi e në përrallë është i pranishëm në letërsinë për fëmijë. Shquhet për trajtimin e temës sociale, pa moralizime e subjekte interesante të përditshmërisë saj. Poetika e njerëzores mbetet palci edhe i motiveve të librit "Mos harro se je njeri", që studiuesi ka përzgjedhur për të analizuar. Këndvështrimi i motivit, faktikja, realja dhe e drejtpërdrejta në organizimin e fabulës, e bëjnë poezinë e Golikut të freskët, të kapshme e me gjallëri jete.

- Shpirti lirik dhe heroi lirik, mbeten dy nga komponentët e krijimtarisë poetike të Kismet Hysenit. "Flas me Hanën" është libri i zgjedhur për objekt analize. Mendoj, që studiuesi Hasan Hasani në gjykimet e tij, në evidentimet e rrafshve tematike të librit në fjalë, na ka ofruar një model se si i duhet qasur një libri, e veçanërisht poezisë lirike. Arsyetimet dhe deduksionet, fjalori dhe sintagma e përdorur e rrisin më tej dimensionin e kritikut Hasan Hasani.

- Shkëlzen Zalli, me kontributet e tij në poezinë për fëmijë, padyshim, është përfaqësuesi më i shquar dhe më i talentuar i brezit të tij. Tiparet e tij shpërfaqen edhe në librin poetik "Shkronjat në shtëpinë e fjalës". I prirur drejt metaforave magjiplote fëmijërore, lodërtar në ëndjen e vargut, mosharrues i peizazheve të fëmijërisë e të Vendlindjes, etj. – janë disa nga veçoritë e personalitetit të tij që e bëjnë përmes talentit të tij të njohë psikologjinë dhe botës e fëmijëve. Të gjitha analizat që bëhen në favor të librit janë reale dhe të meritueshme.

- Emri i Erindë Rrahmanit në letërsinë për fëmijë është një emër shprese. Studiuesi Hasan Hasani ka bërë objeksion studimi dy libra të saj: "Gjithçka mund të ndodhë" e "Natën e mirë, hënë!". Librin e parë poetja e re e botoi në moshën 13-vjeçare. Karakteristikë e këtij libri të pa ndarë në cikle është se, portreti i saj plotësohet përmes motiveve të befta të moshës së saj. Ndërsa te libri i dytë poetik, jo vetëm që shënohet rritje e cilësi artistike, por motivet janë nga jeta e përditshme të para si një risi nga syri i poetes së re. Ndaj, ajo shkruan për flamujt e zemrave, gishtin që ia tregon rrugën, urën që lidh zemra, për një hënë e një yll dhe gjumin e pafund, çka fsheh jashtëku im, vjeshta në dollapin tim, ankesa e zeros... etj. Të gjitha flasin për një fjalor poetik plot fantazi dhe kurreshtje të Erindës së talentuar, që lë edhe shteg për interpretime.

- I shquar në prozën poetike për të rritur si zhanër, Ramadan Mehmeti herëpashere i "kthen sytë" edhe nga poezia për fëmijë. "Të kam zog", edhe pse libri është i ndarë në katër cikle, perceptimi mbetet i beftë. Figura e gjyshit dhe marrëdhënia e tij me mbesat e nipat mbeten modele letrare që duhen përqafuar. Zgjedhja e figurave letrare, magjia e dialogut, etj., përbën një botë të bukur, që kushdo e ëndërron ta jetojë, qoftë si gjysh a qoftë si fëmijë. Dhe kjo është meritë e talentit dhe kualitetit artistik të poetit Ramadan Mehmeti.

## 5.

Kontributet e studiuesit Hasan Hasani në fushën e kritikës letrare kanë vlera dhe ndriçojnë disa pika të rëndësishme të udhëtimit, nëpër vite, të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Kanë edhe një vlerë tjetër. Librat "Faqe Libri" dhe "Shenjzime" sado-pak plotësojnë ende boshllëkun që ekziston në lëvrimin e kësaj fushë të rëndësishme që evidenton dhe përcjell vlera librash e autorësh, përcjell jetësimin e tyre. Kanë edhe një vlerë tjetër. Janë ndihmesë e rëndësishme për hartimin e një Historije të Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj së cilës i ka ardhur koha të jetë më e kompletuar, për procesin e saj zhvillimor, për statet e saj, për lëvrimin e gjinive dhe zhanreve të saj në rrugëtimin letrar, për dobësitë dhe risitë e saj, për ndriçimin në mënyrë sa më plotë të ekzistencës dhe panteonit të saj.

Shkodër, shkurt, 2024

## (Vijon nga faqja 5)

mbështjellë rreth vetes. Instiktivisht desha ta largoja se rrugës përballeshim me të njohur, që po na shihnin habitshëm, por ai më kundërshtoi dhe më tha: Jo krahu që nuk do ta heq, por do thërras me të madhe: E mora Vllasovëëëë! ... Në vizitën që bëmë, tek familja Sallaku, sapo u futëm brenda, ai iu tha: Po ju jap një lajm që do gëzoheni, kjo është nusja ime! Ajo ishte darka e parë që festuam mes miqsh dhe unë u ndjeva si në qiellin e shtatë.

Kujtimi Spahivogli për mua ishte dhe mbetet njeriu i vlerave dhe virtyeteve të rralla. Nuk mund të veçoj vetëm një vlerë. Ai ishte një univers, brenda të cilit merrte frymë Njeriu i Madh në të gjithë dimensionin e të qenit njeri, aty ishte artisti, me përmasat e një uragani gjithëpërfshirës, aty ishte burri, miku dhe shoku që rrallë, shumë rrallë mund t'i gesh në jetë.

Lindja e vajzës ishte një mrekulli i vërtetë, një gëzim i madh sepse, unë doja të ishte vajzë dhe kaq ngulmuese m'u bë kjo dëshirë, sa që vetvetiu m'u krijua një siguri gati absolute, që do të lindja vetëm vajzë dhe vajza erdhi! Atë ditë kemi qenë të lumtur dhe vetëm të lumtur!

## Rikthim te poezia

Në poezi ajo zgjon si me magji adoleshencën dhe rininë, rininë e ëndrrave të bukura. Pastaj dëgjojmë zërin e Vllasovës nënë, një zë prekës, i ngrohtë, intim, teksa i flet nga larg Anit: "Ti mos më pyet ç'më ka ndodhur / Pse jam mërzitur, pse nuk qesh / Ndër qindra ditë që ka viti. / Ndodh dhe mërzitje që të kesh".

Po më i veçantë, më i ngrohtë, më drithëruar, është zëri i Vllasovës gjyshe. Emri "TIM" nuk është thjeshtë emri i nipit bukursh midis moshës 3 dhe 4 vjeçare, ose më i madh në librat e tjerë të poetes. Emri "Tim" është metaforë shumë e gjetur:

"Ende s'i kam treguar /  
përrallën e parë tim nipi, /  
Balonën e parë me të /

S'e kam ngritur..." metafora "Tim është shpresë, e ardhmja kur:

"T'u këndojmë zogjve /  
T'u rrokasim foleve /  
Nga s'bëri /  
Fjongo të zgjedhim ?  
T'ua hedhin reve".

Më kujtohet, që në librin e saj me titullin kuptimplotë "Kthema diellin, Tim", diku më qëndër të librit (dhe jo rastësisht janë vendosur këtu) janë 4 a 5 poezi, që përbëjnë nënështresën e humbjes, ndarjes, mallit, dashurisë së prerë befasisht në mes. Janë vjersha, ku zëri i poetes ka ngjyrë gri, një gri e rëndë vjeshtodimri, me qiell të ulët, ndoshta pa erë dhe shi. Dhimbja është në kufijtë e skajshëm, por pa britama. Malli është tronditës, por i brendshëm si ca gjëmime të vjeshtës së tretë.

Vinir re:

"Vrasja ishte pa krismë, /

Përgjakja pa shtatë u bë. Në vite, dy skajesh qëndruam, / Na ndanë, na vranë dhe... asgjë!"  
Etj, etj.

Unë do të thoja se këto poezi përbëjnë vullkanin e fshehur të mallit gërryes ose epiqendrën e dhimbjes. Ato mund të lexohen ngadalë, vetëm me zë të ulët, ndoshta janë në kufijtë e pikëtakimit dhe ndarjes.

Vllasova Musta ka zërin e saj lirik në poezi. Ajo është vëzhguese e hollë, që e do jetën, i gëzohet të dielave, shkon në mbretërinë e zogjve përgjithnjë, i vjen hëna në shtrat dhe nuk e lë të qetë të hapë derën për të prituar miqtë ose e lë atë gjithmonë të hapur. Ajo udhëton e gëzuar në trenin e jetës, apo hipur mbi krahët e erërave, bëhet edhe vetë erë, i këndon vjeshtës me një delikatesë që vetëm poetët dhe vetëm ata mund ta bëjnë:

"Po vjen vjeshta  
U thoni vajzave të marin me vete/  
Një rrobë të lehtë/ krahëve ta hedhin/  
Se mbrëmjet spërkaten, me vesë".

Poezia plotëson humnerën, që shtrihet mes të sipërme dhe të poshtme së shiritit, mes perëndive dhe njerëzve, shkruan në një nga esetë e tij shkrimtari i madh Stefan Cvajgu. Poetja është gjithmonë në lëvizje, në rrugëtim dhe ajo këto hapësira apo mbresa rrugëtimesh të përhershme, i hedh nmrekullisht në vargje. Lexoni poeten dhe do t'u duket sikur bashkë me të ecën në hapësira qiellore pastaj ulesh në brigje detesh, lumenjsh, rrugëton në Mitrovicë, për të takuar vajzën kosovare me emrin Çamëri(Prof. Agim Vinca, që ja kam dhënë një nga librat me poezi të Vllasovës dhe e ka pëlqyer, para disa ditësh më shkroi, se vajza nga Mitrovica me emrin Çamëri, të cilën unë e njoh (është e bija e poetit Jakup Ceraja), ia nisa me celular poezinë e Vllasovës kush-tuar asaj (Njoha një vajzë në Mitrovicë). Më pyeti se a e njoh

autore; unë i thashë jo, por poezine e saj po),gjendesh në Venecia, Gjermani, brigjeve të Drinit në Strugë, rikthehet në aeroportin e Rinasit dhe ndjek qiellin e Tiranës dhe avionin që zhduket në re, me dy dashuritë e mëdha të poetes, nënë dhe gjyshe: atë për Anin dhe Timin.

## Rrëfimi i tretë

Filloi të dilte në pah një vorbull e frikshme, lëvizëse që nuk po kuptohej se ku do të ndalte. Goditja ra mbi Todi Lubonjën dhe Fadil Paçramin. Ky i fundit, ishte jo vetëm anëtar i Komitetit Qendror të Partisë, por edhe njësi si një nga dramaturgët më të suksesshëm. Kujtimi kishte vënë në skenë disa prej dramave të tij, ndër të cilat: "Shtëpia në bulevard", "Ngjarje në fabrikë" etj. U organizuan mbledhje të kolektivave, ku u kërkua që të dënohej ky "grup armiqësor". Kujtimin e përfshinë në këtë grup duke e etiketuar si mbështetës të Fadil Paçramit, sepse ai nuk pranoi të ngrihej e të fliste kundër tij. Filluan të bëheshin mbledhje të gjata në Akademinë e Arteve, ku ai ishte pedagog dhe kujtoj një natë, në orët e vona, pas mesnate, kur e prisja jashtë, me vajzën e vogël në karrocë, deri sa të mbaronte mbledhja. Kur doli, ishte shumë i tronditur dhe më tha: "Ata duan, që unë t'i kundërvihem Fadilit, por unë, ç'kam pasur për t'i thënë, probleme pune, ia kam thënë ballazi, kur të tjerët nuk guxonin kurrë të flisnin. Tani, unë nuk munden t'ia rikujtoj atij, ato që ia kam thënë njëherë, vetëm e vetëm për ta groposur. Sepse unë dua, që edhe pas njëzet vjetësh, kur ta shoh Fadil Paçramin, ta shoh drejt e në bebëz të syrit e mos të ul sytë para tij".

Nuk kam për ta harruar kurrë me sa vendosmëri m'i tha të gjitha këto, që më tepër se sa një shpërthim i kurajos dhe karakterit të tij të fortë, më tingëlluan sikur kishte nevojë t'ia thoshte edhe njëherë vetes me zë të lartë.

Pikërisht në këtë kohë po vinte në skenë e Teatrit të Rinje dramën e Majakovskit "Banja", e cila fshikullonte "aparatchikët" apo zyrtarët e lartë, që harronin se në shërbim të kujt ishin dhe i jepnin vetes atributet e perëndive. Konceptimi i tij regjisorial, mizansenat dhe çdo detaj tjetër ishin ndërtuar në mënyrë fantastike dhe krejt shfaqja kishte një frymë moderne dhe tingëllojëse të fortë fshikulluese. Shfaqja u quajt si kundërvënie ndaj regjimit socialist. Fillimisht e hoqën nga puna si pedagog, më pas dhe nga Tirana dhe e çuan në një Ndërmarrje Bujqësore të Fierit. E përjashtuan nga partia, ku kishte hyrë që në moshëm 16 vjeçare. Kjo ishte një goditje fatale që erdhi me shpejtësi rufeje.

Pas kësaj, periudha në vazhdim ishte e pashperë për të ndryshuar situatën, ajo vetëm përqeshësohej duke u rënduar më tepër. Mua më shikonin si prenë që po i avitej dita e goditjes. Kudo më drejtohej pyetja: Po ti, si do të bësh?! E vetmja gjë, që nuk e mendoja kurrë se do të ndodhte ishte ndarja. Presionet ishin nga më të ndryshmit, nga më të frikshmit për të nesërmen që më priste mua dhe familjen time. Ika nga shtëpia, pa thënë asnjë fjalë, nuk kisha kurajo të thosha asgjë. Vetëm ika me vajzën 12 muajshe në duar duke lënë zemrën mbrapa. Ajo mbeti aty, në atë shtëpi, tek Kujtimi. Ishte një gjëmë e pakrahasueshme, që mbeti e gjallë gjatë gjithë jetës sime.

U ndëshkua artisti, u vra njeriu u shkatërrua familja.

## Dritarja e hapur e poezisë dhe jetës

Ajo jeton në Tiranë, por është e lidhur pazgëjmërisht me Gjermaninë. Në Gjermani prej vitesh ka krijuar strehën e saj familjare Ani,vajza e saj e shtrenjtë. Ani, thotë Vllasova, është jo vetëm bija ime, por shumë e shumë më tepër se kaq. Ajo është shoqja dhe mikja më e mirë, është krijesa më e dhimbsur dhe më e përkushtuar që do të ëndërronte të kishte një nënë. Unë e kam këtë mrekulli dhe kjo quhet Ani Spahivogli... Në shumë drejtime Ani është kopje e Kujtimit. Është artiste në shpirt e në jetë, është vajzë me karakter të fortë, i buron natyrshëm mirësia dhe përkushtimi për të tjerët. Është model i të atit.

Vllasova kinse jeton në Tiranë, por shpirtin e ka atje, në Gjermani, ku tashmë është madhuar nipi i saj, Timi. E kam parë që të vogël Timin, kur vinte te gjyshja e tij në Muzeun Historik Kombëtar. Ajo përgjërohet për Timin, sepse siç shkruan në librin me poezi "Kthema diellin, Tim" (Tiranë 2006)... "ti mban emrin e atij që mbeti Perëndia ime". Ai mban jo vetëm emrin, por i ngjan shumë-shumë gjyshit të tij të paharruar.

E qetë, me vështrim të butë, e heshtur përtej heshtjes, lirike dhe e brishtë, herë-herë me një pikëllim a trishtim, që shfaqet në portret, veçanërisht në vështrimin e saj si dallgëzime të trazuar vitesh, ose stinë ngricash. Kjo është nëna, gjyshja dhe poetja Vllasova Musta. E pandryshuar ka mbetur dashuria e saj për jetën, me gëzimet dhe hidhërimet e saj dhe ku "si degë e harlisur i vjen pranvera, që i troket xhamave". E pandryshuar, që nga fëmënia dhe rinia, ka mbetur ndjeshmëria për natyrën, qiejt e hapësirat e paana të tyre, lindjet dhe perëndimet e diellit, stinë e harlisur të pranverës dhe erërat, shirat e vjeshtës, dëborë, zogjtë që i vinë në dritare, fëmijëria që e merr në duar, Gjirokastra, shpirti i babait dhe nënës dhe ai i Kujtimit, zërat e dy vëllezërve poetë, Rolandit dhe Yllit, e qara e parë e Anit dhe zëri i Timit, monologjet gërryese në netët e vetmisë.

E pandryshuar tek Vllasova Musta ka mbetur shpirti i saj i ndjeshëm dhe dritarja gjithmonë e hapur e poezisë së saj.



Nji djalë i ri, si Marin Shita, me një pafajësi të humbun që vihet me e rrëzue diktatorin me sy.

A e keni parasysh atë lloj romani që me elementet e ndërtimit vazhdon me ju mbajtë vjerrë edhe mbasi t'ia keni mbyllë kopertinën e fundit? I tillë është romani i autorit Primo Shllaku, titulli i të cilit jo rastësisht ndërtohet me tri P – “Pesha e Padurueshme e Pafajësisë”. Ky aliteracion na krijon një bashkëtingëllim delikat, tue i ofruar lexuesit cilësi lirike që në titull. Kjo është edhe një tjetër dëshmi se kemi të bajmë me një autor sqimatar, ku çdo bashkëtingëllore e zgjedhun me kujdes rezonon me thellësi poetike.

Gjuha, gjetjet, qasja, skenat, personazhet, karakteret bindëse, marrëdhëniet emocionale, mënyra e të rrëfymit, ndërtimi unik, dinamika, komploti tërheqës dhe ritmi i shkëlqyeshëm bajnë që ky roman të vlerësohet si kryevepër e autorit.

Sot kur vlerat artistike letrare janë të shkërmoquna dhe kemi mungesë kritike të konsolidueme, është për t'u përsëritur të guximtë intelektual i autorit për me e sjellë një roman të ndërtuar mbi katër shtylla – pafajësinë, lirinë, luftën dhe moralin – që mishnohen drejtpërdrejt me karakterin e individit. Pra, ky roman na e shpërfaq një autor të mirëformuar, të mirinformuar e të mirëpozicionuar, siç është Primo Shllaku.

Autori shkruen gëgnisht, e megjithatë romani nuk është i gjithi në këtë varietet gjuhësor. Tue synue një kuadër të ngjyrosun edhe gjuhësisht, autori ka ndërtuar edhe dialogë në dialektin toskë, me ç'rast bahet edhe vetëkarakterizimi i personazheve. Asht e qartë se autori këtë e ban me qëllim që të potencojë faktin se komunizmi ishte ideologji me mbështetje të gjatë në jug të Shqipërisë.

Metadiskursi i përdorun e mban të angazhuem lexuesin gjatë gjithë kohës. Përpos gjuhës poetike, autori njihet edhe për fjalorin e pasun. Përmes konstruktit gjuhësor ai shmang metoniminë, tue na pru fjalë jo aq të rëndomta, si tipare gjuhësore të stilit vetjak: shkrythje; vjegësa; fojleta; bazhgarile; lodërtinë; krahishtonte; jerevi;

Primo Shllaku, “Pesha e padurueshme e pafajësisë”

# NË KËRKIM TË NJË TJETËR LIRIE

Nga Vlora Ademi

vandakë; sheneshin; vërgjillta; bizute, e qinda tjera.

Skenat, që shtjellohen nga një pozicion krejt i zakonshëm i një djali hidraulik e fjalëpak, i vetësakrifkuem pvetëdijshëm në pafajësinë e tij, deri tek energjia shpërthyesë e synit të vet, bajnë me kuptue se romani fillon pikërisht me të pazakonshmen. Autori ka ndërtuar me saktësi skena të sinkronizueme me dialogje diakronike, nga ku edhe zërthehet metafizika e romanit dhe doktrina e një periudhe.

“Vilja ishte e madhe dhe vjegësa e saj e trashë. Një herë forma e saj iu duk si hartë, si harta kryeposhtë e nuk e di cilit vend, por ashtu iu duk, si hartë shteti”. (f. 9)

Romani të ban me e ndie objektivitetin përballë subjektit dhe epokës. Në njetën anë janë vitet 1943-45, e në tjetrën përcaktimi i identitetit të një brezi. Realisht, periudhë gjatë të cilës është vëjtë kriza e identitetit. Në veçanti, ajo e identitetit individual. Dhe meqë autori ka një dhunti të jashtëzakonshme në ndërtimin e personazheve, gjithë barrën e kësaj periudhe ia ngarkon mbi supë kryepersonazhit, Marinit.

Marini, djalë krejt naiv, ndodhet përballë një epoke të egër. Jo rastësisht, autori


e ballafaqon moshën e tij (19 vjeç) me brutalitetin e kohës. Madje edhe profesioni i tij prej hidrauliku nuk është përzgjedhë pa u shestue mirë.

Nuk është se autori ka përdorë elemente fantastike për ta krijuar një protagonist interesant, por me shumë takt, personazhin kryesor të romanit na e prezanton si një hidraulik që ka një fuqi të jashtëzakonshme të synit. Këtu nis intriga dhe tensioni. Këtu njiherësh nis edhe polemika direkte me lexuesin. Marini merr mësysh. Ai shiton. Nga këtu, jo pa dashje, Marini është Marin Shita.

“Ndjeu forcën e tij dhe ia tha vetes troç: ‘Unë e këpus vilen e rrushit me sy’”. (f. 12)

Këtu fillon provokimi i pafajësisë së personazhit. Kjo është një nga gjetjet e autorit për me e mbajtë të zgjueme vigjilencën e lexuesit.

Kjo ndodh me Marinin: rritet, burrohet. Bie në dashuni (mbase me dy gra njiherësh), njena grue e emancipue nga jugu i vendit, që për të parën herë e kishte ba me mendue edhe përtej gypave të ujit, dhe tjetra, zgjedhje (e zgjidhje) zakoni. Vihet përballë sprovave të çuditshme – arrestohet në ditën e fejesës, ban burg, lirohet, ballafaqohet me ish-të fejuemen dhe nis e merr vendime



krejt të paparashikueshme, tue e vu në pah kapërcimin e vetvetes dhe tanë peshën e pafajësisë njikohësisht.

“Marini është një personazh që ka ra në kurthën ekzistenciale të epokës së vet, është ba objekt i një loje mistike e globale, askund pyetjeve që ngren ai mbas kalimit të tij, autori nuk u jep përgjigje, sepse përgjigja do të kishte randësi për vetë personazhin, e jo për ne që tashma dimë goxha për metonimitë e asaj epoke, si dhe për masat shtrënguese preventive ndaj lirive themelore të njeriut e të individit” thotë autoi Shllaku në intervistën ‘Aventura e Pafund e Zbulimit Individual’ që bana me te për revistën letrare ILLZ.


Mirë që autori nuk ka qëllue lakonik. Ngacmimi i imagjinatës së lexuesit dhe krijimi i një atmosfere ankthi janë mjeshtria e tij. Autori britanik E.M Fortser, Marinin do ta quante “personazh i rrumbullakët”, e kundërta e “një personazhi të sheshtë” (ose dydimensional) i cili e mishnon “një ide apo cilësi të vetme”. Ndërsa “një personazh i rrumbullakët” sikurse Marin Shita, i përgjigjet ndryshimit: “është në gjendje me befasue [lexuesin] në një mënyrë bindëse”. Pra një personazh i vetëm mundet me shërbye si fokus kryesor i romanit.

Si protagonist, Marini zbulon, ka sekrete, bind, gabon, ban ndryshime, madje edhe josh.

Sado që romani provokon edhe skena krejt të tërthorta erotizmi – “Ai e kapi me duert e tij të forta trupin e trumës... Lidhja u dha dhe ai filloi ta zhdivillonte trumën e randë prej gize, derisa ajo u lirue krejt dhe i peshoi mbi krah djaloshtit” (f. 47) – prapëprap libri është i privuem nga erosi.

Me stilin e tij të qëndrueshëm, autori nuk ka sjellë detaje të thella erotizmi, por brydhtas është ndalë vetëm te joshja si një akt tundimi, ndikimi e magjepsje, duke ngjallë vetëm shpresë dhe dëshirë. Mbase, si personifikim të kohës dhe rrethanave, autori Marinin na e len veç platonik. Një djalë që josh me pafajësinë e tij. “Kur Tatjana i kishte thanë haptas që të ngrente shikimin dhe ta shifte në sy, djali kishte pasë idenë se, po t'i çonte sytë dhe ta shifte pak, atëherë sytë e saj apo edhe sytë e tij do të thyeshin copa-copa”. (f. 58)

Në thelb, në mënyrë paralele, në roman zhvillohen dy lloje konfliktesh. Njeni, i mbrendshmi, që ndodh mbrenda kokave të personazheve dhe tjetri, i jashtëmi, që prek personazhet, por që njiherit ndodh jashtë kokave të tyre. Përmbysja shfaqet diku në mes të romanit. Takimi i parë i Marinit me detin e përmbys komplet pjesën e parë të romanit. Mbas këtij takimi, jeta e hidraulikut, personazhit me emnin Marin, ndahet në dy epoka. Kjo është situata ma delikate ku autori ven në dukje metafizikën e qenies, si përpjekje për me krijuar një përshtatje të Marinit midis vetes dhe pjesës tjetër të realitetit. Për aq sa Marinit – sikurse edhe neve – i duhet të mishnojë orientimin ekzistencial në mënyrë që të ndërveprojë me mjedisin e rrethanat, ai përballë me një urdhën të pvetëdijshëm nga brenda për me



PRIMO SHLLAKU

pesha e padurueshme  
e pafajësisë

OnufriRoman



i dhanë kuptim asaj që po ndodh me te dhe me e përshtatë me veten, si pamje e qenies së tij. Në fakt, kjo përballje e përban krejt elementin metafizik të romanit.

“Marini ishte mbushë plot me detin që e kishte pa për së pari atë ditë dhe po largohej nga bregdeti me idenë se deti kishte qenë i zemëruem dhe ai sa kot ishte hangër sysh me të. Por gjithsesi e hetonte brenda tij një shqepje të diçkaje dhe një si fillim të diçkaje tjetër.” (f. 133)

“Bota po i tregonte Marinin diçka ma shumë nga vetja e saj dhe ai po ndjente interesin e tij të papërballueshëm për ta lanë mbrapa gjithçka që për të kishte qenë një normalitet.” (f. 134)

Asht e dukshme se situatat në roman janë vendosë kundër çdo rastësie po aq sa edhe personazhet. Ato kenë emocione të vërteta, janë në ankth dhe pasiguri të plotë.

-Vidhe, vidhe!

Zefi nuk u kishte besue veshëve.

-Si thatë, atë i shenjtë? – kishte shqiptue me çudi të thellë Zefi.

-Po, po, atë që ndigjove...

Zefi po e kqyrte priftin si i çakërdisun.

-Vidhe dhe qetësohu... Përfundishmisht... (f. 244)

Ky dialog tronditës në roman ndërthur një filozofi sa biblike aq edhe kafkiane, e megjithatë, veçan dyjave, duket se prej tij buron edhe një e tretë – ajo e autorit.

Ndonëse në letërsi tema e pafajësisë shpesh shfrytëzohet si mënyrë me e nxjerrë në pah humbjen e fëminisë, te romani “Pesha e padurueshme e pafajësisë”, tue iu shmangë me shumë delikatesë emrave e termave, pafajësia portretizohet me figurën e Krishtit. Vlerat e palëkunduna morale të tij theksojnë qartë idenë e pafajësisë, petk që fillimisht i asht mveshë Marinin. Krishtenimi vendos theks të veçantë në konceptin e pafajësisë, i cili asht i lidhun ngusht me idenë e mëkatit.

Dhe nëse në njenën anë Kafka thotë: Filloni me ate që asht e drejtë dhe jo me ate që asht e pranueshme, në anën tjetër, autori Shllaku thotë: Vidhe dhe qetësohu... Përfundishmisht...

Me këtë rast, filozofia mbi të cilën autori e ndërton romanin e angazhon lexuesin në një sentencë që nxit në reflektim ose që çon në njëfarë depërtimi a ndriçimi. Në të njëjtën kohë, ka situata që edhe nxisin polemika me te.

Narrativa e romanit provokon. Situatat e krijueme brenda treqind e katër faqeve,

personazhet intriguese si Tatjana e Batoja ose edhe mefistofelikë e cinikë si Zef Vetima, me të cilin Marini njihet gjatë qëndrimit në burg, nxitin diskutime të zhvillueme përmes një lente filozofike.

Filozofia e autorit te “Pesha e padurueshme e pafajësisë” na ban me kuptue se liria dhe pafajësia nuk shkojnë bashkë. Liria e mendimit, mandej edhe ajo e veprimit, fitohen vetëm tue e lanë anash pafajësinë.

“Unë e shof, - i kishte thanë prifti me njëfarë kthejlltësie, - se ti nuk ke gja me Manolin. Ti ke problem, ti nuk duroke pafajësinë tande djalosh...” (f. 243)

I bazuem në idetë e absurdit dhe ekzistencializmit, romani direkt provokon moralin. Metafora e tjetërsimit të individit koicidon me “Metamorfozën” e Kafkës. Po kështu i shpreh ankthet shqetësuese ekzistenciale të ekzistencës tonë dhe të botës në të cilën prap jetojmë kaq paparashikueshëm ne edhe autori i romanit në fjalë, Primo Shllaku.

Në kërkim të një tjetër lirie ose të ridemisionimit të lirisë së tij, Marini thyen rregullat e moralit bashkë me frikën.

Mbasi me sy e kishte rrëzue vilen e rrushit, e kishte praptue kalin e oficerit

bashkë me te, e kishte ba copë-copë pasqyrën në burg, e kishte ndrydhë iluzionin për Tatjanën dhe, mbasi ishte përballë edhe me ish të fejuemen, gjendja prej shtatzane e të cilës përgjithnji e kishte tëhujtë dhe e kishte ndihmue me i nda mendimet, Marini nisjet drejt kryeqytetit me e rrëzue edhe diktatorin.

Marinin e kishte tjetërsue pafajësia e vet.

Kjo asht intriga e fundit që autori ua ban lexuesve. E nis Marinin për në kryeqytet, (mbase edhe me e takue Tatjanën!) dhe këtu e mbaron rrëfimin. Pjesa tjetër i mbetet imagjinatës së lexuesit.

Sikurse “Lehtësia e papërballueshme e të qenit” e Milan Kunderës, tashma edhe “Pesha e padurueshme e pafajësisë”, tue e sfidue konceptin e përsëritjes dhe virtytin njerëzor, i vendosin këto përballë vlerave të lirisë, tue na ba me kuptue se që të dy, në formë të njëjtë, kanë guxue me e sfidue filozofinë niçiane.

“Pesha e padurueshme e pafajësisë” asht një roman provokues dhe thellë i menduem, i cili gjatë leximit të ban me u përfshi drejtpërdrejt me filozofinë. Prandaj edhe na le shijen e një romani të përqendruem qartë në filozofi.

28 mars 2024, Prishtinë



Karikaturë nga Arben Mexsi



E dhe te ky roman i fundit, "Parisi vret", ndihet se Mira Meksi ka stof letrar. Bën një letërsi të kohës. E ka flakur petkun e vjetër të letërsisë së vjetër dhe një tjetër ka veshur. Menjëherë sa e lexon e ndjen verbin e shkrimtarisë së saj, ndjen koreografinë e fjalës, shijon ecejaket e një semantike që lodron midis të thënës dhe të pathënës, të shndritshmes dhe të errtës. Pastaj, më ngjan, se nga romani në roman ajo di të luaj gjithnjë e më mirë me kureshtjen e lexuesit, e mban nën trysni rrëfimin, krijon ca suspansa që një lexues i kualifikuar vërtet nuk hutohet asish porse, nga ana tjetër, grishet të udhëtojë tok me trillin e shkrimtares viseve të "pashkelura", aty ku buisin jetë njerëzish të shquar me gjeniumet e tyre profesionale, morale, karakteriale e kombëtare.

Po këtë ndjesi pata edhe nga leximi i romanit "Parisi vret". Po pse vret Parisi, ky metropol i luksit, i estetikës, i historisë, i erotizmit, i qelqeve, i modës, i arit dhe i bizhuve; pse vret ky Parisi i kalldrëmeve, kafeneve dhe hoteleve mbushur plot histori, i arkitekturës, i katedraleve dhe pallateve mbretërore? Shkrimtares herë pas here i duhet të shëtit hijeshive të "kryeqyteti të botës"; krijon një farë hutie të lexuesi me përshkrimet e ndezura. Këtë e bën në funksion të subjektit i kthyer në lëndën e një historie të njohur sa dhe të panjohur, e lidhur me emrin e një shkrimtari të shquar shqiptar, që mendja menjëherë të shpie tek Ismail Kadare. Përkritjet janë kaq të shumta dhe kaq të drejtpërdrejta, sa edhe sikur të thuash se ky personazh me emrin Martin Gjergji është një sajese letërsie, njohja jonë historike dhe krejt aludimi të thonë të kundërtën. Por kjo s'ka rëndësi, jemi në fushën e letërsisë, pra dhe të fantazisë, të mënyrës se si një personazh, qoftë dhe historik, përshatet me ligjësitë estetike të letërsisë si të tillë, shndërrohet ose në aluzion, ose thjesht i modifikohet emri për të konfirmuar elementet e ngjashmërisë "fenomenale", e të mundshmes, edhe pse jo gjithçka mëvetësohet aty si kjo apo ajo bëmë e njohur e shkrimtarit tonë. Mëpastaj, përshkrimi i një "Parisi që vret", pra i një Parisi të kurtheve, kthinave dhe jo i luksit, i bukurisë, shndërrohet enkas në një dekor të mbushur përplot ngjyra e mrekulli sepse, në këtë rast, kjo mënyrë kryen rolin e kontrapunktit, e asaj që fshihet, që krijon ankth, që është përtej dukjes, kredhur thellë, në basifondet e krimin. Unë kam pasur rastin të shkojë me dhjetëra herë në Paris dhe, si të thuash, peyzazhin përshkënditës siç jepet nga pena e Mirës, e përcjell pa mrekullimin e një syri tjetër, që shkel së pari aty. Mbase një vetëpërbajtje empathie dhe poetizimi mund t'i bënte mirë pandehmës së zymtë që romani e mban si mjet ankthi dhe suspansi. Por siç thashë ky është një "dekor" i qëllimtë, i adresuar për shqiptarët që shkëlqin shumë rrallë në atë qytet të ëndërruar asoherë, qytet shprese dhe lirie ku do donin të jetonin e ku përfshihen edhe dy personazhet kryesorë të romanit, shkrimtari Martin Gjergji dhe e dashura e tij Jurendina Muzaka.

Martin Gjergji, shkrimtari që për politesë nuk po e quajmë Ismail Kadare, pas një kohe privimi për të promovuar letërsinë e tij në Francë, duket se një dorë e pabesë, e kredhur në dyshimet ndaj tij si armik i regjimit, kërkon ta provokojë duke i dhënë lejen e një vizite pune në Paris, por tashmë pa shoqërues, pra ku ai mund të shfaqej e vepronte lirisht jashtë syrit përgjues të policisë sekrete. Jemi në një situatë politike në prag shpërthimesh dhe ndryshimesh të mëdha. Muri i Berlinit ka rënë. Kasta politike e vendit është trembur. Urrejtja vlon, rrebelime dhe akte protestash kanë nisur të shfaqen gjithandej. Udhëheqësi komunist Ramiz Alia provokon intelektualët shqiptarë në një takim të thirrur prej tij për të testuar pulsën se deri ku shkonin kërkesat e disidencës së fshehtë shqiptare: Pluralizëm politik apo pluralizëm "ideologjik"? Pikërisht në këtë pikë-kthese dhe panik që e kishte përfshirë kastën komuniste, shkrimtarit Martin Gjergji i sajohet enkas një shkuarje në Paris, kinse për të botuar në frengjisht romanin e tij të fundit, por në fakt për ta vrarë atë. Pikërisht këtu nis e bitis një aventurë ecejakesh e retrospektivash, që e sjellin shkrimtarin sa në përjetimet e tij dramatike në Tiranë, sa te një dashuri e lënë peng, sa te dyshimet dhe ankthi që e bart me vete si pamundësi të mbërritjes së lirisë në vendin e tij të vogël nën dhunë, aq dhe në dyshimet që e brejnë për një vrasje të mundshme nga policia e fshehtë, mbase nën petkun e një dashurie hakmarrëse. E gjitha kjo vjen e bashkëshoqëruar nga ankthet që

Mira Meksi, "Parisi vret"

## Midis të vërtetës historike dhe të vërtetës letrare

Nga Josif Papagjoni

Mira Meksi duket se është në vllugun e saj si romanciere. Bën një letërsi që ta rrëmben syrin, më së pari, për stilin e saj, gjuhën, fjalorin e pasur, krehjet e hijshme të një rrëfimi e ligjërimi mbresëlënës që epohet kah ngjarje të thukëta të historisë së shqiptarëve, përzier me mite, legjenda, kulturë librore, personazhe të shumënjohur. Kam lexuar disa nga romanet e saj. Më ka lënë mbresa "Frosina e Janinës", me atë udhëtim liriko-tragjik në ankthin e një dashurie të tradhtuar dhe një krimi përvuajtës; pastaj erdhën romanet "E kuqja e demave", "Mallkimi i priftëreshave të lirisë", "Diktatori në kryq". Romani "Kutia e Agatha Christie" më është dukur një befasi gati e parrokshme, diçka si e padëgjuar për personalitetin dhe dashurinë e njërit prej më të ndriturve të shqiptarëve të fillim shekullit XX, Mit'hat bej Frashërit. Në çdo roman të ri që shkruan ajo duket sikur na thotë zëplot po atë fjalë: "Miq, letërsia është një zonjës e brishtë plot farfuri, strehëza ime, ajo që e dua fort e ku preh shpirtin tim, ajo që më nxit e më prin udhëve të fantazisë, trillit, hijeshisë së fjalës, rrjedhës së ligjërit, hip e zbrit ngjarjeve, ca të ndodhura e ca të fantazuara, gdhend karaktere, u jap frymë konflikteve, i kthej situatat nga dukja normale e latente në befasime e thagma çmeritëse, përdor si karrem përkritje të "pabesueshme" që vijnë prej llojit të thrillerit, ku një krim dhe e fshehtë thellë rri veshngritur dhe krijon te ju ankth".

ai përjeton në Parisin shkëlqimtar, po aq të mistershëm e vrasar. Në arkitekturën e romanit shfaqen nyjat dhe pilastrat kryesore: shkrimtari si pika e epërme e vetëdijes së një kombi, dashuria si premisë lartësimi, artisti dhe pushteti, tirania dhe liria, krijimi i pastër dhe kompromentimi i tij nga ideologjia, përkatësia letrare dhe përkatësia politike.

Brenda kësaj siudhese marrëdhënies të lidhura së bashku, narrativa e Mira Meksit shkon e vjen edhe në ndoca paralele historike, që lidhen tashmë me kodet e fshehta ku të vërtetat mbulohe nga pluhuri i shekujve dhe zgjojnë të tjera pohime e pandehma. Le të kujtojmë, bie fjala, letrën e papës Paulus Secundus që i dërgonte Skënderbeut në motin 1468, për dashurinë që ai kishte patur ndaj një bije të Muzakave të fuqishëm të Shkodrës, me të cilën thuhej se pat dhe një fëmijë. E vërtetë përvëluese vjen përmes letrës së Papës në një formë top secret, pra e koduar përmes "kodit djallëzor". Sigurisht kjo pandehmë nuk vihet kot, për kureshtje, por në funksion të asaj çka përfaqësonte Jurendina Muzaka: trashëgiminë dhe fisnikërinë e gjakut të saj të pastër shqiptar (çka do të lidhet më pas me baladën e Kostandinit dhe Doruntinës, kalërimin e të gjallës me të vdekurën, besën dhe pabesinë, si ankthe dhe gjëma shoqëruese të shqiptarëve mes konvertimesh e zhbërjesh historike).

Majaja ngjizëse e brumit të këtij romani

mbetet raporti i vështirë, mistik dhe plot dilema i shkrimtarit Martin me krimin, vrasjen e mundshme prej dikujt, a nga dikah, duke kaluar tanimë përmes një dashurie, edhe kjo e ankthshme. Përherë shkrimtari shoqërohet nga një frikë e brendshme thaujse mistike se dora e fshehtë e sigurimit të shtetit diçka ka përgatitur për ta asgjësuar. Kjo frikë vjen në formë nebuloze metaforike në vargjet e tij "Parisi vret, Parisi verbon...". Pikërisht, përmes verbimit me të bukurën, Parisi edhe të vriste. Por vetëm kaq, thua?! Ishte dora që e ngulte thikën tinëz, pas shpine, në terr, ajo që vriste. Vriste pushteti. Ky makth rivjen në tutje, kur Martini akomodohet në hotelin më të famshëm të Francës në "Ritz", teksa e ha pandehma tmerruese e "...gjakut mbretëror i derdhur në Palace Vendome, si një grusht rubinësh të kuq..." Kësodore nënkuptimi i vdekjes së pritshme të shkrimtarit si të lirive vishet herë pas here me velin e tragjediive shekspiriane dhe pandehmat e tmerrshme me shtriga e paranoja diktatorësh, tretet nëpër mite, rimerret për shpjegime paralele nga legjendat (si ajo e Kostandinit dhe Doruntinës); është e gjitha një kampanë paralajmëruese, ku murti e mban syrin hapur. Një Parthenon me kolona dhe statuja të thyera...

Përtej kësaj situatë frike, ankthi dhe dyshimi, Mira Meksi rreket të shkojë diku më tutje, në një farë transcendence, jo pa një cipëz shpengimi të kahut religjioz, ku shpirti apo fryma qarkullojnë



si riciklime eterne a si rimishërime tokë-qiell (gjegjësisht religjioneve të mëdha si krishtërimi, muslimanizmi dhe budizmi). Martin Gjergji, i vetëdijshëm se mund ta vrasin, kërkon ta sublimojë veten jo thjesht te letërsia e tij si "kurmi" i një krijimi dhe fantazie të shpenguar e të pastër, por edhe te kurmi i një femre, i një të dashurë-peng jete, ku dëlirësia, spikama e hirit trupor që grish energjinë fallike mashkullore, ndjenja e mbrojtjes së kësaj dashurie dhe e vetëmbrojtjes ndaj saj, të gjitha bashkohen në një pikë: nevojën për tejkalim e superim, për transcendencë, për rimishërim të gjeniumit të vet spiritual në trupin e tjetrës. Romancierja e kap këtë tezë, në thelb religjioze dhe hegeliane, e bën pamendë duke cytur buajt e narratives së saj në lërimin e ideve që ajo dëshiron t'i bëjë kryesore dhe të pushtetshme. Martin Gjergji e njeh gjenialitetin e tij si shkrimtar, aq sa njeh dhe rëndomtësinë njerëzore. Përpara se ta flijojnë për "Zotat e Olimp" politik të regjimit, ai kërkon të bëjë një farë ekuarestie, tejkalimin e vdekjes së tij të pritshme përmes erotizmit të pastër dhe dashurisë si ringjallje. "Asnjë i vdekur nuk mund të ngjitej gjallë në Olimb", mendonte ai me vargjet e poeteshës greke Safo. Pra vdis që të bëhesh i pavdekshëm. Vetëm i vdekur arti i tij, dalë prej vuajtjes së mendjes, mund ta çonte më në fund në "Olimpin" e vlerës së përkryerjes, nënkupto të përkryerjes së artit.

Arkeologjia që M. Meksi krijon duke përzier reljeve e lëndë të ndryshme në shpjegimet e saj, filluar nga informacioni politik i kohës, biografia e shkrimtarit të shquar Kadare, religjioni, mistika, mitet, futur aty edhe një shtresim i letërsisë dedektive të 007-tës, shajni e bëma të habitshme që lidhen në një logjikë rrëfimi bindëse të tipit të thrillerit, misterit, një fare ekzorcizmi psikik mes djallëzive, të cilat edhe të kujtojnë vitin 1990 ku vendosen ngjarjet e romanit, edhe i bishtojnë atij, sepse kanë prirjen gjeneruese të një narrative ku e fshehta pjell të fshehtë, ngjarja ngjarjen dhe pandehma pandehmën.

Romani sjell jo pak informacion mbi atë udhë vramendjesh, dyshimesh, kundërshtish dhe ankthesh që kalonte shkrimtari ynë I. Kadare në prag të ndryshimit të madh politik të vitit 1991. Survejimi i tij, frika që kasta komuniste kishte nga fama që ai gëzonte në Francë dhe Evropë, mendjehapja, sidomos letërsia që ai bënte, jo thjesht e talentuar dhe sipërane por po aq dhe kritike, emancipuese dhe formuese për shqiptarët e ngjuar nëpër kulla e bunkerë dogmash e gënjeshttrash, e gjitha kjo krijon në roman një si ndrydhje, një dëshpërim në caqet e traumës. Nën kodet e rrepta ideologjike të realizmit socialist, Kadare (domethënë Martin Gjergji) mundi të bëjë një letërsi të madhe mbushur me dritë, një letërsi të kthyer në fanar për të parë diku tej, në brigjet e një Evrope të lirë e të kamur, në të cilën edhe vendi i tij pat qenë dikur pjesë e atij banketi dhe asaj tryeze. Shkurt, të "bënte një letërsi normale në një vend anormal", sikurse shprehet ai. E pra duke e ndjerë kërcënimin që i vinte në tri kahe: a) mundësia e një arrestimi apo vrasjeje nga policia sekrete, b) pamundësia e një komunikimi të natyrshëm të gjeniumit të tij artistik me botën (nga ndalimi i librave të botuar jashtë), c) vuajtja e mungesës së lirisë e ardhur në zgrip të durimit - shkrimtari Martin Gjergji rreket të shkojë drejt një zgjidhjeje me ngarkesë religjioze dhe transcendente. Ai synon të rimishërohet jo thjesht si burrë që dashuron një grua, por si në një lloj ekuarestie tjetërfarë, duke e ripërtërirë qenien, gjenin e përzgjedhur, pra lëndën superiore të artit, kuintesencën e vet, në mitrën plleneuse të një gruaje. Kjo ide, natyrisht, ka shumë ezoterizëm brenda, sikurse ka dhe një paragjykim mitik, për të mos thënë besëtytni. Kësisoj Meksi e kthen personazhin e vet në bartës të një ideje disi të idealizuar, ku roli i shkrimtarit të ndritur si gjenium, i bashkuar





me bukurinë femërore dhe fisnikërinë e kastave të hershme të bujarisë shqiptare në kohën e Skënderbeut, mund të krijonin amalgamën dritësuese të ardhmërisë së kombit, duke e shpëtuar nga çoroditja, rëndomtësia, degradimi dhe shëmtia komuniste. Them se kjo është më shumë një "ide poetike", disi romantizante, më shumë një metaforë letrare sesa diçka që i shkon më për shtat prozës si narrativë, parashtrim, subjekt etj. Një farë apeli a merak (nëse mund ta quajmë kështu) se Shqipëria dhe shoqëria jonë nën diktaturë lipsej të ruante kuintesencën lëndore të trashëgimisë së saj më të mirë historike dhe antropologjike, gjenin fisnik dhe farën e shpirtit krijues të lartësuar, në thelb është një mbivendosje filozofike, një dëshirë e bukur, por jo një e vërtetë historike, sidomos me proceset çliruese të shoqërisë demokratike sot, me shanset e barabarta të çdokujt, me liritë dhe të drejtat njerëzore në një shoqëri dhe urbanizëm dinamik si ky që jetojmë.

Them se dy dashuritë e pamundura të shkrimtarit Martin, e para me Anjeza Shirokën, një vajzë e ardhur nga kupola partiake e vendit dhe e dyta, Jurendina Muzaka, e ardhur nga kupola mbretërore ("gjaku blu") prej farës së Skënderbeut me vajzën e Muzakajve, janë dy këmbët mbajtëse të urës që shkrimtarja nge mes domethënies të dy kohëve, të djeshmes "skënderbejane" dhe të sotmes "komuniste". Të dyja janë dashuri të pamundura, fatale: e Anjezës si njëra prej vajzave më të bukura të kryeqytetit, bijë e një partiaku të lartë, i cili nuk mund ta pranonte për dhëndër një shkrimtar që ishte kundër regjimit; dhe Jurendinës, që vinte nga një mbiemër historik i bojarëve shqiptarë, nga Muzakajt, të cilës i ngarkohet një mision krimi nga sigurimi i shtetit për të spiunuar dhe vrarë Martin Gjergjin në Paris. Të dyja kanë një fund të trishtë, e para martohe me dikë brenda kastës komuniste që nuk do, e dyta për dashurinë që ka ndaj shkrimtarit helmohet me striktinë (ndoshta vetëhelmohet, ndoshta e helmoi policia e fshehtë, ndoshta... dhe enigma vazhdon...) Të dyja vajzat janë të dëlirësuar, e para pakëz më naive, që i gëzohet mishit në flakërimin erotike e falllike dhe e dyta më fisnike e më dinjitoze, që i gëzohet adhurimit dhe bukurisë së mendjes dhe artit të shkrimtarit. A janë ato "frymëzimi artistik", lënda poetike dhe letrare e Martin Gjergjit, apo pelgje frike, dyshimi, tjetërsimi dhe dështimi? Të dyja këto gjësende M. Meksi i pleks dhe i përzien qëllimisht në funksion të idesë, e cila lidhet me të vërtetën e krijimit letrar: Ç'ishte dashuria vallë, vetëm lënda parake e letërsisë apo edhe kodë i përjetshëm i lirisë. Ku ishte dashuria sublime, te jeta apo te vdekja? Ky binom mortar i vret dhe i pamundëson dashuritë e mëdha, siç ngjet dhe me Martinin, por nuk e vret dhe e pamundëson lirinë e artit, përkundrazi arti i madh ushqehet me ankthin, tragjedinë, vetë vdekjen.

Romani ka çaste ankthi, ëndrrash të frikshme, ku përzihet miti i hershëm hebraik me pandehmat e tmerrshme të mendjes së trazuar që vërshojnë në ëndërr, sikurse na vjen kjo e vizatuar bukur te ëndrra e Jurendinës me kokën e prerë të shkrimtarit mbi teps, njëjtë siç pat bërë dikur në rrëfimin biblike Salomeja. Ajo i kërkoi mbretit Herod kokën e prerë të Gjon Pagëzorit mbi teps që të kërcente mes ekstazës falllike e të lemerishme. I gjetur në roman është edhe episodi kur shkrimtari, duke sfiduar frikën, i shkon Anjezës mu në vilën e saj byroiste, si për ta shpëtuar nga burgosja e dashurisë, por tashmë kambanat kishin rënë. Për t'i dhënë mision shëlbyes figurës së Martin Gjergjit, në roman gjejmë edhe përshkrime historike të një grupi grash të njerëzve të fuqishëm të globit, që kanë ndikim në rrjedhën e ngjarjeve pas shembjes së murit të Berlinit, siç është zonja Rotshild dhe shoqet e saj. Shkrimtarit i kërkohet pjesëmarrje aktive në proceset politike që priteshin të ndodhnin në Shqipërinë komuniste për të sjellë një rend të ri, paçka se mes trysnish dhe sakrificash. Diçka e fortë duhet të ndodhte që të përshpejtohej lëvizja demokratike, siç në fakt Ismail Kadare bëri me kërkimin e azilit politik në Francë. Akti i largimit të tij u bë referenca inkurajuese për rininë shqiptare për të përmbytur pushtetin tiranik, ashtu si dikur braktisja që Akili i bëri ushtrisë së udhëhequr nga mbreti tiran Agamemnon i Spartës. Liria kushton. Liria kërkon teorori. Liria kërkon dëlirësi. Një nga kromozonet dhe qelizat e pamorta të saj është Arti i pastër, i pakorruptuar...

## MUND TË SHFLETOSH NJË ENCIKLOPEDI TË TËRË...

Mund të shfletosh një enciklopedi të tërë dështimesh, mund të shohësh, analizosh, njëmijënjë shembuj për dështimet, madje edhe për dështimet e ditës.

Por, s'mund të gjesh një dështim tjetër që mund të ngajë me timin. Dështimi im, gjithëherë ka qenë lëvizja e vrulltë e pamendte e një çuni të vogël e ëndërrues, që çast për çast vrapon, (vrapon akoma dhe akoma), vrapon e then, e humb diç nga ky trup fatkeq: një këmbë, një dorë, një sy, një mendim të dëlirë, një gëzim, apo mozomakeq, kokën.

Këtë toph me kaq pak ballë sipër, me kaq pak mend, e me dy sy të tharë, që sytë e tu e shohin pikërisht tani mbi supet e mia, mbi qafën time, nuk është koka ime, po koka e këtij çasti, që merr përsipër t'më sigurojë një vrapim ardhës, një dështim ardhës, një vuajtje ardhëse, të ngjashme me atë që më ndodhi vetëm një çast para këtij çasti...

(E pra? Ora është aq sa është, dhe ne mund të jemi, veç për aq sa na lejon Ora...)

## LËKUNDJE

Lëkundet dita. Dita lëkundet si një e marrëmendsh.

(I dehur jam, a vërtet lëkundet dita?..)

Matanë dritares, n'trotuar, shoh si kalonjë, si ecin dy njerëz, që lëkunden poashtu.

Lëkundet edhe ai qenush i vogël, që ka një këmbë të thyer, e u ngjitet pas.

Edhe kafeja, edhe kjo gotë uji që kam mbi tavolinë, edhe cigareja ndezur, edhe taketukja, edhe dora ime, lëkunden, lëkunden.

Lëkundet edhe banaku i kafenesë, e pas banaku, flokëkuqe, e bukur si një perri, edhe kamarierja lëkundet, teksa m'përpin me sy e m'buzëqesh.

Gjithçka lëkundet në këtë çast, përveç këtij mendimi, që më thotë të ngutem, ta marr n'përqaqim, kamarieren e bukur...

## ISHTE E RE. POTHUAJSE E BUKUR...

Ishte e re. Pothuajse e bukur. Dinte t'i menaxhojë gëzimet, hidhërimet. Dinte të mbledhë, të zbresë numra, me pafund. Dinte, edhe të shumëzohë e pjesëtojë, madje edhe shumë më shumë se aq.

Kur ulej të hante, nuk zgjidhte fare. Kishe qejf ta shihje si hante, si i mblidhte e i hante, edhe thërmijat, njëpërnjë.

Nuk kishte kërkesa, si ca të tjera. Kënaqej me pak. I mjaftonte prezenca e atij, paçka se s'ia frynte kurrë, barkun, me bukë. Nuk i kërkonte lukse, si shëtitje, veshje, e gjëra me pafund.

I kishte gjithë të mirat e një femre të mbarë, por edhe një fat të keq, që ia hëngri kokën: u lidh të jetojë me një dështak si ai, që s'dinte, madje, as të numërojë, dhe që e rrehte e ia hante mishin ditë për ditë, ditë për ditë ia pinte gjakun, ia zinte frymën..., derisa një ditë... një ditë... përnjëmend e vdiq... me një gotitje n'kokë!!!

(Për çudi, atë goditësin s'e gjeti gjë. Ai, sot e kësaj dite, vazhdon t'jetojë i lirë, i lirë, i lirë..., si një bishë e egër n'mal... ku ai është bisha, dhe gjithë ne jemi mali...që s'bëzan!!!)

## FLUTURA

Dje, gjithë ditën e ditës, një flutur të bardhë ndoqa. Gjithë ditën e ditës, ia mata lëvizjet, rrugën, drejtimet. Ia mata nisjet, ndaljet, ngritjet, uljet, uljengritjet, ngritjeuljet... Ia pashë madje, edhe lotët që i rrodhën, lotët që i la... te pragu i muzgut.

Në fund të ditës, ndjeva, njëkohësisht, një lodhje të pamasë dhe po aq lumturi.

Sot, po arrij të kuptoj një gjë: Ditët janë flutura të bardha, që Zoti zemërgjërë na i fal neve, që të kemi ç'të bëjmë me to, e t'ia bëjmë disi me veten...

## MËNYRË SHPËTIMI

Kur jam keq, gjej një mënyrë, edhe shpëtoj: marr, i kruaj veshët, sytë, e terroj shikimin, pirë a papirë dehem, e bëj veten troll.

Kur jam mirë, gjej poashtu një mënyrë,



# SHAZIM MEHMETI

## Dhjetë proza të shkurtra

edhe shpëtoj: marr, kundroj një pemë, e mpreh shikimin mbi atë pemë, e lëmoj mendimin për atë pemë, e mendoj atë pemë si trupin tënd, i afrohem, i ngjitem, bëhem ti...

Ja, kështu... kështu ia bëj... Kështu ia bëj, qëkur m'keni lënë... ti dhe ajo koha ime: ti që m'je koha, dhe koha që më është pemë...

## MBASE FJALË KOTI...

Mbase fjalë koti, por, ka një lloj femrash që janë të bukura, e që bërë janë veç për t'i dashur. I do, edhe kur s'i do, i do edhe kur i do. Kur s'i do, i do, por disi më pak. Kur i do, i do, por disi më shumë.

Si planetka të largëta, gjithnjë të palumtura janë ky lloj femrash: nuk arrijnë ta dinë se i duam, dhe për më keq, na duken disi të paarritshme, disi të padiskutueshme.

Pyes veten, pse vallë, na duken të tilla?... Kërkoj mënyrë, për ta gjetur arsyen pse na duken të tilla.

Femrat e tilla, mbase janë si ëndrrat: flurore; të paqena, edhe kur janë të qena; të qena, edhe kur janë të paqena.

Besoje se femrat e tilla, janë disi edhe të qasshme, përveç një gjëje të vogël që është shumë e madhe: nuk janë për prekje!

Dhe, gjithë kjo e keqe, u vjen nga droja jonë mashkullore për t'ua zënë rrugën e për t'u thënë se i dëshirojmë, dhe mund t'i bëjmë edhe të lumtura. Por, jo vetëm kjo. Gjithë kjo e keqe atyre mund t'u vijë edhe nga ai parashkrim i keq: Parashkrimi i të qenit Vetëm me Vetën...

## DREKË

Ajo më ka vënë përpara një drekë të varfër: bukë, kripë e qepë të pjekura. Çuditërisht, dreka më vjen e shijshme. Më vjen e shijshme deri... n'meditim.

Kur frigoriferin e ke përplot me mish e me zarzavate të freskëta, e ke më të lehtë të përgatisësh një gjellë të shijshme. E ke më të lehtë, sepse ke me çka.

Shpirtrat e rinj, që mbushur janë me ndiesi të holla, disi më të lehtë e kanë, të na sjellin një gjellë të shijshme fjalësh.

Tjetër gjë ndodh me shpirtrat e vjetër: në mos qofshin të vdekur, shpirtrat e vjetër janë si frigoriferë të boshatisur. Për të nxjerrur gjë qandej, duhet ditur të bësh gjellë edhe prej asgjëje.

(Mbetet gjithnjë e nevojshme, gjetja e një përgjigjeje për një pyetje banale, të thjeshtë e të stërshtuar: "A m'plaket shpirti?..."

Kam një përgjigje me qepë të pjekura, më banale se vet pyetja, por nuk e them...)

## UNË TË DUA..

Unë të dua, dhe ti e di se unë të dua. Unë ta shtrij dorën, por ti më përbuz. (Nga dashuria?) Dakordohem me përbuzjen, marr të ik, por ti më kap për jake, më kthen kah vetja.

Dakordohem sërish, dorën ta shtrij, por ti dorën ma kafshon.

Ta shoh përgjakjen e turirit. Kokëulur, marr sërish të ik, por nga mbrapa, ti m'sulesh, ma

kafshon supin, për aq sa krahu im i majtë, dora ime e majtë bie përtokë.

Ulem ta prek, ta marr, ta ngris me të djathtën, por ti m'sulesh sërish, ma ha gjithë shpinën.

Tashmë koka ime është përtokë; tashmë koka ime është tokë. Veç sytë e mi kanë akoma edhe ca xixa gjallërie, fare pak xixa, aq sa, mezi arrij të të shoh mjegullisht, si më gllabëron të tërin. Por, s'arrij të të shoh me fund, sepse pikërisht tani, pikërisht tani... sikur më prek një dorë mbi sup, një frymë m'bie mbi frymë, dhe... po më del gjumi...

(Paska qenë ëndërr... shyyqyr, Zot!...)

## VERBËRIA

Një dashmire vargësh, se si kishte gjetur një mënyrë, për të ma bërë këtë pyetje: "Je vërtet i verbër, apo bën sikur je?"

Pamendueshëm, iu përgjigja troç: "Jam, dhe bëj sikur jam."

Tashti, që po e mendoj më mirë mrekullinë e dritës (edhe mrekullinë e dijes?), arrij të kuptoj, se i kisha pas dhënë asaj dashmirëseje, përgjigje të gabuar.

Qenka pas dashur t'ia jap këtë përgjigje: "Nuk bëj sikur jam i verbër, po jam i verbër..."

## EMRI

Gjithë fëmijët i donin gjyshërit, unë e doja stërgjyshin. E doja, e doja, dhe, edhe pse isha i vogël, e ndija si shkrihej ai, kur m'i hidhte sytë, kur m'i ledhatonte flokët, kur m'i prekte duart. Diç si dritë e rralluar, sikur i dilte përsyshë, sa herë ma thoshte emrin.

Nuk i ndodhte një gjë e tillë, kur i prekte vëllezërit e mi (që fëmijë e të vegjël ishin edhe ata), dhe kjo gjë më bënte disi, dhe gjel dhe kureshtar.

Kur ndërroi jetë stërgjyshi im, mua thuajse m'u shemb bota. Më, qiellin nuk e gjeja, me ngjyrën që e gjeja. Drita e mëngjesëve, filloi të mos më mrekullojë, si më mrekullonte dikur, kur gjendesha ulur në prehërin e tij. Lojërat e elemisë, ndryshe m'u bënë, disi të pashije, të pamagjishme.

Përnjëkohë, nëna ime (ndjesëpastë), i kishte vërejtur te unë këto ndryshime. Dhe, për të bërë të ndihem më mirë, sikur e mori ajo rolin e stërgjyshit.

Një ditë, teksa m'i lëmonte flokët, e m'i prekte duart me duart e saja të përdjegura nga saçi, bëlbëzueshëm, nëna ma fryu n'vesh emrin tim. Ma fryu, mu ashtu si ma frynte stërgjyshi im, sa qe në gjallje. Që atë ditë, ndjeva disi sikur m'u kthye gëzimi, sikur m'u kthye magjia e ngjyrës së qiellit, magjia e dritës së mëngjesëve, magjia e lojës së elemisë...

Por, kureshtja për magjinë e lidhjes së stërgjyshit tim me mua, nuk m'u shua kurrë, derisa, vonë, vonë, një ditë, pothuajse kur u rrita, nëna ime m'i kapi duart, dhe ngadalë e me lotë në sy, ma shpjegoi gjithë magjinë e asaj lidhjeje: në moshë fare të re, stërgjyshi im kishte pas varrosur një evlad të vetin, që pagëzuar kish pas qenë me emrin tim...



**Fragmentarizëm e të dhëna:** Janë më dhjetëra monografi të botuara për personalitete të kinemasë dhe teatrit. Jo vetëm në formatin e albumeve të botuara nga AQSHF por edhe me autorësi. Miho Gjini i ka kushtuar monografi Mihal Popit e Naim Frashërit, Albert Zholi Reshat Arbanës, Kujtim Gjonajt e Luftar Pajës, Lec Shllaku Zef Jubanit e Loro Kovaçit, Josif Papagjoni Kadri Roshit e Dhimitër Anagnostit, Suzana Varvarica Faruk Bashës, Zenepe Luka Violeta Manushit etj. etj. <sup>1)</sup> “Së fundi” përgatitur nga Marjeta Ljarja e Dashnor Kaloçi është botuar libri në kushtim të aktorit, regjizorit, skenaristit, piktorit e prozatorit Rikard Ljarja “Rikardi” në të cilin janë përmbledhur shkrime publicistike të autorit, intervista, shkrime për Rikardin përgjatë çerekshekulli (1994-2020). Botim “Onufri”. Viti 2022.

Vonë shumë vonë “u zgjova” që të intervistoj ikonën emblematisht të aktrimit në vitet 60-ta e 70-ta të shekullit të kaluar! Por i kthehem një botimi “të hershëm” përmbledhës “Magjia e ekranit” <sup>2)</sup>, një vepër siç thotë autori Gani Mehmetaj “për nostalgjikët e kinemasë”, intervistës realizuar në vitin 1992 me aktorin Rikard Ljarja i cili ka thënë se “ëndrrat e aktorëve për interpretim janë të përjetshme”. Por, çerekshekulli më pas aktori nuk ka asnjë peng, e ka “harruar” interpretimin dhe po e përfundon me krijimin e rrëfimit në prozë përmes tregimit, novelës dhe romanit.

Në prologun “Parafjalë” të nënshkruar nga Rikardi, del koncepti i “të shkruarit letërsi” i cili “nuk ka shpjegim të saktë”, “Është mister. Është çudi.” Një qëndrim poetik borgesian. Autori ecën më tej, në një përcaktim të beftë, se “të shkruarit letërsi është një “sëmundje.”

**Poetika për Atdheun dhe intervista e shkrimtarit me aktorin:** Shkrimi i parë është përzgjedhur i vitit 1994 i shkruar nga Rikard Ljarja me titull “Pas rënies së komunizmit, në vendet e Lindjes, orthodoksia u thirr në skenë!” në të cilin autori shkruan për kombin, atdheun dhe traditën “e afërt”. Nga ironia në kod e “parim” dhe anasjelltas del fraza a fjala e urtë shqipe: “Për inat të sime vjehre...” të cilën e përmend tetë herë në këtë shkrim.

Paragrafi për “kombësi myslimane” dhe Titon, seç më kthen në vitin 1981 kur bëhej regjistrimi i popullsisë në Kosovë. Përkatësia nacionale myslimane?! Dhe disa shqiptar, familje shqiptare në Kosovë janë shkruar vërtetë jugosllav!? Kulmi i këtij shkrimi në përfundim. Rikardi pyet se ç’është atdheu të shkruar në prozë, të cilën po “i kthej në vargje”, si një poetikë diksioni lexuar nga autori i dokumentarit “Rikard” <sup>3)</sup>, aktori Mevlan Shanaj:

Ç’është atdheu?  
Vërtetë ç’është atdheu?  
A nuk jam unë atdheu,  
gruaja dhe fëmijët,  
oborri im,  
toka ku kam mbjellë sivej bostan e grurë,  
a nuk është atdheu komshiu im,  
lagjja,  
fshati përkarshi,  
ai lumi që s’pushon së rrjedhuri,  
a nuk është atdheu gjuha që flasim,  
këngë që u këndojmë e vaji,  
e gjama,  
a nuk është atdheu varret e gjyshërve e stërgjyshërve,  
a nuk është atdhe gjithçka në këtë tokë e mbi këtë tokë  
deri tek flamuri?  
Sigurisht që ky është atdheu.  
Një piramidë që fillon tek unë e mbaron tek flamuri.  
Po për shumëkënd,  
ndoshta për shkaqe të kota,  
ndoshta edhe madhore,  
nga komplekse të ngatërruara psikologjike,

Rilexim “Rikardi, nuk kam asnjë peng”

# ME RIKARDIN PËRMES LIBRIT

Nga Enver S. Morina

Libri për aktorin e mirënjohur Rikard Ljarja. “Rikardi” në gjashtë pamje. “Rikardi” është monografi që ngërthen jo vetëm të dhëna për Rikardin nga të tjerët, jo vetëm disa intervista të përzgjedhura të Rikardit, por edhe qëndrime e autorësi jetëshkrimore të vetë Rikardit...

pronësi,  
grindje,  
xhelozie,  
inferioriteti,  
karakterit...

Lind pyetja: O atdhe, po të mbroj, po ti ç’po bën për mua?

Dhe në qoftë se kjo pyetje s’merr përgjigje ashtu si është ndërtuar në kokën e atij që pyet...

Atëherë për inat të sime vjehre...  
ngre kokën dhe pështy përpyetë.

Vjen pastaj një intervistë e rrallë dhe nga më të rëndësishme e realizuar nga shkrimtari Fatos Kongoli e vitit 1996. Bashkëbisedojnë për filmin, kinematografinë, bashkëprodhimin dhe të tjera tema: “...prodhimi kinematografik është i lidhur ngushtësisht me industrinë...” (faqe 20). “Bashkëprodhimi është mënyra kryesore e prodhimit të filmit në botë.” (22). “...mendoj se i ka kaluar koha e eksperimentit.” (23). “... të keqen më të madhe teatri ynë e ka të mungesat e dramaturgjisë kombëtare.” (23). “Roli i shtetit ka rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm në subvencionimin e artit, por edhe në orientimin drejt vlerave të mirëfillta kombëtare. Sepse në fund të fundit paret e shtetit janë paret e mia e të tuat dhe s’duhet të guxojë askush të tallet me to.” (23)

**Kinostudioja “shtet në miniaturë” dhe “Shkodra e bekueme”:** Mesazhet e Rikardit janë të qarta. Nuk kanë ekuivoqe, janë të drejtpërdrejta. Kinostudioja? Për Rikardin Kinostudioja ishte një “minishtet” a “shtet në miniaturë” sepse të 700 punonjësit “të gjithë kanë qenë miq të mirë me njëri tjetrin.” dhe se janë krijuar edhe “vepra të padiskutueshme”.

Portreti i Marash Hajatit për artistin, për “interpretimin e heshtjes”. Kështu e portretizon aktorin: “Me botën e tij të brendshme në rrugën e filmit shqiptar, më shumë se asgjë, ka interpretuar heshtjen. Po, po, heshtjen. Heshtjen me atë psikologjinë e qëndrimit befasues përballë partnerit,

përballë episodit, përballë shikuesit.” (43)

Publicisti Fatos Baxhaku shkruan për romanin e Rikardit një shkrim eseistik. Portret. Për madhësinë e thjeshtësisë, Ndreç Lucën. Një shkrim i thjeshtë për madhësinë. Një portret në perfeksion. Dhuntia e një artisti. Njohja: tek vitrina e fotografit Jakova e një oficeri. Ky shkrim “do të hyjë” në librin e Gjergj Lucës për babanë dhe do marr emrin edhe libri. <sup>4)</sup>

Intervistë e Rikardit nga Dashnor Kaloçi (2005). Roli i parë në film në moshën 23 vjeçare. Në rolin kryesor atë të Dritan Shkabës (mësuesi Ndreç Ndue Gjoka) në filmin “Komisari i Dritës. “Atë rol e fitova me kinoprove, mes 15 konkurruesve...”, thotë aktori.

“Shkodra e bekueme” është siç thotë autori “Një profil i vogël i qytetit tim”, një shkrim i gjatë, nga më të gjatët në këtë libër. Historia e civilizimit të Shkodrës nga mitologjia e legjenda e Rozafatit deri tek modernia. I shkruar në gegnisht. Ka edhe koncepte epike në pafundësi si “Shqiptari kërkon të jetë i lirë, i lirë deri në absurd.” (76).

**Vetëcensura e munguar dhe titulli:** Si një gërshetim zhanresh në libër herë pas here “ndërhyjnë” autorë në kushtim të aktorit. Ela Baçi shkruan se “prej kohësh ai njihet si ikona e filmit shqiptar, ndërsa për të tjerët që do të vijin më pas përherë do të bëhet shëmbëlltira e aktorit që theu, skematizmin dhe revolucionarizoi konceptin e aktrimit, duke i dhënë një dimension të ri ekranit dhe kinematografisë shqiptare të viteve ‘70.’ ... “Gjuha e shpirtit të tij nuk ka kode sekrete, gjuha e syve nuk e ka tradhtuar kurrë dhe ai, di të flasë veç me to, dhe di të mbështetet tek ato kode që kanë konservuar virtutin dhe që të gjenerojnë energjinë për të kërkuar vlerën e vërtetë që jetës që jetojmë.” <sup>5)</sup>

Shkrimi i Rikardit për filmin dokumentar te Pluton Vasit, në veten e parë është një përshkrim mbresëlënës. Më tej shkrimi kronologjik me kujtime, një ese, shkrim portret i Arjan Konomit me kapituj “Pasioni

i të shkruarit”, “Nga Teatri te Kinemaja”, “Si regjisor” dhe “Familja”. “Interpretimet e tij (te Rikard Ljarjës-vër. e.s.m.) jo vetëm do të linin gjurmë të shqiptarët duke e kthyer atë në një “mit” të kohës, por do të ndihmonin edhe në shkëputjen e teatralitetit nga kinemaja.”, mendon Arjan Konomi, pasi sipas tij “filmi shqiptar në vitet e para të tij ka qenë shumë teatral”.


Digresioni dhe gërshetimi i një “gjykimi” nëpër kohë në heshtjen e frikshme dhe pritshmërinë vlerësuese për filmin “Rrugë të bardha” ç’thuret si mesazh pas përmbysjes së metodës së realizmit socialist dhe “ndëshkimit” të autokritikës tek skena “e gozhdimit” në shtyllën e drunj të personazhit real e kryesor, Pjetër Llesh Dedës. Vetgozhdimi?! Proces gjyqësor në mungesë. Vetëkritikë e institucionalistëve të kohës. Kush ka qenë ministër i kulturës?! Kush e lejoj këtë film të shfaqet?! Këtë skenë? Përgjigje të cilat erdhën vonë por që shikuesi e paska ndjerë!

Një udhëtim dhe një shkrim plot nostalgji e përkushtim “Gjirokastrë, më kish marr malli për ty...”. Derisa historia e Shkodrës është shkruar me nota gegnishte, shkrimi për Gjirokastrën është shkruar toskërisht. (102-109)

Titulli i shkrimit, i thënies, i librit “Rikard: Nuk kam asnjë peng” na shfaqet në faqe 114. Studiuësja Alda Bardhyli me dy shkrime eseistike të njëpasnjëshme. Ajo thotë se “Larja ashtu si me çdo gjë tjetër e lidh shkrimin me të vërtetën. Asnjë imagjinatë nuk mund të tejkaloj të vërtetën” dhe se “Skenarët në njëfarë mënyre janë një lloj letërsie.”

**Letërsia, skenari dhe pështyma:** Pas intervistës me Skënder Minxhozin (2012) botohet intervista me Arta Markun realizuar në fillim të vitit 2016, me gjasë intervista e fundit me aktorin! Rrëfimi për Heminguejin, rrëfimi për betimin në gur, rrëfimi për Shkodrën, për heronjtë në dialog në “Bibliotekë”. “Të bësh skenar është si të bësh një libër të vërtetë. Ka edhe skenari karaktere, personazhe, atmosferë, marrëdhënie etj., etj., pra letërsi. Por është letërsi e veçantë. Është letërsi që duhet parë, që flet me figurë”, thotë Rikardi. Raportet mes zhanreve kryesore në gërshetim sipas aktorit “ka një lidhje të fuqishme mes letërsisë dhe kinemasë, të dyja kanë huazuar nga njëra-tjetra.” Dhe qëndrimet e artistit për kombin: “... shqiptarët janë të besës deri në fund kur janë të besës dhe janë të pabesës deri në fund kur janë të pabesës. Në fakt kjo është një kontradiktë, por e kemi brenda. Të marrësh historinë e kombit tonë, ke të pabesë të llahtarshëm, por ke edhe të besës të jashtëzakonshëm.”

Shkrimi i dytë për dokumentarin e Pluton Vasit është një ese e thellë në strukturë e përmbajtje “Ku i kam eshtrat...”. Autori arrin të thotë të vërtetën dhe realitetin e hidhur me një gjuhë të antitezës për çka kemi “të drejtë





të fshehim krimin dhe kriminelin. Kemi të drejtë të vrasim vëllain për dy gisht tokë. Kemi të drejtë të përdhunojmë në mënyrë kolektive vajzën e komshiut. Kemi të drejtë që të mbledhim e të shesim kanabis. Kemi të drejtë që motrat tona të kopjojnë njëfarë Kimi. Kemi të drejtë të marrim identitetin një të panjohuri...” si përfundim “kemi të drejtë për gjithçka, përveç, të bëjmë drejtësi.”

Një ese ironike semiotike dhe morfologjia fonetike e të pështyrit te “Ejani të pështyjmë”:

“A, se mu kujtua.

Po Zotit Ibrahim... e... nuk do ja fusim?

Patjetër.

“Paqësori”...ha, ha, ha... Pamvarsiaku...

Me shumicë nga të gjitha krahët. Pështymë me një fjalë.

Cilët krah?

I dini ju, i dini, mos u shtirni...”<sup>6)</sup>

**Spektatori i shenjtëruar dhe “ndyrja” e Nobelit nga Handke:** “Skena është e shenjtë”, kanë thënë profesorët. Shenjtëria e teatrit?! Rrëfim i sakrificës së papërsëritshme! Këto ditë nderohet Dita e Teatrit. A ka çast më sublim se sa në DitëZie të vdekjes së Nënës, të vdekjes së Vajzës dhe vdekjes së Djalit aktorët, i pari Çun Lajçi, i dyti Pistol Soja dhe i treti Prenk Lëkunda të mos largohen nga atmosfera që ndërton teatri por të paraqiten në skenë, për spektatorin e shenjtëruar. Rrëfim si në mitologji. Si në legjenda.

Fillimqershor 2018. Dy shkrime kronikë ditore nga promovimi i romanit “Josifopedia” nga Valeria Dedaj dhe Alma Mile. <sup>7)</sup> Dhe më tej dy shkrime kushtim si homazh për Kiço Blushin ( f. 159, 20 shkurt 2019) dhe për Fatos Baxhakun ( f. 161, 24 gusht 2019). <sup>8)</sup>

Gjatë takimit të fillimqershorit në UET me Fatos Baxhakun peng më mbeti përgjithnjë takimi dhe bashkëbisedimi më tej më të!

Me një finesë të përkryer për ta njohur dilemën e çmimit për një shkrimtar siç është Peter Handke dhe Nobelit për Letërsi autori, tashmë një personalitet i letrave, shkruan kritikë për gjermanishtfolësin-shkrues: “Ky njeri, kontrovers, Peter Handke, është i vetëdijshëm. E arriti atë që donte. U bë figura më e ndyrë e letërsisë së përbotshme dhe reklama që po i bëhet i mjafton. Me siguri zgërdhihet e u nxjerr gjuhën të gjithëve meqë ua hodhi.”

Një intervistë e gjatë me të dhëna vjen nga miku i hershëm i aktorit, nga Zaimir Mati. Një udhëtim artistik, siç thotë Fatmira Nikolli nga vitet 50-60 të shekullit XX te ceremonia a takimi letrar në kushtim aktorit, regjizorit, skenaristit e shkrimtarit Rikard Ljarja realizuar në Paris në nëntor të vitit 2019. “Faqet e librave të Rikardit janë si skenarë imazhesh të filmave të pa realizuara por që të mbushin me dëshirën e të parit në celuloidin e filmave që do të realizohen”, thotë Zaimir Mati.

Edhe pse me një rezolucion të dobët vjen një fotografi e panjohur gjatë xhirimeve të filmit “Skëterrë ‘43” (Rikardi, skenaristi Bashkim Shehu dhe kompozitori Zef Çoba) me një shënim për ditëlindje botuar për herë të parë nga Dashnor Kaloçi, vetëm pak ditë para se të shuhet aktori i njohur Rikard Ljarja.

Triptiku i Rikardit?! “Arnaut Osmani, Frederik Engels dhe Sigmund Freud”. Ben Andoni këtë e quan gërshetim që ngërthen letërsi dokumentare, ese dhe studim. Është sintezë. Është trajtesë.

Tregimi biblik i parë mbi krijimin: Shtatë ditët e zanafillës hyjnore

Vrasja e vetëvrasja në Lurë në vitin 1983: “Do u baj dam n’ma t’mirin.”

Rapsodia “Tre shokët e Jutbinës”: Arratisja nga burgu dhe mbijetesja (pas vdekjes)

Këtë shkrim e lexova me një frymë. Eposi i kreshnikëve rilexohet. E kaluara duke u rilexuar ndryshohet.

Në shtojcën 40 faqëshe në fund gjenden edhe fotografi nga rolet kryesore të Rikardit, nga pllakatet e filmave si aktor apo regjisor, ballinat e librave që ka botuar, disa nga pikturat e tij dhe Rikardi me familjen.

Mars 2024, Prishtinë

1 Disa nga botimet monografi: Miho Gjini “Mihal Popi”, Botimet Enciklopedike, Tiranë, 1997; Miho Gjini “Naim Frashëri”(Pasardhësi i Moisit), Dituria, Tiranë, 1998; Josif Papagjoni “Kadri Roshi, njeriu që preku lavdinë”, Toena, Tiranë, 2001; Lec Shllaku “Loro Kovaçi” (1903-1966), “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2002; Flori Slatina “Pranvera e Vangjushit”, Orana, Tiranë, 2003; Loro Sata “Legjendat nuk vdesin” (Lukë Kaçaj), PEGI, Tiranë, 2007; Zenepe Luka “Violeta Manushi, kryezonja e skenës”, Triptik, Tiranë, 2007; Albert Z. Zholi “Luftar Paja”, Toena, Tiranë, 2009; Gjovalin Çuni-Gjovalin Gjoka “Pjetër Gjoka 52 vjet në skenë”, Geer, Tiranë, 2009; Gjergj Luca “Madhështia e thjeshtësisë”, “Marin Barleti”, Tiranë, 2010; Liri Brahimi “Unë dhe filmi”, Toena, Tiranë, 2010; Petrit Ruka “Kadri Roshi kalorësi mbi det”, Tiranë, 2011; Roberta Mone (Ndokaj) “Skënder Selimi, dritëhijet e artisti”, Botimet Toena, Tiranë 2012; Andon Qesari “Unë, ti dhe teatri”, AQSHE, Tiranë, 2012; Muharrem Fejzo “Të pathënat”, “Botimet Barleti”, Tiranë, 2015; Albert Z. Zholi “Kujtim Gjonaj dhe magjia e filmit”, Bota Shqiptare”, Tiranë, 2016; Albert Z. Zholi “Reshat Arbana, Artist i Popullit” (Monografi), Shtëpia Botuese “Morava”, Tiranë, 2017; Suzana Varvarica Kuka “Faruk Basha, rrugëtim drejt ëndrës”, Tiranë, 2020; Anila Mema “Tinka Kurti, ditari i një bashkëshorti”, Tiranë, 2021; Josif Papagjoni “Dhimtër Anagnosti”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022; Ester Gjika “Film pas filmi, unë e bija e...” Botimet Toena, 2023; etj. dhe “Duke biseduar me Drita Pelingun”, AQSHE, Tiranë, 2013, etj dhe “Jeta Xhano” (kujtime dhe mbresa të aktorëve të vegjël në filmat e regjisores Xhanfise Kekë), Tiranë, 2012; “13 muaj kineast Viktor Stratobërdha”, AQSHE, Tiranë, 2010; “Vath Koresha, profili në dy pamje” (Zgjidhje dhe përgatit: Petrit Palushi), Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005...

2. Gani Mehmetaj “Magjia e ekranit”, Kosovafilmi, Prishtinë, 2005

3. Filmi dokumentar “Rikard, përcjellja e fundit”, regjisor: Mevlan Shanaj, Skenari: Natasha Lako, kompozitor: Genti Rrushji, 2023

4. Gjergj Luca “Madhështia e thjeshtësisë”, “Marin Barleti”, Tiranë, 2010

5. Ela Baçi në “Albanica”, 20 prill 2008. Ishte periudhë kur kisha arritur të intervista shumë kineastë, disa prej të cilëve nuk i botoja dot! Faqe 93. Ela kërkon intervistë. “... a nuk tregon asnjë lloj interesi kur i kërkon një intervistë apo kur dëshiron ti bësh një portret.” Dhe kështu më ndodhi edhe mua në vitin qershor të vitit 2018 gjatë takimit me aktorin Rikard Ljarja, kur edhe më dhuroi romanin “Josifopedia”.

6. Në nëntor të vitit 1993, në stacionin policor në Klinë, 16 veta shumica profesor, pështymë dhunshëm nën kërcënimin e egër policor serb në fotografinë e Ibrahim Rugovës! Dikush më shumë e dikush më pak kishte dhembje! Ndoshta të gjithë! Ishte një nga çastet për të cilat vite më pas disa turpëroheshin e ca të tjerë edhe krenoheshin!

7. Udhëtuarkam nga Prishtina për në mjediset e Universitetit Evropian të Tiranës. Për të takuar aktorin. U përhëndetëm me Fatos Baxhakun, skenaristin e ciklit të filmave dokumentar “Sytë e lumit”. Takova për herë të parë shkrimtarin Bashkim Shehu. E pyeta për prijten e botimit nga “Pika pa sipërfaqe” të tregimeve të Jorge Luis Borges. Më tha që i kam përkthyer dhe tashmë “së shpejti do të dalin, punën time e kam kryer”. Po më e rëndësishmja ishin pranë njëri tjetrit dy autorët e filmit të vitit xhiruar në vitin 1980 dhënë premierë në mars 1981 “Skëterrë ‘43” regjizori Rikard Ljarja dhe skenaristi Bashkim Shehu!

8. Parantëzë nga “Rikardi, nuk kam asnjë peng”, Onufri, Tiranë, faqe 163:

“U hap dera dhe vura re se i ngjite ato dy shkallë me zor. Pse qenka kaq i lodhur”, thashë më vete. Pastaj filloj një ceremoni e vogël për promovimin e një libri timin (se mbasi mbarova me kinemanë, kam filluar të shkruaj meqë s’bëj dot film më).

Pas pak po e kërkoja me sy se ku ishte futur, po nuk e pashë.

Ishte hera e fundit që e shikoja.

Më vonë mora vesh se ishte sëmurë dhe erdhi.

Kaq sëmurë ishte sa nuk arriti të qëndrojë deri në fund, e megjithatë erdhi.”

## TRE SKICA Nga Doruntinë Ramadani



### MONOLOG ME PASQYRËN QË E THEVA VETË

Epo, po, ja tek jemi..unë, një pasqyrë e thyer, pika gjaku gjithandej, duart të thata e të vrara.

Nuk jam hiq më pak se ç’meritoj, madje meritoj më keq se kaq. Nuk meritoj të ushqehem këtu ku jam me taksat e një shoqërie të ndershme e të dashur, as atyre që protestojnë atje jashtë kundër meje.

Jam mëkatar po aq sa jeta, jam kaq i padrejtë me të gjithë, fillimisht me veten, me një vogëlush që u mësua akoma pa i bërë një vjet të ec, jam i padrejtë me atë nxënësin që mësonte përmendësh në shkollë poezitë e Fishtës e Asdrenit, me atë djalin e ri që krenohet me sakrificën e familjes Jashari. Po, jam ai fëmija i mbarë që u bë përbindësh për pak kohë. PSE?

Jam rritur pa dashuri, mes dhunës dhe frikës, dhe sot jam më i dhunshëm se vetë dhuna, jam më frikësues se djalli, kam dy duar që nuk kanë takat, shkatërroj gjithçka para meje; vras, rrah, çfarë nuk bëj unë me tërë agresivitetin që kam brenda...

Jam kështu si jam, zot shtëpie kudo që hedh hap, sepse nuk kam pasur kurrë një shtëpi timen; sepse askush nuk doli të më ndaloj vërtet. Madje, edhe këtu ku jam, ndihem i tillë, nuk është që po vi për herë të parë, prandaj me të ardh e theva pasqyrën dhe qava dorën, dhe aspak aroma e gjakut nuk po më pengon, as këta gjymtyrë të mitë të mavijosur... a e di pse?

Sepse, e kam rrahur dhe torturuar një njeri të njomë deri në vdekje dhe pa pikë dhimbje e kam çuar 24 orë pasi ka dhënë shpirt në spital.

Kaq i keq jam.

Kam thyer, kaq e kaq zemra, për shumë nëna jam ankh, jam terri i natës në një kohë dhjetori të ftohtë...

Si nuk doli bre dikush të më ndalojë me kohë?

Nuk e di kur do të dal, apo si do të dal, por sido që të vejë puna kam disa falenderime:

Faleminderit familjes sime që nuk panë kurrë të mirë diçka te une, dhe mora tepozjën, faleminderit shokëve të mi që qeshnin teksa rrihja të vegjlit e lagjes, vetëm të tregoja të fortin para të dobëve. Këta shokë sot janë mësues, ekonomistë, madje njëri i lagjes poshtë është i biri i prokurorit në njërin nga veprat penale të miat. Faleminderit policëve që jo rrallëherë kanë mbyllur sytë karshi sjelljeve të mia, faleminderit edhe drejtorëve të burgjeve që më lironin para kohe, nuk kanë qenë pak, për dy e kam fjalën.

...dhe po, kam edhe kërkimfalje, por duke qenë se më mungon njerëzia askush nuk do të më besojë, andaj mos më falni më, sepse duke me falur arrita të vras dhe të ikë pa kthyer kokën mbas.

Faleminderit që më dhatë jetë, faleminderit që po ma merrni.

Me shumë respekt, djali juaj i llastuar,

adoleshenti arrogant, problematik, burri dhe babai i dhunshëm me dorë kriminelin.

Shënim: Gjatë vitit 2021 një vrasje e një vajze 18 vjeçare në Ferizaj tronditi Kosovën, e cila dyshohet se u vra barbarisht nga i dashuri i saj.

### NGA FRIKA JOTE U BËRA NJERI

Nanë...

Me netë s’kam fjetur nga frika se do t’i harroj sytë e ty, e zërin tënd. Megjithatë, një natë më zuri gjumi e më nuk më tingëllon zëri yt.

Nanë...

Më ka djegur lëkura nga dhimbja, më janë larë e më janë tharë sytë, s’kam dashur t’i ndalojë lotët se kisha frikë se venitej dhimbja për ty, por ata u ndalen një ditë, e unë sot më shumë ndjej krenari se mall.

Nanë...

Jeta s’na ka dashur as mua as ty! Megjithatë unë i falenderohem asaj nganjëherë, jo për gjë tjetër por ngaqë jam mësuar të jetoj pa ty, e harroj t’i hakmerrem ndonjë ditë si kjo, kur më bie lapsi në dorë dhe e modernizoj dhimbjen duke e hedhur në fletë.

Nanë...

Ka kaluar kaq kohë e gjatë, kanë ndodhur kaq e kaq gjëra pa ty. Shpesh, dua të mendoj si do të ishin me ty, por ta hajë dreqi nanë, s’ia dal dot. A munden vallë gjithë këto vite të përbihen brenda natës?

Nanë...

Ahh nanë, sa bukur duket kur të drejtohem kështu, imagjino si do të përgjigjeshe ti, do kërceja nga gëzimi unë, e shfrenuar dhe e lumtur deri në asht. S’e di, kam frikë edhe ta mendoj.

Nanë...

Akoma më dridhen gjunjat kur e mendoj si ike, se ajo ike më ka bërë njeri. Nga frika se do të rritem pa ty, i jam kapur vuajtjes pas dhe asnjë ditë s’e kam lëshuar. Druhesha se po u shkëputa nga ajo të harroj ty.

Nanë...

E sheh sa vështirë është një jetë pa ty, një jetë kur shkëputesh nga trupi, e bredh venave pa gjak, pa ajër, e përplasesh mes dallgësh pa ditur not. Ah nanë, mjerë ti e mjerë unë; mjerë ti që braktise ëndrrat e tua, e mjerë unë që po jetoj ato pa bekimin tënd.

### UNË DHE VALIXHJA IME E RËNDË!

Ne po ikim dalëngadalë, po i mbledhim plaçkat dhe po nisemi me zemrën bosh e sytë lotë!

Po iki edhe unë, ashtu siç kishte ikur edhe babai im, me zemrën copë-copë, dhe pa pikë krenarie kishte marrë plot herë një rrugë që secilën herë që ai udhëtonte unë e mallkoja! Sot, unë po nisem rrugës së tij, por mua vallë kush do të më mallkojë?

Po iki edhe unë, ashtu siç kishte ikur edhe i dashuri im, rrugëve të zymëta pa jetë, i lodhur, e i shkatërruar! Kur kishte ikur ai, një copë zemre ma kishte marrë, një ma kishte lënë, prandaj unë sorokatesha lartë e poshtë deri sa paketova valigjen, dhe u nisa drejt tij.

Po iki edhe unë, me një diplomë në valixhe, me dy-tri kurse gjuhësh, me një CV të pasur, dhe po i shkrijë të gjitha në një fjalë të vetme „emigrante“.

Po iki me një fotografi të nënës sime, miratimin e së cilës nuk besoj që do ta kisha për ta braktisur, megjithatë unë kam vendosur dhe po largohem!

Po iki, me kokën poshtë që po lë këtu pjesë të shpirtit, për të cilët çdo ditë do të më marr malli! Po largohem për t’u rritur, e them kështu sepse njeriu del nga shtëpia vetëm kur e ndjen se mund t’ia del mbanë vetë, dhe unë për ta ngushëlluar qenien time nuk po e them se po iki për një jetë më të mirë!

Dreqi ta hajë, po iki pak për hatër e pak për qejf! Më falni për të dyja, por kam udhëtuar mjaft rrugëve pa jetë, dhe egoja ime po kërkon diçka tjetër, dhe unë po i dorëzohem prapë erës!.



Pranuar njëzëri si kryevepra poetike e Sadik Bejkos, vëllimi "Letër Hamurabit" u botua për herë të parë në vitin e largët 1996. Pjesë e vëllimit është dhe poezia me të njëjtin titull, e cila përbëhet nga gjashtë strofa katër vargëshe dhe mund të lexohet fare mirë si një monolog dramatik. Teoritë moderne të letërsisë e shpjegojnë monologun dramatik si një formë të poezisë të shkruar në vetën e parë. Poezia rrëfëhet nga këndvështrimi i një personazhi imagjinar që i drejtohet një publiku të padukshëm. (1) Kjo letër e Bejkos e shkruar çuditërisht në kohën e pergamenit duket se është konceptuar si e tillë jo pa shkak. Drama ekzistenciale që ajo përcjell është e njëjtë për njeriun e të gjithë kohërave, prej antikitetit e deri në bashkëkohësi.

Është drama universale e shpirtërave të rrënuar në të njëjtën mënyrë, si në epokën e pergamenit, si në epokën e shpikjeve të mëdha teknologjike. Pavarësisht u të bujshme e vezulluese në dukjen e jashtme të dukurive, ajo tjetra, bota e brendshme mbetet përherë e njëjtë, e pandryshueshme, njësoj tragjike, njësoj e brishtë. Murgari i shpellës Aram është një personazh imagjinar dhe publiku i tij i padukshëm perceptohet si i tillë falë dy funksioneve të poezisë; së pari sepse publiku nuk i përket vetëm një kohe apo një vendi, edhe pse në leximin e parë të poezisë duket se mesazhi poetik adresohet drejt epokës së Hamurabit, mbretit të gjashtë amorit të perandorisë së lashtë babilonase, ndërsa në të vërtetë publiku real është qenia humane e gjithëkohësisë, dhe së dyti, sepse murgari e shkruan letrën në vetminë e një shpelle dhe ia drejton mbretit të tij. Në rastin e dytë publiku kamuflon dhe fshihet pas një personazhi të vetëm, mbretit Hamurab. Letra e shkruar në vetmi është monologu i poetit filozof që deshifron të vërtetat e hidhura të një shoqërie pa ligje.

Në rrafsh sintagmatik, poezia mund të lexohet edhe si poezi satirizuese për problemet e shoqërisë shqiptare të pas viteve '90. Një zë i së vërtetës në shëmbëllimin e një murgari që shkruan ligje që do të mbeten veç në letër, për një shoqëri që ka marrë të tatëpjetën në udhëtimin prej diktaturës në anarshi politike e morale. Është po aq imagjinar zëri i së vërtetës këtu dhe po aq i padukshëm publiku i supozuar shqiptar.

Duke qenë se dy nga tri karakteristikat e një monologu dramatik janë perspektiva e vetëreflexive dhe publiku i heshtur (2) të dyja të realizuara mjeshtërisht në këtë monolog të murgarit me veten dhe dialog me të tjetrin/të tjerët "e pagojë", na mbetet të hetojmë udhën nëpër të cilën monologu kryen zbulimin e ngadaltë të karakterit (3) të atij që rrëfen veten me përvujtni e tronditje madhështore.

Në strofën e parë të monologut drama zë fill me pyetjen: "Nga budallallëku im pse më nxorre?". Murgari sapo e ka kryer misionin për hartimin e ligjeve dhe prapë se prapë nuk ndjen gëzim. Përfaqimi i ligjeve nga njerëzit e atdheut të tij i duket utopi. Vetë jeta e tij si simbol i dijes, dritës, diturisë i përngjan një realiteti joreal për të tjerët jashtë shpellës. Vargu i strofës së dytë "Jam shpella ime e përvojtur imzot.." e përfon edhe më tej mendimin e patundshëm të murgarit për të tjerët jashtë habitatit të tij. Deklarata se jam shpella ime e përvojtur nënkupton të vetmuarë e pashoq në kufijtë e një përndritje që të tjerët nuk mundën ta kuptojnë. Murgari rrëfen për "pak dritë, pak ujë, pak vaj", ndërkohë që na shfaqet i pangopur me dituri.

Strofa e tretë nis me deklaratën: "Uji, uji është drita është drita e eshtrave të mia të thara". Përsëritja dy herë e shenjuesit "ujë, ujë" duket se bie ndesh me deklaratën e parë pak ujë. Lexuesi model zbulon se më parë ai "pak ujë" apo pak etje, duke u vënë në antitezë me pangopjen për dituri, vendos të parin shpirtin në raport me çdo gjë tjetër jashtë tij, ndërsa në strofën e tretë

Poezia e Sadik Bejkos

# LEXIMI I POEZISË "LETËR HAMURABIT" SI MONOLOG DRAMATIK

Nga Alisa Velaj

uji shndërrohet në simbolin e ekzistencës njerëzore. Uji si rrjedhë e dritës, uji si rit pagëzimi i të vërtetave që ngjizin kuptimin e vërtetë të ekzistencës. Uji që mungon në shpirtërat e tharë të të tjerëve jashtë habitatit të murgarit filozofi.


Strofa e katërt dhe e pestë vazhdon të shtjellojë më tej argumentin zanafilor të monologut dramatik: njerëzit janë me nga një hambar terri mbi shpinë dhe nën tru. Është aq tragjike padija e tyre sa fjala dhe logjika nuk do të arrijë t'i shpëtojë dot. Ndoshta duhet përdorur dhe kamzhiku i xhelatit...Zvetënim i ka prekur çdo qelizë të njeriut dhe shoqërisë. Murgari trembet se as këshilltarët dhe gjeneralët e urtë të mbretit s'do mundën ta kuptojnë. Monologu dramatik i mëshon një gjendje pa rrugëdalje të rrëfimtari. Përmasë përvujtnisë dhe vetmisë së tij, ai na skalit portretin e një shoqërie në kufijtë e absurdit apokaliptik.

Letra e tij për mbretin e një vendi që u shkatërrua dhe nuk u rindërtua më asnjëherë (ashtu si edhe ishte parathënë në Shkrimet e Shejta) shndërrohet në testamentin poetik të njeriut vizionar që parandjen shkatërrimin e një ideali, e një atdheu, e një epoke vlerash të përmbytura pa kthim pas.

(1) Howard, Claud, The Dramatic Monologue: Its Origin and Development, Studies in Philology, Vol. 4, University of North Carolina Press, 1910.

(2) Po aty.

(3) Po aty.



Poezia e Sadik Bejkos

## LETËR HAMURABIT NGA MURGARI I SHPELLËS ARAM

Imzot Hamurab, mua plakun e përvojtur pse më nxore nga shpella ime, nga budallallëku im pse më nxorre?! Nën dritat e shandanëve me arin e gjithë botës sot po e shkruaj rreshtin e fundit në kode.

Jam shpella ime e përvojtur, imzot... eshtrorë, e gurtë... Më mjafton pak dritë. Ha tullat e librave, i brej si brejtësit. Më mjafton pak ujë. Pak vaj dua për kandilin, pak bukë. Më mjafton plasa e mekur e diellit në mur. Thinjat e mia trembin gjeneralët e tu, këshilltarët e tu të urtë.

Uji, uji është drita e eshtrave të mija të thara. Ç'më duhen teatrot, hipodromet, stadiumet e vulgut... lumë, djersë dhe gjak?

Imzot Hamurab, nuk e mbaj dot shpatën. Lavirhanet e tregut e të valleve për gjakun tim të mpakur nuk ngrenë dot rrjeta, as lak.

Pse më torturon, zoti im, me sjellje të këso bote? Njerëzit këtu janë me nga një bodrum të zi, me nga një hambar terri mbi shpinë dhe nën tru. Kur ata bien nga shpellat në bodrumin e vetes, për ta s'ka më nënë, bir, mik e të dashur, janë më të ftohtë se një gur, më të thatë se një dru.

Në atë bodrum ata shqyhen egër mes veti. Ti më kërkon të vë ligje për ta, të gdhend kode, imzot. Ata duan dhëmbët e qenit, shkopin e xhelatit, Imzot Hamurab, ata s'i ndreq që nuk i ndreq dot. ... Ja, t'i hartova ligjet, merrri kodet e tua, për mua zoti, zoti im me ligjin e tij të pamort.

Imzot Hamurab, më i madh se qytete dhe muret, te shpella ku kthehem, le të mbulohem krejt me pluhur. Dhe uroj: në hipodromet, stadiumet, lavirhanet e tua nga bodrumet e zinj të njerëzve, u derdhtë më pak gjak dhe lot i purpurt.

Edukimi dhe arsimimi janë detyra dhe përgjegjësi më e madhe e një shteti serioz, me vizion dhe që punon për të ardhmen e vendit e të kombit të tij. Pikërisht për të realizuar këtë mision na vjen në ndihmë një libër jo vetëm interesant, por me shumë vlera metodike, konceptuale, sistemore, përgjithësuese e praktike i profesor Bardhyl Musait. Është fjala për monografinë "Arsimi në demokracinë e brishtë"! Kjo monografi nuk është vetëm një punim përshkrues, me të cilin në marrim njohuri si si ka rrjedhë zhvillimi i arsimit në Shqipëri pas rënies së perdes së hekurt dhe Murit të Berilinit. Ky libër është një udhëzues metodik jo vetëm për ata që punojnë në fushën e edukimit dhe të arsimit. Por edhe për administratën publike dhe vetë politikën shqiptare.

"Arsimi në demokracinë e brishtë" merr vlerë të jashtëzakonshme, sepse në këtë monografi pedagogjike jo vetëm për mësuesit, por edhe për politikën dhe administratorët e shtetit, gjejmë këshilla dhe mendime racionale e logjike lidhur me kalimin nga metodat e sistemit totalitar të arsimitit, te metodat e reja në kushtet e një rendi demokratik e të hapur të zhvillimit të edukimit. Autori ka trajtuar në mënyrë origjinale, shumicën dërmuese të problemeve të kohës, duke nisur me përgatitjen e mësuesve dhe vijuar më tej me çështje të tjera si zhvillimi e praktikës profesionale, sistemin e mentorëve, të menduarit kritik në mësimdhënie, kurrikulumin shkollor, kompetencat mësidhënese e analizat e të nxënës, menaxhimin e situatës me tekstet shkollore etj. Vend të veçantë ze matura shtetërore, ligji për arsimin e lartë, akreditimi në këtë nivel arsimimi dhe mendimi e administrimi i çështjeve arsimore.

Nga tematikat e mësipërme sekush sheh që kemi të bëjmë me arsimin në përgjithësi dhe menaxhimin e administrimit e tij në kushtet e një rendi të ri demokratik. Libri pasqyron dinamikat e zhvillimit të arsimit shqiptar pas rënies së diktaturës komuniste, evidenton arritjet e përvojat pozitive, reflekton ndaj gabimeve dhe nxitimeve në vendimmarrje në këtë fushë dhe para së gjithash rekomandon që sëmundja e përmbyesjeve kur pushteti ndërrohet të mos aplikohet së paku në arsim. Nga pikëpamja strukturore monografia e profesor Musait "Arsimi në demokracinë e brishtë" përmbledh gjithsej 12 tema, shumicën prej të cilave e përmendëm më lart. Kësaj duket se është një punim shkencor jo vetëm logjik e racional, por edhe me një tematikë kronologjike të pasur.

Karakteristika e kësaj monografie tejte cilësore dhe me rëndësi të veçantë për arsimin shqiptar lidhet me një lloj gërshetimi të dijeve teorike, dhe përvojës praktike të autorit, për të cilin lexuesi lehtësisht mëson se ka kontribute të veçanta në këtë sistem, deri rektor i Universitetit të Elbasan dhe këshilltar për arsimin i kryeministrit të Shqipërisë. Autori ka krijuar gjithashtu një eksperiencë të ndërthurur në bashkëveprim me aktorë dhe faktorë europianë e amerikanë, me të cilët ndan në këtë libër përvoja interesante, këshilla, mësimet e reflektime të çmuara.

Dhe jo vetëm kaq! Profesor Bardhyl Musai në monografinë e tij na shfaqet autentik, jo konformist, me një diapazon dhe mendim krejt të pavarur. Ai na mëson se si një autoritet shkencor do të duhet të jetë jokonformist e të mos pajtohet me status-quo-në. Kjo duket që në kapitullin e parë të librit, ku shpreh mospajtimin e tij për të aplikuar një sistem arsimor të modelit totalitar. Psh., ai kundërshton idenë e një sistemi arsimor që përgatit mësues në dy nivele, atë të shkollës së mesme dhe universitar. Ai këmbëngul me çdo kusht ndërtimin e një niveli në përgatitjen e mësuesve, të modelit universitar për të gjitha ciklet e arsimit.

Idetë dhe refleksionet e prof. dr. Bardhyl Musait shfaqen për ndryshim që në vitet e para të vendosjes së sistemit demokratik në Shqipëri, kur është fjala për ristrukturimin e modelit të përgatitjes së mësuesve. Por



Libri "Arsimi në demokracinë e brishtë" i profesor Bardhyl Musait

# NJË LIBËR I ÇMUAR PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIN

Prof. dr. Enver Bytyçi



duket se rekomandimet e tij nuk vrasin sa duhet veshin e shoqërisë e të institucioneve shtetërore të kohës për shkak të ndikimeve të së shkuarës. Ptrandaj ai e zhvillon më tej idenë e rolit të arsimit në shoqërinë demokratike, kur përcakton shprehitë bazë të shoqërisë së dijes. Ndër to veçojmë motivimin për të mësuar përtej arsimit bazë, të nxëniet e dijeve në mënyrë të pavarur, aftësinë për të përpunuar informacionin dhe shprehitë digjitale, aftësitë për të qenë krijues në zgjidhjen e problemeve, në sipërmarrje, në komunikim etj.


Prof. dr. Bardhyl Musai na kujton përmes këtij libri se është ndërmjetësuesi i lidhjes së zhvillimit të arsimit shqiptar sipas modelit të Bolonjës. Sistemi i Bolonjës është modeli evropian i zhvillimit të arsimit, sidomos atij të lartë. Autori e trajton këtë lidhje si një domosdoshmëri për reformën arsimore në tërësi dhe pjesën e përgatitjes së mësuesve në veçanti. Për profesor Musain përgatitja e mësuesve dhe edukimi i tyre nuk është thjesht shpenzim fondesh dhe energjish. Përkundrazi është investim me përfitime të mëdha për një arsim cilësor dhe për një të ardhme të sigurt të vendit.

Nuk besoj se dikush tjetër në sistemin tonë akademik e ka trajtuar këtë temë me kaq përgjegjësi, kaq përmblendhtas dhe me kaq shumë njohuri të thella. Monografia "Arsimi në demokracinë e brishtë" na ofron dije e kulturë, eksperiencë dhe rekomandime

ideore, pedagogjike, strukturore, për programe e kurrikula shumë të rëndësishme për politikën arsimore e zhvillimore. E gjithë struktura e kësaj monografie është ndërtuar sipas një koncepti bashkëkohor të të menduarit kritik, si një shprehje e domosdoshme që mundëson të përballojmë sfidat e shekullit të 21-të, shkruan autori. Të mësuarit dhe vlerësimi kritik i dijeve, sipas profesor Musait, zhvillon mendimin e pavarur dhe fillon me pyetje që kërkojnë përgjigje. Ndërkohë kjo mënyrë e perceptimit dhe realizimit të të nxëniet kritik i bën njerëzit fleksibël, i largon ata nga koncepti i të mësuarit në mënyrë dogmatike, me përkufizime standarde dhe bën që mësuesit, nxënësit e studentët të vendosin në bazën e diskutimit, debatit dhe dijes logjikën dhe racionalitetin.

Libri është një udhërrëfyes, doracak pedagogjik dhe metodik i përsosur. Ai përmban frymën e përgjegjësisë për strukturat e shtetit dhe instancat arsimore për zhvillimin e arsimit, sidomos në fushën e përgatitjes cilësore të mësuesve. Në këtë kuptim autori e sheh shumë të rëndësishme këtë aspekt për të arritur rezultatet e nevojshme në vlerësimin ndërkombëtar të nivelit të dijeve dhe të arsimit në Shqipëri. Ky vlerësim sintetizohet të sistemi "PISA", përmes të cilit realizohen sondazhet dhe bëhet rankimi i nxënies së dijeve në vendet e ndryshme të Europës e të globit. Ky lloj barometri për sistemin arsimor dhe aftësitë e nxënësve për të lexuar, shkruar dhe përvetësuar dijet është sistemi kryesor krahasues i sistemit të të dhënave për sukses ose mos-sukses në fushën e arsimit.

Monografia e prof. dr. Bardhyl Musait "Arsimi në demokracinë e brishtë" është e duhet të jetë substancë e metodës së punës për sistemin arsimor, deri te Ministria e Arsimit dhe Sportit e të shërbejë për të mirën e përbashkët, përmirësimin e vazhdueshëm të reformave në arsimin parauniversitar dhe atë universitar. Dashtë zoti dhe formulat, rekomandimet, propozimet, argumentet e përfundimet që dalin nga ky libër bëhen pjesë e projekteve të reformave në vendin tonë, me qëllim që të ngrëm nivelin e arsimit e të dijes sonë!



Nga kritika gjermane për romanin e Stefan Çapalikut "Mbyllur për pushime", botuar në gjermanisht nga "Transit Verlag" me titullin "Tirana ein kurzer traum", përkthyer nga Zuzane Finger. (Marrë nga "Deutschlandfunk Kultur", datë 18 mars 2024).

## Nga kritika gjermane për romanin e Stefan Çapalikut "Mbyllur për pushime"

nga Marko Martin



Tri histori dashurie në kohë lufte, një në Romë, një në Salzburg, një në Tiranë, një në botën artistike, një në një manastir, një në Shqipërinë e atëhershme kaotike. Një roman tërheqës dhe i stuhishëm. Ky është përshkrimi në tekstin shoqëruar të librit „Mbyllur për pushime“ titulli në gjermanisht „Tirana Ein kurzer Traum (Tirana. Një ëndërr e shkurtër)“, i autorit Stefan Çapaliku. Mjedisit historik i këtyre historive është faza e vonë e Luftës së Dytë Botërore dhe libri tregon për ngjarje midis shtatorit 1943, kur Italia u dorëzua dhe u rreshtua në krah të fuqive perëndimore, dhe nëntorit 1944, kur Shqipëria u çlirua, pra periudha kur italianët tërhiqen dhe trupat gjermane pushtojnë Shqipërinë.

Fjala është për një roman të shkurtër. Nuk kemi të bëjmë me një epike opulente kombëtare. Por mendoj se teksti i shkurtër, që shoqëron si reklamë botimin, nuk i përgjigjet tamam përmbajtjes së librit. Sepse nuk kemi të bëjmë vetëm me histori dashurie, por me histori marrëdhëniesh, dhe jo me idile të rrema, histori që ndodhin në kuadrin e historive të ngjarjeve të luftës dhe të pushtimit gjerman.

Njerëzit që njohim në roman janë të lidhur në një mënyrë pak a shumë tragjike me këtë të ashtuquajtur histori të madhe. Kemi një familje të klasës së mesme, e cila detyrohet që të paktën të bashkëpunojë indirekt me administratën gjermane. Pastaj një emisar nazist të rangut të lartë bashkë me dashnoren e tij serbe, i cili urdhëron pushkatimin e rivalit të tij shqiptar, me pretekstin se gjoja është partizan. Dhe një Don Zhuan, që kishte shkuar në Itali për shkak të artit dhe të dashurisë, por që më pas kthehet në Shqipëri, ku punon si përkthyes për partizanët. Me qëndrimet e tij liberale ky shkakton menjëherë trazira të stalinistët, prej të cilëve natyrisht që kishte në masë në radhët e partizanëve.

Edhe pse kjo nuk është tabloja e plotë e romanit, shkurt mund të thuhet se në roman njihemi me njerëz që brenda kësaj historie të madhe prezantohen me historitë e tyre të vogla në thonjëza dhe të cilëve ndonjëherë u duhet të sajojnë histori të rreme për jetën e tyre, pra si të thuash të gënjejnë veten.

Kemi të bëjmë pra më shumë me luftë për mbijetesë sesa me histori dashurie. Dhe

interesant është fakti se autori nuk bie në grackën e narracionit të tipit „oh ai i gjori, apo ajo gruaja e panjohur“ që u shtypën dhe u mbytn nga historia e madhe. Pjesërisht kjo është e vërtetë, por në njëjtën kohë ata njerëz kishin sigurisht edhe opsione për të shkuar në njërin drejtim ose tjetrin, me të gjitha kontradiktat, mungesën e konsistencës dhe mospërputhjet. Nazisti p.sh. nuk trajtohet si ndonjë përbindësh *per se*, por përshkruhet si njeri i natyrshëm, kuptohet si një njeri i keq dhe i poshtër, por në një mënyrë mjaft realiste. Sipas meje autori përshkruan jetën të tërësinë e saj, por jo në një mënyrë pompoze, plot ojna dhe llafe, por në një mënyrë të thukët, të ngjeshur, me fjali të përpikta, të përmbledhura në kapituj të shkurtër.

Ajo që e bën këtë roman të shkurtër prej më pak se 150 faqesh të veçantë, është se ai është shumë intensiv, pa qenë manipulues. Në kapitujt e shkurtër personazhet na shfaqen si njerëz të vërtetë prej mishi e gjaku. Por nga ana tjetër lexuesit nuk i jepet mundësia për t'u identifikuar me ta, pra që dikush të thotë: oh, këtë ose atë e kam përjetuar edhe unë kështu, ose edhe unë jam ndjerë kështu apo ashtu. Romani ofron diçka të huaj, të pazakonshme, të panjohur, të çuditshme, çka nga ana tjetër minimizohet nga një përshkrimi i jashtëzakonshëm, sa i pasaktë dhe preciz i këtij autori. Për ta thënë në mënyrë më popullore, autori nuk përpiqet t'u lëpihet lexuesve që t'u pëlqejë, gjë që për mua është një gjë e mirë.

Mendoj se autori ndoshta i bën homazh dhe mund të ketë marrë si shembull romanin e madh të autorit serb Alexander Tišma „Përdorimi i Njeriut“, por ndoshta ky edhe mund të mos ketë qenë fare qëllimi i Çapalikut.

Sidoqoftë „Mbyllur për pushime“ / „Tirana Ein kurzer Traum“ është një libër i rëndësishëm që ua rekomandoj patjetër lexuesve. Ai tregon jo vetëm diçka për fazën e vonë të Luftës së Dytë Botërore, por edhe për ambivalencën e jashtëzakonshme të gjendjeve kur njerëzit bashkohen ose i detyrojnë të bashkohen.

Përmbledhje nga intervista e kritikut letrar Marko Martin për radion publike gjermane „Deutschlandfunk Kultur“ përgatitur në shqip nga Pandeli Pani



## Stina e dashurisë

Ta themelojmë një stinë të re,  
lë të quhet stinë e dashurisë,  
pak pranverë, verë sa për t'i pjekë frutat,  
vjeshtë sa për t'i rregulluar ngjyrat  
dhe dimër sa për t'i zbardhë ëndrrat.

Ta themelojmë stinën tonë,  
një gramatikë të re fjalësh.

Tingujt të mos jenë stinë, të jenë diçka në  
mes,  
dhe foljet të mos jenë të parregullta.

Dhe pastaj ta themelojnë mbretërinë tonë,  
me lumenj dëshirash që nuk ndalen kurrë,  
me lumenj dëshirash që kthehen  
në secilën stinë - e gurgullojnë -  
e gurgullojnë, dhe ne e thyejmë rregullin e  
moçëm,  
dhe lahem dy herë në të njëjtin ujë.

Yje, lule, buzëqeshje dhe së të gëzuar  
dhe piktura dashurie, dhe askund pemë të  
ndaluara,  
as gjarpër, as Kain.

Lë ta themelojmë stinën tonë,  
e malet të mos duken të larta,  
e luginat të mos jenë të thella,  
e ne të ulemi mbi maja malesh,  
e të themi fjalë lartësish për ujdhesat,  
fushat dhe luginat e fatit.


Lë ta themelojmë stinën tonë, në një djep  
plot ëndrra  
dhe t'i përkundim duke kënduar ninulla  
dashurie,  
për veten dhe për të tjerët.

Dhe në fund, lë të shkundim pluhurin  
dhe historitë që janë ngjitur nëpër thembrat  
tona  
e të hyjmë triumfalisht në këtë stinë,  
të mbështjellë me të gjitha stinët nga pak.

## Poeti

Sytë e poetit janë kombinim i të gjitha  
ngjyrave.  
Shohin në errësirë e ia ngulin sytë diellit.  
Zemra e tyre nuk matet në peshore.  
Ka formë të papërcaktuar.  
Poeti i ndien që larg therjet në gjoksin e  
njeriut,  
në mes therash nuhat kopshtet me lule.  
Fluturon me zogj. Nuk i përfill kufijtë  
dhe fjala e tij shkakton tërmete të bukura.  
Ty më pyet:  
Poeti, si i përshkon shtigjet e dhimbjeve?  
A ngjitet në pemë të ndaluara?  
A dalldiset kur kalon nëpër kopshtet e  
dashurisë?  
Sa peshon pikëllimi i tij kur e sheh këtë tokë  
të shkretuar?  
Si e gjen udhën të hyjë në zemrat e njerëzve  
dhe të nxjerr kristale magjepse thellësish?  
Shpesh më pyesin: çka bën poeti?  
Ata që nuk i ndiejnë dhimbjet,  
ata që nuk nuhasin bukuritë e natyrës,  
që kalojnë pranë një peme të bukur dhe nuk  
e kthejnë kryet,  
që nuk tmerrohen kur shohin sykëqij,  
që nuk digjen flakë kur bien në dashuri.  
Shpesh më pyesin: çka bën poeti  
e çka sheh ai?  
Më pyesin ata që nuk kërkojnë anijet e  
fundosura,  
ata që nuk zhyten thellë në errësirë,  
ata që nuk magjepsen me dritën e hënës,  
ata që nuk lexojnë shenjat e motit të ligë,  
ata që nuk bien në dashuri me një libër.

Poeti jeton në magjinë e tingujve,  
i përcjell shenjat e motit të ligë  
dhe me valë të trazuara zemrash  
krijon simfoni për ditë të ëmbla dashurie  
dhe dhimbje fonebre.  
Po, poeti bëhet zog, fluturon me retë e  
lumturisë,  
përmes zemrave të trazuara,  
ec edhe nëpër prush,  
e kapet nëpër flatra lartësie, ngjashëm si  
lkari,  
fluturon lart, por kurrë nuk shkrihet,  
kurrë nuk bëhet hije  
e as harta ku të tjerët vizatojnë kufij.



## Përfaqim

Për herë të parë,  
jam pikëlluar pafund kur e kam kuptuar  
se përfaqoj është një folje kalimtare,  
vjen dhe ik, si të gjitha gjërat e mira.  
Sa mirë do të ishte,  
kjo folje të ishte e rregullt, jokalimtare,  
një gjendje njerëzore  
dhe unë të zgjohesha i përfaquar,  
ashtu siç bie në gjumë.  
Përfaqohet dita me natën,  
afrohet një breg me një tjetër,  
përmes një ure. Përfaqohen stinët,  
kur i lëshojnë vendin njëra-tjetrës.  
Kurse unë ndiej nevojë të përfaqoj,  
si të ishte ti universi dhe unë një terr i zi  
që të fut thellë në gj.

## Pritja

Pritja është stacion, po stacion ngujimi,  
një strehë si qielli, ku përshkojnë re të  
bardha e të zeza  
e prej ku godasin stuhi errësire e dielli.

Pritja është stacion, po, stacion ku nuk matet  
koha,  
e ku hapësira është e paformë, pa kalendar,  
ku hyjnë e dalin trena të stërbushur me  
dëshira  
dhe ku njerëzit presin të ndodhë diçka e re.

Mund të jetë prirje njerëzore, e ngjashme me  
shpresën.

Kur jemi në dimër, zgurdullojmë sytë  
dhe presim ardhjen e pranverës.  
Kur jemi të mërzhitur, mbajmë veshët hapur,  
që të dëgjojmë kur troket lumturia.

Dhe vonë e kuptojnë se lumturia kurrë nuk  
troket, ajo është një botë, një botë që nuk  
vjen natyrshëm si pranvera, si dimri, si  
mërzia.  
Ajo shfaqet ku nuk kërkohet, udhëve të  
parrahura,  
në lëvizjen e reve, larg stacionit të pritjes.

Ne gjakojmë të rritemi e tek vonë e kuptojmë  
se foshnjëria është gjendje e përhershme,  
e pritja, stacioni i vërtetë i ekzistencës sonë.

Ne presim të mësojmë gjëra të reja,  
të rritemi e të bëhemi nxënës,  
pastaj bëhemi udhëtarë kohësh,  
përshkojmë udhëve të rrahura,  
si nëpër tregime të cilave ua dimë fundin.

Dikur vonë ecim në ato udhë që çelim vetë.  
Ecim nëpër mëkatet që trashëgojmë,  
pastaj nëpër ato që bëjmë vetë.

Ne presim përherë,  
presim një punë më të mirë, më shumë  
dashuri.  
Presim të vjen dimri, të kënaqemi në  
bardhësi,  
të gjuajmë retë me topa bore.  
E kur na ngrihen fjalët,  
kërkojmë pranverën, livadhet e gjelbra,  
pemët plot lule  
dhe duam të shndërrohemi në pranverë.

Kur jemi të rraskapitur, të tradhtuar,  
presim të vjen pushimi i verës,  
të nisemi drejt plazheve të shpirtit,  
diku larg në ishulthin e fshehur të lumturisë.

Por zor mësohemi të dalim nga stacioni i  
pritjes,  
të dalim prej kësaj strehe fatale,  
të mbyllim një derë,

si një histori që duam ta harrojmë  
dhe çelësin ta asgjësojmë.

## Jemi rrethuar me pemë të ndaluara

Kopshti i jetës sonë është përplot pemë.  
Ullinj, trëndafila, lule tërfili, thera,  
por ne më së shumti i shohim pemët e  
ndalura.

Joshemi, tundohemi dhe rrëshqasim nëpër  
fjalë,  
rrëshqasim bashkë me fjalët.  
Përherë rrëshqasim,  
përplasemi nëpër korridoret e lumturisë  
apo të trishtimit.  
Më shumë rrëshqasim nëpër kohë,  
nëpër detin e tërbuar të ndjenjave  
në atë det që kurrë nuk qetësohet,  
nëpër ato dallgë dëshirash.  
Dëshirat në jetë njohin vetëm rritjen.

Përplasemi përherë në sytë e kohës,  
në sytë e zi, në sytë e gjelbër,  
në sytë blu si deti o si qielli,  
o në sytë e pafund të dashurisë,  
në ata ë me ngjyra pa emër,  
por më së shumti përplasemi me  
pamundësinë,  
nëpër rrënojat e Babelit,  
të pashtjelluara nëpër këmbët tona.

Pastaj shtrihemi në kopshtin e madhe të  
jetës,  
si në atë fustanin e gjelbër,  
që të dëfton pemën e ndaluar  
e sytë tundues të gjarprit.

Në jetë jemi të rrethuar me pemë të  
ndaluara.  
Mbrëmje, muzg. Terr i pa formë.  
Dallgë dëshirash që rriten e ku duhet të  
lundojmë.

E drita e zemrës sime ndizet si reflektorë,  
mund të jenë paqe,  
me shkëndija që formojnë yje në qiell,  
yje që shndrisin qiellit tim.  
Dhe unë kaloj nëpër dyert e kohës,  
diku mbylli shtigje,  
por më shumë hapi dritare,  
që të pushoj në kopshtin madhështor,  
ku harlisem përherë,  
sa herë shoh ë të bukur,  
si paqja ndanë detit,  
si qielli i kthjellët dhe zhytëm i tëri në ta.

Ti e di se udhët e kohës janë plot të  
papuritura,  
të dhemb zemra dhe të duhet dora e mjekut  
ose e atij mjekut që nuk ka mantel të bardhë,  
por shkruan fjalë të bardha.

## Terr

Natë! Shikoj diçka që nuk përkon me terrin  
dhe ky mospërkim më hap horizonte.  
Është terr, si në fillimet e kohëve.  
veshët i kam hapë që të dëgjoj  
buçimën e një zëri,  
një zëri që vjen nga misteret e kohëve  
dhe flet me një gjuhë që e kuptojnë të gjithë:  
“le të bëhet drita.”

Dhe drita le të bëhet,  
e njerëzit të kundrojnë sa i bukur është një  
çast drite,  
kur jeta zhvishet nga terri dhe shfaqen  
livadhet plot lule,  
e qielli bëhet fushë e pafund,  
spektakël për zogjtë dhe retë e lumturisë.

Por diçka të rëndësishme mund të mësohesh  
edhe në terr:  
se zhurma e paqartësisë mund të shndërrojë  
në terr,  
në një tokë të djegur,  
prej së cilës nuk sheh lulishtet fatit të  
gatuara për ty.

Në terr nuk ndien hovet e gëzimit,  
që të çlirojnë trupin nga pushtet i natës.  
Në terr nuk dallon asgjë, e as hijen tënde,  
as sytë e butë që mund të jenë diku afër  
duke kërkuar, duke pritë,  
duke vuajtë për sytë e tu plot dritë.

Megjithatë, në terr e mëson se  
të shpëtosh prej pushtetit të tij,  
asgjë nuk të duhet më shumë se drita,  
ajo dritë e vogël që bie në zemër të errësirës,  
si kandili që e mbajnë duart e forta  
brenda një dhomë të zhytur në terr dhe  
trishtim.

## Si ftohen stinët

Ndodh shpesh e ëndrrat formojnë akullnajë,  
e në to të rrëshqasin njerëzit,  
e pastaj zhyten në mjegull e shndërrohen në  
mjegull.

Ndodh shpesh të shkrihen ëndrrat,  
të bëhen lumenj,  
liqene mjellmash  
dete dashurish,  
oqeanë pafundësish  
dhe njerëzit të lahen në ujëra lumturish.

Ndodh ndonjëherë ëndrrat të bien si gjethe  
vjeshte,  
gjethe shumëngjyrëshe dhe të tretën në  
dheun e zi,  
që pastaj të kthehen në piktura apo poezi.

Ndodh që ëndrrat të duken yje, nën dritën e  
hënës,  
pastaj të bien në gjumë si një trup i  
rraskapitur,  
e të mbulohen me batanije frike.

Po, ndodh, që një mëngjes të ketë kuptimin  
krejt mëngjes,  
mëngjes i ri-  
si një puthje sipari që nis një udhëtim të ri.

Po, ndodh që një ditë,  
dhimbjet të formojnë armë shkatërrimi,  
për të cilat askush nuk kujtohet.

## Humbës të mëdhenj

Humbim orët e paçmuara  
duke shikuar horizonte të largëta,  
dhe nuk ndiejmë aromën e luleve përreth  
nesh.

Dalim nga errësira, por nuk e braktisim  
terrin.  
Dalim nga trishtimi, por na rëndon mendjen  
e djeshmja.

Jemi humbës, e dashur.  
Kohët i ndrydhim në një thes arnash,  
formuar prej ditëve të këqija,  
dëshpërimit, atyre orëve të hutuara të pritjes.

Dhe harrojmë çastet e bukura,  
fragmentet e lumturisë,  
lundrimin nëpër qetësinë e natës  
nën vështrimin e yjeve,  
kur drita përfaqohet me errësirën dhe bëhen  
një.

Ne jemi humbës.  
Na pëlqen të ecim skajeve të rrezikut  
e të mos prekim asnjë çast dyert e tij.

Por kur zhytemi në të,  
shndërrohemi,  
sepse jemi humbës e dashur.

Lundrojmë nëpër ditët shkuara  
ose në ato që duhet të vijmë,  
si anije e dëbuar nga brigjet  
që e godasin valët  
apo si një jetë e lënë në një varkë,  
të cilën dikush dikur e lëshoi në një lumë,  
në një lumë që rrjedh pandërprerë.



Nëse ka një gjë që nuk e honeps fare nga udhëtimet jashtë shtetit, janë kontrollet në pikat kufitare. Më duket se aty të gjithë trajtohen si të dyshuar. Duke e menduar këtë, sa hipa në makinë në Parga, para se të nisesha për në Tiranë, thashë t'i kem gati pasaportën dhe dokumentet e makinës. Hapa xhepin e kroskotit dhe i nxora. U përshëndeta edhe një herë me mikpritësit e mi dhe i futa marshin makinës. Një zë më bëri të frenoja pa ecur as tre-katër metra. Kisha harruar aparatën fotografikë në hollin e hotelit dhe roja vrapoi të ma sillte. E falënderova dhe u nisa.

Mizën e vura re që pas kthesave të para. Nuk kisha arsye ta prishja terezinë. Vërtet kishte ardhur pa ftuar, po ishte njëllor si një pasagjer i rastësishëm e i panjohur, të cilit nuk kishte kuptim t'i jepje muhabet; shpejt do t'i thoshim lamtumirë njërit-tjetrit. Më duhet ta them që në fillim se mizat më bezdisin, i kam inat. Nuk them i urrej. Vetëm gjarpërinjtë dhe minjtë i kam neveri. Nuk besoj se ka njeri që mizën e quan një shoqëruese të mirë. Shoqëria e keqe është si kanceri, duhet trajtuar sa më shpejt që të jetë e mundur, këshillova veten. M'u duk e mjaftueshme ulja e xhamit që ajo të largohej me dëshirën e saj. E quajta këtë si stad të parë të trajtimit. Por ajo qëllon nga ato mysafire që vërtet nuk priten me mjalte, por duhen ndjekur me uthull. Të dy e kuptuam se beteja mes nesh do të ishte e pashmangshme. I hodhëm nga një vështrim njohës njërit-tjetrit si luftëtarët para dyluftimit.

Kisha dëgjuar për mungesën e etikës nga ana e mizave, madje edhe për paturpësinë e tyre kur, pa i ftuar, i afrohen tavolinës ku ti drekon dhe të ulen në krah. Nxitojnë të provojnë të parat copën e bërçollës së viçit – nuk refuzojnë as ato të derit – para se ti ta fusësh në gojë. Guximi dhe trimëria e tyre herë-herë i kalojnë caqet e imagjinatës sonë kur ato sakrifikojnë edhe jetën në pjatën e supës dhe kjo ose kalon pa u vënë re nga ana jonë, ose përfundon duke i shfryrë kamerierit, apo duke e kërcënuar në emër të shoqatave në mbrojtje të kafshëve. Nëse deri më sot kjo nuk ka bërë kauzë, jo se ne nuk kemi ndjeshmërinë e duhur, po sepse ende studiuesit po grinden mes tyre se ku duhet ta fusin mizën, te kafshët apo te shpendët. Tani për tani – dhe kjo po zgjat mijëra vjet – njeriu e quan mizën insekt, pra një sekt brenda llojit, por pa përcaktuar se për cilin lloj e ka fjalën.

Po kthehem te miza në makinë. Nga njohuritë e mia modeste m'u duk si mizë kali dhe e para gjë që i thashë vetes ishte fakti se kisha qëlluar me fat, që kësaj krijese që ma shpifte, nuk i ishte tekur të hynte në makinë me gjithë shoqëruesin e saj, pra me kalin. Hapa xhamat dhe i rashë disa herë borisë që ajo të trembej e të dilte jashtë, po asaj nuk iu drodh qerpiku. E them nga inati se nuk ia pashë sytë, pasi isha i përqendruar te rruga. Ama ajo, me siguri, ca lente nga të syve i kishte kthyer nga unë. Ju e dini, besoj, se në sytë e mizës ka miliona lente gjashtëkëndore dhe secila prej tyre funksionon më vete dhe sheh gjëra të ndryshme.

Pra, isha i bindur se ajo më kishte nën vëzhgim dhe kjo më nervozonte akoma më shumë. Po jo deri në atë masë sa të përpiqesha ta vrisja mizën me pëllëmbë, siç bëjnë disa njerëz kur ajo u rrotullohet dhe është gati t'u ulet mbi majën e hundës. Kjo metodë mund të ishte për mua me më shumë pasoja, mund të humbisja kontrollin e makinës dhe sa para do bënte vrasja e mizës. Ai jorgani që digjet për një plesht nuk është asgjë para vlerës së makinës, apo, mos, o Zot, edhe kokës sime. Dhe më e bukura është se me shumë gjasa miza do ia hidhte paq. Deri më sot në të gjitha kronikat për aksidentet me makinë



## MIZA NË KABINËN TIME

*Tregim nga Jani Malo*

në asnjë rast nuk kam dëgjuar të flitet për miza të vdekura. Përkundrazi, e di mirë se ato bëjnë të parat inspektimin e kufomave pasi janë ku e ku më të shpejta se makinat e policisë apo se edhe vetë ambulancat.

Mendova se duhej gjetur një mënyrë më pak e rrezikshme dhe shumë më efikase për ta hequr qafe. Kisha dëgjuar se mizat përzihen duke varur diku një qese me ujë. Nën refleksin e diellit ajo do t'i dukej mizës si një rrjetë gjigante merimange dhe frika nga burgosja e përjetshme në të do ta bënte të largohej. Hodha ujë në një qese plastike që e kisha në makinë dhe e vara pranë xhamit në krahun e pasagjerit. Eksperimenti rezultoi dështim për mua dhe mjet argëtimi për mizën. Ajo shkante e përplasej atje gjithë qejf sikur luante me një tullumbace të bardhë, ndërsa nga lëvizja e makinës uji zuri të përhapej nëpër kabinë.

Kur ndalova në doganë, nxora pasaportën dhe hodha një sy edhe nga bashkudhëtarja ime. Ajo nuk bëri asnjë lëvizje. Rrinte e heshtur mbi kroskot.

- Vetëm jeni? - më pyeti polici duke hedhur një vështrim brenda kabinës, që m'u duk se kishte një dozë provokimi.

- Po, po! Vetëm, - nxitova të them me pakëz hutim.

Aty për aty seç ndjeva një lloj frike. Kisha dëgjuar për pëllumbat spiunë, që u vënë mikrofonta dhe i përdorin për të përgjuar, por për miza me çip ende nuk kisha dëgjuar të flitej. Trupi i saj kaba – sa mund të përdoret kjo fjalë për një mizë – mund të çonte e shumta te mendimi se ishte një mizë e modifikuar gjenetiksht.

Hutimin tim të përkohshëm polici e përktheu në dyshim dhe kërkoi të kontrollonte makinën. Me një elektrik dore bëri dritë në vrimat ku nuk hynte syri dhe u ra me shkelm gomave. Miza prapë nuk e prishi terezinë. Polici më vështrroi çuditshëm, sikur unë të kisha përhapur përreth një aromë aspak të këndshme, bëri shenjë me kokë për të ikur dhe më tha:

- Dhe hiqe atë mizë nga makina!

U dhashë të drejtë atyre që mendojnë se sytë më vigjilentë në botë janë ata të policit dhe të gruas.

I dhashë gaz makinës dhe ndërrova stacionin grek të radios, valët e të cilin nuk kapnin më nëpër rrugën me kthesa, me një stacion vendi. Tallavaja mbushi kabinën. Ishte një këngë për një dashuri të humbur. Miza u zgjua dhe sikur mezi e kishte pritur, filloi të vinte vërdallë nëpër kabinë. Me gjasë kërcente. Por më shumë dukej të kishte melankoli dhe trazim sesa pasion dhe qejf në kërcimin e saj. Ndërrova kanal përsëri. Po miza nuk u dorëzua. Përkundrazi, nën ritmin e muzikës lëvizte nga njëri cep i kroskotit tek tjetri, përplaste këmbët dhe krahët, ndonjëherë edhe kokën në xhamin e përparmë. Në një moment u përku mbi këmbët e saj dhe ngriti lart dy krahët transparentë në gri të argjenditë. Me gjithë përpjekjen time për ta parë si një helikopter të sapo ulur, ashtu nervoze ngjante më shumë me xhinde xhuxhe. Shtoi shpejtësinë e lëvizjes së krahëve, nuk është çudi të ketë qenë pranë rekordit prej 1000 përplasjesh në sekondë, që thonë se e mban një mizë amerikane.

Ndalonte pak çaste dhe rifillonte me të njëjtën këmbëngulje të frikshme. Përplasej në xham. Rikthehej mbi kroskot. Vraponte. Fluturonte. Përplasej përsëri. Sikur kërkonte të sakrifikohej.

Mund të kem anashkaluar ndonjë detaj dhe ju mund të mos jeni të bindur, por unë jam i sigurt se kaq këmbëngulje rezervohet vetëm për diçka hyjnore.

Sinqerisht, filloi të më vinte keq për dhimbjen e saj. U ndjeva në faj po aq sa edhe këngëtari që me muzikën e tij melankolike i kishte trazuar ndjeshmërinë e brishtë. Për një çast harrova edhe bezdinë edhe neverinë. Kishte diçka përtej së zakonshmes së jetës së një mize. Të hyja brenda hallit të saj e kisha të pamundur, por edhe ta quaja mizë të çmendur do ishte mendjelehtësi. Me të drejtë shkencën

e kishte tronditur lopa e çmendur, por lajthitja e krijesave kaq të vogla zor se do bënte njeri të merrej seriozisht. Në një kthesë miza pati një avari të vogël, përplasi kokën fort në xham dhe ashtu e trullorur ra në ndenjësën e pasagjerit. Egoizmi im paskej qenë i pashembullt. Nuk i kisha kërkuar të vinte rripin e sigurimit dhe as i kisha dhënë kokore, megjithëse rregullorja e qarkullimit rrugor nuk parashikon as njërën dhe as tjetrën në rastin e qenieve jonjerëzore.

Ajo qëndroi pak çaste pa ndjenja. Pastaj lëvizti, shkundi krahët dhe, si për të më bërë karshillëk, bëri disa xhiro të plota nëpër kabinë. Shumë shpejt iu rikthye ritualit të saj të shëtitjeve mbi kroskot. E di që hapat e saj, edhe pse në dukje përplaseshin fort, qenë shumë të butë, por mua në vesh më vinin të fortë, dëgjoja trokun e këmbëve të saj, a thua se kishte veshur këpucë me taka.

Pak më tej, një tufë lopësh më prenë rrugën. Aty për aty kujtova se bytha e kalit është një nga vendpushimet më të preferuara për mizat. Nuk kisha ndonjë informacion nëse kjo vlente edhe për bythën e lopës, gjithsesi mendova se ky ishte rasti për ta provuar. Edhe pse nuk mund ta dija nëse ky mendim ishte edhe në kokën e mizës, hapa xhamat e të katër dyerve me shpresë se gjeta momentin për t'u ndarë në paqe me bujtësinë time të paftuar. Gabova. Iu nënshtrova një pritjeje të bezdisshme, derisa ajo filloi edhe një herë me ato përplasjet e forta në xhamin e përparmë. Nëpër mend më kaluan llojlloj marrëzish, e megjithatë nuk isha në gjendje të kuptoja arsyen e këmbënguljes së saj prej mushke për të mos dalë nga kabina. Edhe pse dukej sheshit se ajo po luante me nervat e mi, e këshillova veten të ruaja qetësinë. Po ta gjykoja me cinizëm, do thosha se me gjasë po synonte që fjalën kokëmushkë në fjalorin e shqipes ta zëvendësonte me kokëvizë.

Më në fund u dorëzova. I hapa rrugë mizës. Le të bëjë ç'të dojë, thashë me vete.

Edhe pas kësaj, ç'është e vërteta, nuk pashë asgjë të re në sjelljen e saj që të më bënte të ndërroja mendim për mizat. Ndërrova vetëm radhën e fjalëve: deri sot kisha menduar se mizat janë të ndyra dhe të bezdisshme, tani them se janë të bezdisshme dhe të ndyra. I hoqa sytë nga miza, po mendjen tek ajo e kisha. Mendoja mbërritjen në Tiranë. Hutimin e zakonshëm të atij që vjen për herë të parë në një vend të huaj ku nuk njeh njeri. Një mendim i frikshëm më kaloi në kokë. Po sikur të mos më ndahet, të më kërkojë t'i gjej hotel apo edhe t'i jap darkë. Po sikur...

Pa kuptuar më filloi dhimbja e kokës. Hapa krahun dhe ndalova makinën. Miza dukej e heshtur, e lodhur. Pa fuqi, shpresëhumbur. Zgjata dorën e djathtë dhe hapa xhepin e kroskotit për të marrë një tabletë për dhimbjen e kokës. Miza kërcëu dhe u ul butë, fare butë, mbi pëllëmbën e dorës sime. E mora si shenjë ndjese. Mos u pendua për andrallat e shumta që më kishte sjellë? Nuk e ngacmova. Zgjata dorën në sirtar dhe kapa kutinë e tabletave. Kaluar mbi dorën time hyri edhe miza.

Atë që ndodhi më pas nuk do ta besoni. Nëse nuk do ta kisha parë me sytë e mi, nuk do ta kisha besuar as unë. Kur nxora dorën nga xhepi i kroskotit, mbi pëllëmbë qëndronin dy miza. Të pashqetësuar, po edhe pa turp, ishin shtrënguar fort me njëra-tjetrën.

Vetëm pak sekonda më vonë, lidhur trup më trup, të bashkuara në një, ato fluturuan tej dritares. Nuk di pse desha të besoj se diku do ta kthenin kokën prapa dhe disa nga ato miliona lentat e syve të tyre do të përcillnin drejt meje një përzierje ndjenjash të ndryshme.

Shpresova të mbizotëroheshin nga mirënjohja.



## Shpërfillja e ëmbël e botës (Fragment)

1.  
Ajo vjen më viziton shpesh, shumicën e herëve natën. Qëndron në këmbë pranë shtratit, më vështron nga lart dhe më thotë: je plakur. S'ma ka me të keq; zëri i tingëllon i hareshëm, plot dashuri. Më ulet buzë shtratit. Por flokun, më thotë duke ma shpupuritur me dorë, e ke prush të dendur, si gjithmonë. Veç të është thinjur. Vetëm ti s'plakesh, i them. Nuk jam i sigurt, nëse kjo më trishton apo më lumturon. Nuk flasim kurrë shumë; e çfarë na ka ngelur më për t'u thënë. Koha fluturon. Vështrojmë njëri-tjetrin dhe buzëqeshim. Ajo vjen pothuajse çdo natë, ndonjëherë ende pa zbardhur dita. Kurrë s'ka qenë e përpiktë, por nuk e kam problem; sa më pak kohë më ka ngelur, aq më shumë kohë i jap vetes. Nuk bëj asgjë tjetër, veçse ta pres dhe, sa më vonë të vijë, aq më gjatë kam mundësi të lumturohem.

Sot më doli gjumi herët e u ngrita brof. Nuk doja ta prisja në shtrat. Vështa pantallonat e mira, xhakëtën dhe këpucët e zeza e u ula në tryezën ndanë dritares. Krejt i gatshëm.

Ka ca ditë që bën ftohtë, mbi çati dhe lëndina ka rënë dëborë dhe nga oxhaqet e fshatit ngrihen shtëllunga të holla tymi. Nxora prej sirtarit kornizën e vogël me foton e Magdalenës, të cilën e kisha prerë shumë kohë më parë nga një gazetë, ku fytyra thujse nuk i dallohej fare. Letra tashmë është zverdhur krejt, por është e vetmja foto që kam prej saj dhe, vështrë se kalon qoftë edhe një ditë, pa ia hedhur të paktën një vështrim. Lëmoj me gishta kornizën e hollë prej druri e më duket sikur prek atë: lëkurën e saj, flokun e saj, format e trupit të saj.

Kur hedh sytë sërish tej dritares, e shquaj Magdalenën përjashta. I del avull nga goja, më buzëqesh dhe ma bën me dorë. Buzët i lëvizin; e marr me mend se po më thërret. Eja! Përsërit ajo dukshëm, në mënyrë të tillë, që t'ia lexoj lehtë buzët. Le të bëjmë një shtëtitje. Po vij, i përgjigjem duke thirrur, më prit! Tmerrohem nga gërvishja e ngjirur e zërit tim, si të jem plak; një zë, që më është po aq i huaj, sa trupi i epuar ku jam zënë rob. Aq shpejt sa mundem, vesh pallton dhe shallin. Nxitoj teposhtë shkallëve dhe për pak sa s'thyej qafën mbi gurët e rrëguar të tyre. Sa dal nga shtëpia, Magdalena ndërkohë është larguar. E ndjek në drejtim të lumit kah ura e këmbësorëve, e cila të çon për karshi fshatit të fëmijërisë sime; arrij pranë pellgut ku ushqenim rosat kur ishim fëmijë; te vendi, ku dikur isha përplasur keq me biçikletë; aty ku takoheshim dhe ndiznim zjarr netëve kur ishim të rinj. Më duket sikur jam bërë pjesë e kësaj panorame, e cila nuk ka ndryshuar aspak me kalimin e kohës.

Magdalena pothuajse ka mbërritur tek ura. I hedh hapat aq lehtë, sa duket sikur pluskon mbi rrugicat e mbuluara me borë. Në nxitim e sipër kisha harruar bastunin dhe vërtitesha sa para mbrapa mes frikës se mos shkel mbi akull, se mos rrëzohem dhe më humb nga sytë Magdalena. Prit!, e thërras përsëri, nuk jam më aq i shpejtë sa dikur.

Më shfaqen imazhet, se si ajo rendte në mal para meje, se si kërkonim në qytet udhët tona, se si ecnim krah për krah kryq e tërthor Stokholmit atë natë kur po i tregoja historinë time, kur po i tregoja historinë e saj; atë natë, kur më puthi.

Ajo kthehet drejt meje dhe më buzëqesh. Eja, pra, më thërret. Eja pranë meje!

2.  
Magdalena duhet të jetë çuditur nga mesazhi im. Nuk i kisha dhënë as numrin e telefonit dhe as adresën, vetëm orën, vendin dhe emrin tim: Ju lutem, ejani nesër në orën katërbëdhjetë te *Skogskyrkogården*<sup>1</sup>. Dua t'ju tregoj një histori. Po e prisja në dalje të stacionit të trenit. Në dy e një çerek ende s'kishte ardhur; mendova një çast se mund të kishte marrë taksì. Kjo vonesë nuk do të thoshte asgjë, ajo ishte gjithmonë e pa përpiktë; jo në mënyrë të vrazhdë, për t'i treguar pritësit se koha e tij ka më pak vlerë se e saja, por më tepër në formë shkujdesjeje,

Përkthyer nga Anna Kove dhe botuar nga "Aleph"

## Peter Stamm vjen në Tiranë me dy romane "Agnesa" dhe "Shpërfillja e ëmbël e botës"

Peter Stamm, autori më përfaqësues i letërsisë bashkëkohore të Zvicrës, mbajtes i çmimeve më të rëndësishme letrare të botës gjermanike dhe i nominuar për çmimet më të rëndësishme botërore, u lind në vitin 1963, studioi anglisht, psikologji dhe psikopatologji për disa semestra dhe punoi në profesione të ndryshme edhe në Paris e Nju Jork. Ai jeton në Zvicër si shkrimtar në profesion të lirë që nga viti 1990. Prej romanit të tij debutues "Agnesa" në vitin 1998, janë botuar edhe shtatë romane të tjerë, pesë përmbledhje me tregime, një vëllim dramash, shumë radiodramatizme. Në shqip promovohen për herë të parë dy romane të tij: "Agnesa" dhe "Shpërfillja e ëmbël e botës", përkthyer nga Anna Kove dhe botuar nga "Aleph".

"Agnesa" është pjesë e kolanës me 100 librat më të mirë të letërsisë gjermane të shekullit të shkuar. Ndërsa "Shpërfillja e ëmbël e botës" u shpall romani më i mirë i vitit 2018 në Zvicër.

Autori vjen në Tiranë për lexuesin shqiptar ditën e hënë, më 08 prill, ora 18:30, në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, ku ftohet të marrë pjesë çdokush i interesuar për të dëgjuar lexime nga romanet në shqip dhe për të bashkëbiseduar me vetë autorin.

Në datën 19.04. ora 11:00 do të jetë i ftuar nga Departamenti i Gjermanishtes, në Sallën Europa" të Fakultetit të Gjuhëve të huaja, dhe në 11.04. ora 11:00 në Bibliotekën Shkencore të Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër.

ashtu siç kishte jetuar gjatë gjithë jetës. Isha i sigurt se do të vinte, se kureshtja e saj ishte më e fortë se mosbesimi.

Pesë minuta më vonë arriti treni i radhës; tek po mendoja se nuk ishte as në këtë tren, ajo u avit duke zbritur shkallët pupthi. Do të doja të më kishte vënë re menjëherë, por pa e parë mirë akoma, m'u mor fryma sërish si një ditë më parë kur i kisha zënë pritë te hoteli dhe ku, gjithsesi, nuk i fola asnjë fjalë. Të tridhjetat duhet t'i mbushte së shpejti; ishte njëzet vite më e re se unë, por dukej si vajzë e vogël dhe, kush na shihte së bashku, mendonte se ishim babë e bijë. E lashë të më kalonte pranë pa i folur dhe e ndoqa në drejtim të varrezave.

Nuk ta jepte përshtypjen e dikujt që ka lënë takim. Ecte me hapa të shpejtë tatëpjetë, si ta kishte bërë me qindra herë atë rrugë. Mendova se do të më priste në hyrje të parkut, por ajo u fut brenda dhe, pa u stepur, ngjiti një kodrinë të vogël e u ndal pranë një rrethi pemësh të moçme. Rrëzë kodrinës ishte një kryq i stërmadh guri, për më tepër, parku seç kishte diçka si të pa-fe; trualli dhe natyra të linin më shumë mbresë nga godinat e shenjtëruara dhe nga gjithë simbolet e krishtere.

Magdalena qe ulur mbi kodrinë, nën njërën prej pemëve gjethe-vyshkura, dhe po shihte drejt meje, sikur kishim bërë garë dhe ajo kishte dalë fitimtare. Lu afrova pa frymë dhe, megjithëse s'më kishte parë kurrë në jetë, u duk sikur e dinte në çast, se deri këtu e kisha

sjellë unë.

Lena, tha ajo dhe më zgjati dorën. Kristof, i thashë unë, disi i turbulluar, dhe i zgjata dorën. Jo Magdalena?

Askush nuk më quan kështu, tha ajo duke buzëqeshur. Vend i pazakontë për një takim.

Doja të kishim mundësi të flisnim pa u shqetësuar, i thashë.

U ula pranë saj dhe vështruam teposhtë ndërtesave prej gurësh të zverdhur, të cilat duhet të ishin të viteve tridhjetë. Pranë një ndërtese në formë kubike shquhej një çati monumentale, mbështetur në kolona katër këndore; përpara saj, një pellg i madh, i ngrirë. Mbi fushat e valëzuara të peizazhit dukeshin disa njolla bore. Nga hyrja e varrezave u afruan njerëz me pallto të zeza; disa të vetëm, disa në çifte ose në grupe të vogla. Ndaluam përpara njërës prej ndërtesave; një grumbullim i hallakatur njerëzish, që nuk dukej se përshtateshin shumë me njëri-tjetrin.

Më pëlqejnë varrezat, tha Lena.

E di, i thashë.

Bën ftohtë, tha ajo. Po sikur të lëvizim pak? Zbritëm poshtë kodrës. Kortezi ishte zhdukur ndërkohë nën çatinë e shtrirë të kapelës dhe sheshi u boshatis përsëri.

Pranë ndërtesës kishte një shandan me sahat. E çuditshme, tha Lena, duket si platformë treni. U afrua poshtë sahatit, pa lart drejt tij dhe kontrollloi kohën në orën e saj të dorës, si udhëtarë që mezi pret t'i niset treni.

Stacioni i fundit, i thashë.

Më buzëqeshi, por vazhdoi ta luante rolin e saj, derisa unë kërcita disa herë lehtë duart, çka e bëri të kthehej si pa dëshirë. Vazhduam udhën në brendësi të parkut, rrëzë fushave gjeometrike të varrezave, në drejtim të një pylli të zhveshur pishash. Ecnim aq ngjitur njëri-tjetrit, saqë shpatullat nganjëherë na çukiteshin. Lena tani heshtte, por kjo nuk ishte heshtje e padurimtare; mund të vazhdonim ashtu pa folur akoma më gjatë, të preokupuar vetëm me mendimet tona. Si përfundim, tashmë kishim arritur mes pemëve të para. U ndala në vend dhe i thashë: Kam dëshirë të të tregoj historinë time. Nuk m'u përgjigj, por u kthye nga unë me një vështrim më shumë të devotshëm, sesa kureshtar.

Jam shkrimtar, i thashë, ose më mirë, isha shkrimtar. Kam botuar një libër të vetëm e që atëherë kanë kaluar pesëmbëdhjetë vjet.

Edhe i dashuri im është shkrimtar, më tha, ose pretendon të jetë.

E di, i thashë, ndaj dua të ta tregoj historinë time.

Ecëm ngadalë përgjatë shtegut me zall, i cili zgjatej në vijë të drejtë përmes pyllit dhe i tregova Lenës për atë takim të pazakontë para katërbëdhjetë vitesh, i cili qe bërë shkak të hijja dorë nga të shkruarit.

3.

Kisha filluar të punoja për romanin tim të parë prej kohës së studimeve. Konstruktoje ambicioze plot truizma dhe lojëra letrare, të cilat askush nuk donte t'i lexonte, e aq më pak t'i publikonte. Këto përpjekje shumëvjeçare dhe dështime të pandërprera qenë në fund ato çka më ndihën drejt suksesit. Heroi i romanit, për të cilin mbas vitesh gjeta një botues, ishte po ashtu një autor i dëshpëruar, si puna ime. Libri tregonte një histori dashurie. Hamendësohej për një lloj portreti të së dashurës sime, por ndërkohë që po shkruhej, ne u ndamë e kështu u kthye në një rrëfim për ndarjen tonë dhe për pamundësinë e dashurisë. Për herë të parë gjatë të shkruarit ndjeva se po krijoja një botë të gjallë. Njëherësh u shkëputa gjithnjë e më tepër nga realiteti; e përditshmja m'u bë e mërziqshme dhe e cekët. E dashura më la, por, të jem i sinqertë, në kokën time kisha muaj që isha ndarë prej saj, isha harruar nëpër fantazi, në botën time artistike. Kur më tha se nuk mundej më, se i mungoja madje edhe kur isha përkrah saj, pata thjesht një ndjenjë mërzie dhe padurimi.

Romani u prit mirë nga shitësit, nga lexuesit madje i ra në sy edhe kritikës. Ky debutim mbart në vetvete mundësi të pamata për të ardhmen, shkroi një kritike.

E në të vërtetë, pas shumë e shumë kohësh, për herë të parë pata besim tek e ardhmja. Prej vitesh jetoja me fitime të pakta dhe suksezi i romanit më solli të ardhura mbase jo të harlisura, por të mjaftueshme dhe, më e rëndësishmja, kisha në dorë më në fund një libër, që kurorëzonte mundin tim. Vitet e shkrimtarisë së pasuksesshme tani i takonin një kohe të shkuar, të cilën e kisha kaluar i burgosur në labirinte projektsh, të ushqyera nga ambicie të tepruara.

Se sa kishte të bënte me mua historia e librit, nuk e pranova kurrë. Sa herë përballesh me atë pyetje mbas leximeve, përgjigjesha duke ngulmuar në dallimin midis tregimtarit dhe autorit.

Shtëpia botuese organizonte lexime të panumërta dhe më shijonte arratisja nga shtëpia ime e boshatisur; të udhëtoja nëpër vend, të shihja qytete të panjohura dhe të isha i zënë vetëm për ca orë gjatë mbrëmjes. Ndaj hezitova veç një hop, kur më erdhi ftesa nga një librari e vogël në fshatin tim të lindjes. Librashitësi i vjetër më kishte dërguar një letër aq dashamirëse dhe mikluese, saqë pranova. Sa po vinte e po afrohej data, fillova të ndihem nervoz nga ideja e të lexuarit para njerëzve, të cilët më kishin njohur që kur isha fëmijë dhe mund ta bënin lidhjen mes personazheve të romanit dhe jetës sime të tashme.

Ishte fund nëntori. Pak pas mesditës u nisa enkas shumë më herët. Fshatin nuk e kisha vizituar prej vitesh dhe doja të shihja nëse ende realiteti përputhej me kujtimet e mia.

Treni zbrazej gjithnjë e më tepër nga



1 Varrezat e Stokholmit, shpallur pasuri botërore nga UNESCO (sh.p.)



stacioni në stacion, thua se po i afrohej një zone të ndaluar; kisha ngelur i fundit në vagon dhe kontrollorët prej kohës s'ishte dukur. Kur u nisa shkëlqente dielli, por sa më në lindje shkonim, aq më mjegull bëhej, ndërkohë nga dritarja shihej vetëm gri, pyll, pemë të zhveshura, fusha të zymta, një kope dhish dhe herë pas here ndonjë fshat i vetmuar apo ndonjë fermë.

Pak pa mbërritur në destinacion, rruga, që përndryshe ishte thuhaj krejt e drejtë, merrte një kthesë për të kaluar lumin dhe të nxirrte në anën tjetër të luginës. Treni filloi të ngadalësojë shpejtësinë që para kthesës, derisa në fund ndaloi plotësisht. Pjerrësia e trasesë, e cila as që vihej re në lëvizje e sipër, në vendqendrim më krijoi një ndjesi parehatie, si të kisha dalë vetë jashtë binarëve.

Treni qëndroi gjatë ashtu i ndalur, e më pas, përmes një shkundjeje u vu sërish në lëvizje, duke kapërxyer lumin, pa ndodhur asgjë që mund t'i kishte dhënë shpjegim ndalesës. Parehatia më shoqëroi deri sa arrita në fshatin tim. Në dimër këtë krahinë nganjëherë e mbulonte mjegulla edhe për javë të tëra; ishte ai lloj moti, të cilin e lidhja me fëmijërinë si asnjë gjë tjetër: një botë e ftohtë, gri dhe e turbullt dhe njëherësh e sigurt, ku çdo gjë që nuk ishte mjaftueshëm pranë teje sikur nuk ekzistonte. Vetëm kur u largova nga fshati e u zhvendosa në qytet mbas maturës, mësova se sa e pamatë dhe e pasigurt është bota. Ndoshta prandaj fillova të shkruaj, për të rifituar peizazhin dhe sigurinë e fëmijërisë time, nga të cilët e kisha dëbuar veten. Megjithatë mund të largohesha menjëherë mbas leximit, iu luta librashitësit të më zinte një dhomë pikërisht në hotelin e qendrës tregtare, në sheshin e tregut, ku gjendej një restorant dhe një sallë teatri. Para studimeve kisha punuar disa muaj aty si portier nate. Asokohe kompleksi ishte krejt i ri dhe më ish dukur i madh e shumë modern. Tani çdo gjë dukej modeste, e vjetërsuar dhe e zymtë.

Kisha bërë në plan të shëtisja pak përmes fshatit, por, gjatë rrugës nga stacioni i trenit për në hotel, ajo përzjerje mes së njohurës dhe të resë po më shqetësonte dhe irritonte. Madje edhe ndërtesat, krejt njëlloj si ato të fëmijërisë time, m'u dukën të huaja si në një muze, të shkëputura nga funksioni dhe konteksti i tyre.

Ajri në dhomën e hotelit që i thatë dhe me erë mbytëse aromatizuesi për ambiente. U shtriva dhe po mendoja për fshatin, se si kishte qenë më parë. Kur mbylla sytë, çdo gjë ishte akoma aty. Shtëpitë, rrugët, njerëzit, që kishin banuar. M'u kujtua gjallëria gjatë ditëve të tregut, festat me muzikën e bandës frymore dhe fishekzjarrë, por edhe ditët e lodhshme të pranverës, zbrazëtia e ditëve të verës, nanuritja e ditëve me shi të vjeshtës. Çdo stinë e vitit kishte pasur aromën e saj, ato të shiut mbi asfalt, të ziftit të nxehtë, të gjetheve të porsaçelura. Edhe vetë dëborat kishte aromë freskie, të cilën e perceptoja më tepër si shije.

U zgjova nga një zile. Dhoma ishte e errët dhe m'u deshën disa çaste, derisa gjeta telefonin të përgjigjem. Ishte librashitësi, i cili interesohet nëse kisha arritur shëndoshë e mirë dhe nëse kisha dëshirë të vinin të më merrnin në hotel.

Rrugën e gjej vetë, i thashë; nuk ka kaluar edhe aq shumë kohë që kur jam larguar.

Meraku im kishte qenë i kotë. S'njihja askënd nga publiku dhe, që e kisha prejardhjen nga ai fshat, dukej sikur nuk i interesonte njeriu. Mbas leximit m'u bënë pyetjet e zakonshme, ndërsa ato autobiografiket lexuesit këtu duket se i shmangnin. Më vonë shkova me librashitësin dhe disa prej klientëve të rregullt për të pirë verë në një restorant. Megjithatë s'kishim shumë c'të thoshim, prapë ndenjëm gjer vonë. U interesova për ca njerëz nga fshati, por shumicën shoqëruesit e mi nuk e njihnin, mbas vetëm si emra; ata ishin shpërngulur, ishin plakur ose nuk kishin më rëndësi. Të tjerët flisnin për çdo çështje të mundshme të fshatit: intriga politike, histori vogëlsirash për njerëz që nuk i njihja ose që nuk kisha pasur lidhje. Lokali u mbyll në mesnatë dhe me shumë mundësi ta bind librashitësin mos më përcillte deri në hotel.

Gjatë ecjes shkurt përmes rrugëve të

zbrazëta të natës, ndjeva për herë të parë tek më kaploi një ndjesi e njohur, që kishte të bënte më tepër me orën sesa me vendin, me natën; m'u zgjuan kujtimet e rrugëve drejt shtëpisë mbas turneve të gjata nëpër pijetore, pas bisedave që nuk kishin fund me miqtë në kryqëzimet ku na ndaheshin udhët, mbi plane që fluturonin në qiell dhe pritshmëri të mëdha.

Hyrja e hotelit ishte një portë e ulët, rrethuar me gjethe, e ndriçuar dobët; dera e xhamit ishte e kyçur. I rashë ziles së natës dhe vetëm atëherë, ndërkohë që prisja, kuptova sa i dehur isha. Mbahesha me një dorë në xhamin e ftohtë dhe ca minuta më vonë i rashë ziles sërish. M'u kujtuan patrullimet gjatë kohës time si portier nate. Ecja me llambën e dorës përmes sallës së teatrit, mbi skenën e boshatisur, përmes korridoreve të ftohta dhe dhomave të konferencave, deri poshtë në garazh.

Më në fund dëgjova kërcitje e derës dhe m'u duk se pashë vrik diçka që lëvizti në korridor, dera e xhamit u hap dhe një djalë i ri u qas drejt meje. Teksa jepte e merrte me tufën e çelësave, pashë fytyrën e tij krahas pasqyrimin të fytyrës time në xham, por e njoha vetëm kur më hapi derën. Isha unë vetë.

4.

Ç'do të thuash me këtë?, më pyeti Lena. Kishim arritur në fund të shtegut prej zalli dhe qëndruam para një kubi të lartë në ngjyrë okre, pranë të cilit që ndërtuar një portik i stilit grek.

Ajo lexoi me zë qesharak një tabelë në murin rrethues të ndërtesës, një fjalë e padeshifrueshme në suedisht, të cilën pas disa përpjekjesh arritëm ta përkthenim si *Kapela e Ringjalljes*.

Pranë kapelës ndodhej dhe një godinë e gjatë, e sheshtë, ku gjendeshin banjat dhe disa dyer të rënda hekuri.

Mos prehen të vdekurit këtu?, pyeti Lena

duke vendosur pëllëmbën mbi njëren prej dyerve. Mos prehet dikush këtu, duke pritur ringjalljen?

Në fytyrën e saj kishte një pamje paniku përçeshe.

Për ku jemi nisur tani? Pyeta unë. Vetëm mbrapsht jo, tha ajo. E urrej t'u kthehem mbrapsht rrugëve. Ndoqëm të parin drejtim më të përshtatshëm dhe shëtitëm ngadalë më tej përmes rreshtave të varreve.

Në ç'kuptim e thatë, që ishit ju vetë?, pyeti Lena përsëri.

Vështirë të shpjegohet, i thashë; kur pashë djalosin e kuptova menjëherë se unë dhe ai ishim të njëjtët.

Ngaqë edhe ju kishit punuar roje nate?

Jo vetëm nga kjo, i thashë. M'u duk sikur po shikoja veten në pasqyrë. Çuditërisht ai nuk vuri re asgjë nga ngjashmëria jonë. Më përshëndeti krejt natyrshëm, më priu drejt recepsionit, më dorëzoi çelësin dhe më uroi natën e mirë.

Atë natë nuk më zuri gjumi deri vonë. Mendoja vazhdimisht për portierin e natës, sesi ecte tani përmes dhomave të errëta; më dukej sikur ecja përkrah tij dhe ndjeva sërish atë përzjerje të çuditshme frike e turbullimi, me të cilën bëja xhirot e natës asokohe.

Paraardhësi im ishte një burrë i moshuar, i cili deri në natën e dytë ose të tretë më kishte treguar dhe shpjeguar çdo gjë. Në mesnatë duhej kyçur porta e hyrjes, mandej të bëheshin xhirot e kontrollit, të mbylleshin dyert dhe të fikeshin dritat. Më pas duhej të ndihmoja në disa angari të vogla, për të cilat zakonisht nuk harxhoja më tepër se një a dy orë.

Fshija sheshpushimin, rendisja shishesh boshe nga restoranti, hapja derën për ndonjë klient të orëve të vona. Rreth orës dy apo tre të natës merrja diçka për vete nga frigoriferët e kuzhinës. Pastaj mund të shtrihesha në një

kthinë prapa recepsionit, por nuk flija kurrë; në vend të flija, lexoja ose luaja bixhoz me rrogën time në automatat pranë hyrjes.

Ndonjëherë silltesha vërdallë pa qëllim dhe hulumtoja ambientin përreth: një vend krejt i panjohur, në mes të një fshati të njohur.

Ishte një vend për udhëtarët, të cilët takoheshin këtu, të pashqetësuar nga fshatarët, si të ishin anëtarë të një sekti sekret. Herët në mëngjes, pak pas orës katër, trokiste në derën e xhamit shoferi që shpërndante nëpër kioska gazetat dhe revistat. I hapja derën dhe bëja nga një kafe prej automatit për të dy. Shoferi ishte burrë miqësor me një histori të komplikuar, për të cilën më fliste natë për natë me zë të shtruar. Pak mbasi largohesha ai, lija turnin. Asokohe jetoja akoma në shtëpi dhe haja mëngjes me prindërit, dita e të cilëve sapo fillonte, ndërkohë që imja shkonte drejt fundit. Shumicën e kohës flija deri në mesditë. Më kujtohet ato pasdite të çuditshme, kur isha krejt i zgjuar dhe njëkohësisht i përgjumur, ajo ndjesi e shkarjes nga koha dhe e të jetuarit sipas ritmit tim sinkopal.

Të nesërme doja të nisesha herët, por kur ia dola të ngrihem nga shtrati, u nguta të mos humb orarin e ngrënies së mëngjesit. Mbrapa banakut të recepsionit tani gjendej një grua e re dhe për një imtë kohe pyeta veten mos e kisha imagjinuar takimin e natës me alteregon time, apo mos thjesht e kisha parë në ëndërr.

5

Libri po më shitej suksesshëm dhe udhëtoja shpesh sa andej këndeje për të folur mbi të apo për të lexuar pjesë prej tij. Madje ishin nënshkruar edhe disa kontrata përktimi; mbaja korrespondencë me botues dhe përkthyes; më ftuan edhe në disa festivale jashtë vendit.


Fitova një bursë, një shumë goxha e konsiderueshme parash për gjendjen time dhe, duke qenë njeri me pak pretendime, do të mund të jetoja për më shumë se një vit. Por suksesi s'mund të më mashtronte aq sa të mos e kisha idenë se për çfarë do të shkruaja më pas. Herë pas here nisja projekte të reja, vetëm për të hequr dorë i mërzitur e i hutuar mbas ndonjë duzine faqesh. Jo vetëm më kishin shteruar idetë, por edhe gjuha ime e kishte humbur gjallërinë, ndoshta ngaqë shkrimi tashmë më ishte kthyer nga domosdoshmëri në detyrim. Ndonjëherë, për javë me radhë, nuk shkruaja as edhe një fjalë të vetme dhe humbisja kohën me lexime të kota apo me kërkime të paqëllimta për projekte, të cilat më pas as nuk i merrja në konsideratë. Jetoja ende në të njëjtën shtëpi, ku kisha jetuar së bashku me të dashurën. Çdo gjë ma kujtonte atë, kohën që kishim kaluar bashkë dhe, aq i lumtur sa isha për suksesin tim letrar, po aq e vuaja edhe mungesën e saj.

Takimi i asaj nate nuk m'u hoq kurrë nga mendja gjatë gjithë kohës.

Njëherë madje telefonova në hotel dhe u interesova për portierin e natës, por të dhënat që përmenda ishin aq çoroditëse dhe arsyet për interesimin tim aq të pa baza, saqë gruaja në anën tjetër të telefonit u bë mosbesuese, derisa më pyeti edhe njëherë për emrin dhe më pas nuk pranoi të më thoshte asgjë më tepër. Fillova të shkruaj për sozinë time; ashtu si edhe në librin tim të parë, kjo ishte më pak një tentativë për të sjellë një tekst letrar, sesa për t'i dhënë kuptim asaj çfarë kisha përjetuar. Kësaj here nuk pata sukses, historia në të vërtetë ishte shumë më absurde dhe shumë më komplekse, nga sa mund ta përfshija unë në shkrim.

Mendoja shumë për të dashurën, lexoja letrat që i kishim dërguar njëri-tjetrit, shikoja fotografitë e pushimeve tona. Nuk kishim para, por megjithatë kishim udhëtuar shumë, kishim ngjitur male, kishim kaluar net në hostele apo në çadra kampingu. Ajo ishte aktore dhe shpesh kishte javë të tëra të lira ndërmjet njërit angazhim dhe tjetrit. Ishim të lumtur me njëri-tjetrin, ndonëse herë pas here pyesja veten çfarë shihte tek unë dhe ç'kisha bërë për ta merituar. Kaluam së bashku tre vjet, e megjithatë, mes shumë të tjerash kjo pyetje më mbeti enigmë.

Nga gjermanishtja Anna Kove





Një roman me densitet të jashtëzakonshëm poetik, *Dashuria dhe njeriu me flatra*, (titulli në origjinal: "Perëndia mbrapsht dhe e dashura", shën. ynë) shkruar nga Visar Zhiti, i kërkon lexuesit pak kohë për t'u mësuar jo aq shumë me kthjelltesinë dhe qashtësinë e imazheve të marra nga realiteti i papërpunuar dhe të dhëna sipas një rendi kujtese ose imagjinate, por dhe me troçitjen faktike.

Megjithëse një roman i bëmave të kujtuara, thellësisht të brendëzuara dhe të mbarura nga një model kulturor i përjetimit të dramës, megjithëse një ravijëzim i brendshëm i fakteve në një orë drejtpeshimi midis një sive të mëdha kohore, historia nyjtohet në mënyrë epike dhe propozon një dyfishim të trajektore faktike, me lirikën dekoruese të interierëve të dramave të mëdha.

Në lëçitjen e këtij libri nevojitet një kohë shtesë leximi, në të cilën harmonitë e tragjedisë mund të prodhojnë dridhërimin e mëvonshme dhe kështu të riprodhojnë në mendjen e lëçitësit muzikën e dramës, jehonën e saj.

Shtresëzimi i rrëfimit, përmes vendosjes alternative në rrafsh të ndryshme narrative, më pas, duke projektuar nënshtresën thellësisht lirike si lëndë e tejdukshme dhe e rrjedhshme, e cila lejon përfshirjen e zgjatimeve të reja epike, e bën romanin *Dashuria dhe njeriu me flatra* një shembull të mjeshtërisë autoriale të poetikës romanore. Sigurisht një tragjedi, në një botë bashkëkohore, e cila, e tërhequr në margjinë, duke asgjësuar mitet e mëdha dhe duke e rrëgjuar perceptimin e botës në dinamikën e vetëlëvizjes, pa pika referimi kulturore, epistemike apo fetare, e ka vrarë tragjedinë, e eliminon atë nga menjëhershmeria e shkrimit, romani Visar Zhiti nuk është anakronik. Përkundrazi, në përputhje me një prirje europiane për të ringjallur qendrën e eposit parak, pa lënë pas dore përzierjen e zhanreve specifike për shkrimin e këtyre kohërave - shkrimtari shqiptar është mjeshtër i kësaj zgjidhjeje të shkrimit nën shenjën e synimit të tij, jo i përfrimit me modën - në afërsi të një prirjeje për të ringjallur mitet parake dhe rigrupuar mjetet poetike në kuptimin e rikrijimit të një rrugëtimi të gjerë epik.

Visar Zhiti na ofron një roman aktual, si të nxjerrë nga thellësia e veprës së Eskilit, por sjell në ditët e sotme dhe frymëmarrjen bashkëkohore romanore, në mënyrë aktuale të ekspozimit të interierëve të indinuar nga historia.

Nëse Eskili kishte propozuar përdorimin e tragjedisë si mjet për të promovuar një model (në frymën e kohës dhe vendit) të të kuptuarit të botës, që përfshinte dashurinë për atdheun ose kultin e virtytit, Zhiti nuk i shmanget linjës eskiliane, por sjell në plan të parë, në vend të tragjedisë së atrisianëve të *Agamemnon-it*, *Hoeforët*, *Eumenidët* dhe *Orestias*, apo vetë kalaja e Mikenës, tragjedia e disa personazheve të shkëputur nga realiteti i një shekulli shtypjeje dhe një rajon jo larg nga verilindja e Peloponezitet.

Në rrëfimin e çiftit Felix Konti - Ema Marku shkruhet tragjedia e një Shqipërie të drobitur nga regjimi komunist. Visar Zhiti na bën të harrojmë se ka pasur dikur, në kohët parahomerike që letërsia bashkëkohore shqiptare (kryesisht Ismail Kadare) shfrytëzon, duke përditësuar hapësira të vjetra dhimbjeje, kalaja mikenase që bashkohet me Trojën dhe e ekspozon Shqipërinë në lakuriqësinë faktike si vendi i tragjedisë, si Atdheu i Absurdit, si Absurdland.

Në një aktakuzë të vonë, personazhi Felix parashtron arsyet e një akuze nga një rast i komunizmit shqiptar që nuk pati shanse në një gjyq në asnjë gjykatë të historisë - i dalë nga vitet e komunizmit venal, personazhi imagjinoi se ai mund të shkojë në Tribunalin e Hagës për të hedhur në gjyq gjithë atdheun - duke theksuar atë që në projeksonin mizor të realitetit të atyre kohërave përkthehet në një tragjedi të panevojshme, të cilën

Romani "Perëndia mbrapsht dhe e dashura" i Visar Zhiti, në rumanisht

## Tragjedia e thekshme që dëgjimi nuk e percepton

Nga Adrian Lesenciu

Në numrin e fundit të revistës dyjavore kombëtare të kulturës "Tribuna", në numrin e fundit të saj, e cila botohet në kryeqendrën e Transilvanisë, në Rumani, Cluj Napoca, është botuar një ese e prof. dr. Adrian Lesenciu për romanin "Perëndia mbrapsht dhe e dashura" e shkrimtarit tonë të mirënjohur Visar Zhiti, botuar në Shtëpinë Botuese A të ALAR-it. Adrian Lesenciu është poet, prozator, kritik letrar, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, filiali Brashovë dhe ka manifestuar një interes të posaçëm për letërsinë shqipe. Libri është përkthyer mjeshtërisht nga Cătălina Frâncu dhe është promovuar në Teatrin Kombëtar "Marin Sorescu" dhe i janë kushtuar disa emisione televizive nga Televizioni Kombëtar i Rumanisë TVR.

perënditë nuk e kishin kërkuar, që fati nuk mund ta shpjegojë dhe që kori i lashtë nuk mund të qetësojë, por përpara të cilit një Europë e shurdhër nuk ka forcë të përkulet:

"...jemi i vetmi vend në botën moderne që ka dënuar jo vetëm njerëzit, por edhe emrat, edhe varret, madje edhe kuajt, pemët, deri dhe fotografitë, thoshte Feliksi, diktatori me gërshtëri i priste, në fillim kokët, pastaj fotografitë e atyre kokëve, ose anasjelltas, gërshtërit janë ende në Muzeun Kombëtar, me bojë të zezë nxinte nëpër fotografitë historike ata që nuk i donte më, jashtë nga albumet, nga kujtesa kolektive [...] (f. 286-287).

Në lexim e sipër, faqet e romanit shndërrohen gradualisht në faqet e aktakuzës së Feliksit, të ekspozuar në një Europë të shurdhër ndaj dramave, në një Europë që tashmë ishte zhveshur nga mitet e mëdha, por veçanërisht nga rrëfimet e mëdha themeltare.

Feliksi bëhet një personazh absurd në

kërkimin e tij donkishotesk për të arritur dy qëllimet e lirimit dhe të gjykimit planetar.

Rrugëtimi i tij europian nis në një Itali të lirë, në Bari, ku ai i kundërvihet dhunës ndaj të ikurve shqiptarë në gadishull Italian, duke nëpërmendur dhe dhunën e hasur tek *La Ciociara*, romanin e njohur të Alberto Moravias.

Dramat e historisë shqiptare po shpalosen si ato mikene, më parë: "Lufta e Dytë Botërore s'ka mbaruar ende për ne, andej në bregun tjetër... ju them unë, dezertori i saj..." (f.30). Brenditë e jetës së tij, përpara se të udhëtonte rrugën nga Bari në Vjenë, të shënuara nga ndalesat dhe shpotitë, megjithëse Feliksi është arsyetari i Shqipërisë, janë shënuar nga pika referimi të qarta, mes tyre vdekja e babait, e dërrmuar nën peshë, e sëmundjes që lindi nga shqetësimi, apo pasqyra e familjes së kohëve të hershme, duke refuzuar të ekspozojë fytyrat e të pranishmëve komunistë:

"Natyrisht fytyrat nuk janë tonat, - kishte thënë një djalë xhaxhai i babit, i liruar nga burgu dhe që erdhi për vizitë fshehurazi një mbrëmje. - Si të të duket jotja fytyra, kur atë ta ka marrë... shteti? Dhe e vendos fytyrën tënde ku të dojë, në rresht, në parakalim, në aksione të detyruara, si tullat në mure fabrikash, ose si tabelë qitjeje në kufi ose e nxin. I heq pjesë, buzëqeshjen, i shkull flokë, krihu kështu, urdhëron, jo këta vathë, i nxjerr njërin sy, të dy, veshët, dhëmbët, tortura, ah! Sa të shkon trishtimi, por nuk lejohet... Ti ta duash pasqyrën, a je i bindur se po të rrefen të vërtetën? Mundohu të kuptosh veten, të ndreqësh çfarë nuk të pëlqen, jo thjesht në fytyrën tënde, por më thellë, në shpirt". - kishte thënë djali i xhaxhait i babit, që, megjithëse s'ishte i vjetër, pinte duhan me llullë. Pas atij tymi shtëllunga-shtëllunga, jo vetëm fjalët e tij, por edhe buzët, nofllat, sidomos vështrimi i rëndë, merrnin mister." (f.72).

Në këtë kuadër të tragjedisë së përgjithshme, të shtetit që shtyp individin, drita e romanit përqendrohet te historia e dashurisë. Fotografi Felix Konti, gjatë viteve të ushtarisë në Shkodër, mbërrin aksidentalisht në sallën e gjyqit dhe, duke qenë i pranishëm në gjyqin e gjimnazistes Ema Marku, me një bukuri, zgjuarsia dhe vendosmëri të paimagjinueshme, arrin ta kapë atë në një foto. Historisë së mungesës së dhimbshme të babait i shtohet, gjysmë shprese, edhe iluzioni i përbushjes përmes dashurisë për Emën. Ema do t'i përgjigjet atij në përputhje me rrethanat.

Të dy pozicionohen kundër sistemit dhe shtypen. Feliksi është kundër sistemit nga mospërshtatja e thjeshtë në politikën diktatoriale që përkthehet me "shtypjen e mendimit", por kundërshtari i vërtetë i regjimit është Ema. Ka një fisnikëri në qëndrimin e saj që përcillet nga familja - duke vizituar burgun ku ishte ajo, gjyshja e Emës do t'i thotë kryerjës: "Dal, tha, vij me e pa, se me kë të rast shof dhe Shqipërinë. Atë të burgjeve dhe vuajtjeve, se Shqipëritë e tjera qenë shembur." (f.192-193) - dhe një vendosmëri për të çrrënjësuar burgun e kthyer si një hapësirë kastrimi (shih kortezhin e grave, f.200) dhe abuzimin seksual.

Duke arritur ta kthejë takimin e rastësishëm në një histori dashurie që digjet nga densiteti i tragjedisë greke, Visar Zhiti ekspozon paralelisht me rrugët e kërkimit europian të heroit të tij, kujtimin e kësaj historie të konsumuar nën dërrmimin e një shoqërie që nuk i kishte zhveshur rrobat e së keqes.

Heronjtë e lidhur me zinxhirë reduktohen në një trup të vetëm. Por dashuria e tyre kushtëzohet nga kontekstualizimi: "Do të më doje ti, po të mos ishte diktaturë? - më pyeti Ema një mëngjes herët me zërin mermëritës, paksa të ngjirur" (f.216), kushtëzohet nga prania e së keqes: "e keqja na bën të kuptojmë më mirë se kush jemi" (f.219). Kontekstualizimi ndodh në një shkallë shumë më të madhe, duke e vendosur historinë në absolutin tragjik, të trashëguar nga Eskili. Vrasja brutale e Emës në post-komunizëm, drama e Feliksit, kërkimi i tij për ta bërë zërin e tij të dëgjohej në një hapësirë të shurdhër ndaj tragjedisë e përforcojnë dramën. Absurditeti i reales turbullohet nga zëri i sistemit: "Ajo që është personale është kolektive dhe ajo kolektive është personale" (f.222), thotë një agjent i Sigurimit. Ka, do të thonë, një risi, të cilën askush nuk mund ta kundërshtojë dhe e reja është trans-sistemike, trans-historike, trans-kulturore. Tragjedia e vërtetë është shurdhim dhe heshtje në dramën njerëzore.

Në atë hapësirë të kalimit përtej, mes shekujsh dhe mijëvjeçarësh, të koloraturës së një kryeqyteti europian, Vjena, ku ndodh tragjedia e vërtetë, lind historia e Visar Zhiti, e cila bëhet në vetvete aktakuza që Feliksi nuk mund ta ekspozojë. Sepse, përfundimisht, personazhi fotograf nuk bën gjë tjetër veçse praktikon atë që në shqip quhet thjesht: "dritëshkronjë" (f.100).

(Përkthimi dhe shënimet Luan Topçiu)





## Hymje

Leva në një kohë kur shumica e të rijve e kishin humbë besimin në Zot, për të njejtën arsye pse prindja e tyre e kishin pasë – pa me e ditë pse. Tevona, tue qenë se shpirti njerëzor prirret natyrshëm me kritikue mbasi ndijon, e jo mbasi mendon, shumica e këtyne të rijve zgjodhën Njerëzimin për ta zavendësue Zotin. I përkas, qyshdoqoftë, njetij lloji të njerëzve që janë prore në zgrip t'asaj ku përkasin, e jo veç shohin shumsinë e asaj që janë, për pa i pá edhe hapësitë e mëdha anepërreth. Për ate as e braktisa Zotin aq haptas si ata, as kurrë nuk e pranova Njerëzimin. Vlerësova se Zot, sado pa gjasë, mund të kish; e meqë mundet, duhet t'adhurohet; kurse Njerëzimi, tue qenë pos një shllim biologjik, e tue mos përfaqësue ma shum se llojin shtazor njerëz, s'ish ma i denjë për adhurim sesa cilido tjetër lloj shtazor. Njiky kult i Njerëzimit, me ritet e tij të Lirisë e Barazisë, m'asht ngja gjithmonë një ringjallje kultesh të motshme, në të cilat shtazët ishin si zota, jase zotat kishin krena shtazësh.

Pra, pa ditë m'e besue Zotin, e tue mos mujtë me e besue një mizëri shtazësh, mbeta, sikur tjerët në zgrip të njerëzisë, në atë largsi ndaj gjithçkasë që të shpeshën quhet Dekadencë. Dekadencia asht humbje e plotë e pavetëdijes; sepse pavetëdija asht themeli i jetës. Zemra, të mendonte, kish me plasë.

Atyne pra, si unë, që jetojnë për pa ditë me pasë jetë, ç'u mbetet, si miqve të mi të paktë, pos mohimit si mënyrë dhe të kundruemit si fat? Tue mos ditë ç'asht jeta fetare, as tue mos mujtë me e ditë, ngase nuk ka besim me arsye; tue mos mujtë me pasë besim në përbashkësinë e njerëzve, as tue mos ditë madje ç'me ba me te, na ka ngelë, si arsye me pasë shpirt, të kundruemit estetik të jetës. Dhe kësisoj, të huej për madhështitë e tana botëve, mospërfillës ndaj hyjnoses dhe përbuzës të njerëzores, i jepemi kot ndijes së paqëllimtë, të përpunue me në epikurizëm të hollë, siç nervave tona trunore u kandet.

Tue ndalë, prej shkencës, pos atë parimin e saj qendror, se gjithçka u nënshtrohet ligjsive fatale, kundër të cilave kurrnjigja nuk vepron pavarësisht, sepse janë ato që na bajnë me veprue; dhe tue vrojtue se si ky parim përkon me tjetrin, ma të vjetër, të fatalitetit hyjnor të gjanave, çojmë duer nga rrekja porsit të ligshët nga ushtrimet trupore, dhe përkulemi përmbi librin e ndjesive me një skrupull të madh ditunimi të ndijuem.

Tue mos marrë gja seriozisht, as tue mos mendue se na asht dhanë, sak, tjetër njimendsi veç asaj të ndijeve që kemi, strehohemi në to dhe i hulumtojmë si t'ishin dhena të panjohun. E, në asht se i përdorim me ngulm, jo sall në kundrimin estetik, po edhe në shprehjen e mënyrave dhe të nxjerrave të tij, asht pse proza e vargu që shkruem, i zdashun dëshire me synue me u mbushë mendjet tjerëve o me u luejtë dëshirat tjerëve, asht si të folunit të madhe t'atij që lexon, ba për t'i dhanë objektivitet të tanë kënaqësisë subjektive të të lexuemit.

E dimë mirë se çdo vepër ka me qenë e papërkryeme, e se ma i pasigurti i kundrimeve tona estetike ka me qenë ai për të cilin shkruem. Por e papërkryeme asht gjithçka: nuk ka perëndim njaq të bukur sa të mos mundet me qenë ma i bukur, asnjë fllad të lehtë që na bjen gjumë sa të mos mundet me na pru një gjumë edhe ma të lehtë. Dhe kështu, kundruet të bjeshkëve e të shtatoreve njilloj, tue i shijue ditët sikurse librat, tue i andërrue të tana, sa për t'i kthye në landën tonë ma të përbrendshme, do të bajmë edhe përshkrime e shqyrtime, të cilat, me t'u krye, do të na huejtohen, gjana që mund t'i shijojmë si të vinin me muzgun.

Ky nuk asht vështrim pesimistësh, si ai i Vigny-t<sup>1</sup>, për të cilin jeta a' burg, ku thur thupra me e shkue kohën. Me qenë pesimist asht me i marrë të tana tragjikisht, e ky asht qëndrim i tepruem e sticim. Nuk i mveshim, njimend, asfarë vlere veprës që e shkruem. E shkruem, njimend, me e shkue kohën, por jo sikur i burguem që thur thuprat mos m'ë kujtue Fatin, po sikur vajza që qëndis nënkresat, me e shkue kohën, jo për tjetër gja.

1 Alfred Victor de Vigny (1797-1863), poet, prozator e dramaturg francez.



## DASHNORI KUNDRUES

nga Fernando Pessoa  
(Fragmente nga "Libri i shqetësisë")

Përktheu nga origjinali: Gazmend Bërlajoli

Jetën e shoh si han ku duhem me ndalue derisa të më vijë karroca e greminës. Nuk di ku do të më çojë, se nuk di kurrë. Mund ta shoh këtë han si burg, mbasi jam i detyruem me pritë në te; mund ta shoh qendër shoknimit, mbasi këtu takoj të tjerë. Nuk jam, megjithatë, as i padurimtë as i zakonitë. Ua lej këtë atyne që mshelen në dhomë, të shtrimë amull në shtrat ku presin pa gjumë; ua lej atyne që kuvendin në dhoma, prej ku muzika dhe zanet u vijnë lirshëm te unë. Ulem te porta dhe i lej sytë me tretë në ngjyrat dhe tingujt e visores, e këndoj butë, veç për vete, kangë të lehta që i kompozoi nësa pres.

Për të tanë ne do të ulet nata dhe karroca do të mbërrijë. Shijoj flladin që m'asht dhanë dhe shpirtin që m'asht dhanë me e shijue, e nuk pyes ma, as kërkoi. Nëse ajo që shkruet në librin e bujtësve do të mundet, e rilexueme një ditë, prej të tjerësh, me i argëtue edhe ata udhës, do t'ish mirë. Nëse s'e lexojnë, ose nuk argëtohen, prap shumë mirë.

\*

DASHNORI KUNDRUES (I)  
Anteros

Për dashninë e thellë dhe përdorimin e dobishëm të saj kam veç shllim sipërfaqësor e stolisës. Unë u nënshtrohem afsheve të kundrimit. Por të pacikun e mbaj zemrën, dhanë fateve ma të paqena.

Nuk mbaj mend t'ia kem dashunue pos «pikturën» kujt, të jashtmen vetë – ku shpirti s'futet për gja, veç që këtë të jashtme me e ba të lëvizshme e të gjallë – e kësisoj të ndryshme nga pikturat që i bajnë piktorët.

Kështu dashunoi: ia qep sytë një figure të bukur, tërheqëse, ose tjetërqysh të kandshme, të femnës a të mashkullit – ku nuk ka as epsh, as ka parapëlqim gjinie – e kjo figurë më josh, më ban zap, shqim më kaplon. Asgjamangut, nuk due ma veçse me e kundruet, as shoh gja ma me lemeri sesa mundsinë me mbërritë me e njohë e me i folë vetjes së njimenditë që kjo figurë me gjasë e shplon.

Dashunoi me sy, jo me fytyrim. Sepse për atë figurë nuk fytyroj gja që të më mbërthëjë. Nuk e paramendoj veten tjetrazi të lidhun me te, se dashnia ime sigurisht s'ka ma ç'me thanë. S'më zgjon kureshtjen me ditë kush asht, çka ban, ç'mendon krijesa që më jep me i pa dukën e jashtme.

Vargje e vistra njerëzish e gjanash që sajojnë botën më janë një galeri e pasosshme pikturash, mbrendia e të cilave nuk më intereson. Nuk më intereson, se shpirti asht monoton e gjithëherë i njejtë në të tanë njerëzit; i dallojnë veç paraqitjet vetanake, e ma e mira e tij asht ajo që derdhet në andërr, në sjellje, në gjeste, e kësisoj hyn në pikturën që më rrëmben, e në të cilën i kundroj fytyrat besnike të këtij dashunimi.

Për mue krijesa nuk ka shpirt. Shpirti asht i vetvetes veç.

Kësodore e vetëjetoj, pos tue kundruet, dukjen e lëvizun të gjanave e të qenieve, mospërfillës, si zot nga tjetër botë, ndaj përbamjes – shpirtit të tyre. Thellohem sall në sipërfaqe të vetë qenies, e kur mallëngjehem për thellim, në vetvete e në shllimet e mia për gjanat e kërkoi.

E ç'mundet me më pru njohja personale e krijesës që e dashunoi njëkështu si stoli? Zhgënjim jo, meqë, tue mos i dashunue pos dukjen, e tue mos fantazue gja për te, marria a mediokriteti i saj nuk i heqin gja, se nuk kam pritë tjetër veç dukjes, të cilën s'kisha ç'me e pritë, e dukja të ngulitet. Po njohja personale asht e damshme se asht e kotë, e gjasendi i kotë gjithnji i damshëm asht. Me i ditë emnin krijesës për se? E prap, asht e para gja që, me t'u njohë me te, e mësoj.

Njohja personale vyen me qenë, gjithashtu, liri për të zhbirulue, gja që lloji im i të dashunuemit e lyp. S'mund t'i sodisim, t'i zhbirulojmë lirshëm ata që i njohim personalisht.

Ç'asht e tepërt asht ma e paktë për artistin, ngase, tue e trazue, e zvogëlon ndikimin. Shorti im i natyrshëm prej vrojtësi të paprajshëm e të ftigtë të dukjeve e paraqitjeve të gjanave – objektivit i andrave, dashnor kundruet i trajtave dhe pamjeve të natyrës □

S'kam të baj me atë që psikiatrit i thonë onanizëm psikik, as me atë që i thonë erotomani. Nuk fytyroj, si në onanizëm psikik; nuk shoh andërr se jam dashnor trupor, e as shok kuvendesh bile, i krijesës që ia ngul sytë e e mbaj në mend: kurrë soje nuk fytyroj. As, si erotomanët, nuk e idealizoj a mbart tej sferës së estetikës së mirëfilltë: nuk i due, as i mendoj përtej se m'u jep syve dhe mbamendjes së drejtpërdrejtë e të kthjellët t'asaj që sytë kanë pa.

\*

15.9.1931, botue më 1931

Re... Jam sot i vetëdijshëm për qiellin, mbasi ka ditë kur nuk e shikoj, por e ndiej, tue jetue në qytet dhe jo në natyrën ku ai përmbahet. Re... Janë sot njimendësia kryesore dhe më brejnë sikur zyrtimi i qiellit të m'i ishte ndër ma të mëdhajat rreziqe fatit. Re... Rendi nga grykëderdhja në Kështjellë, nga perëndimi në lindje, me një trazim të hapërdamë e të zdashun, të bardha herëherë, nëse të rreckosuna rendin në pararoje të kumeditë çkasë; gjysëm të zeza tjerat, nëse, ma të ngeshme, vonohen, për t'u fshi nga era fërfëlluese; të zeza me të bardhë të përlyeme, nëse, as me dashtë me ndalue, e vranësojnë ma shum me avitje sesa me hije ate që rrugët e çelin si hapësinë të rreme ndërmjet ngrhinave përmselëse të shtëpive.

2 fjala në frangjisht në tekstin original - décor

Re... Ekzistoj pa e ditë dhe do të vdes pa dashtë. Jam ndërmjetësia mes asaj që jam dhe asaj që nuk jam, mes asaj që androoj dhe asaj që jeta më bani, mesatarja e palandët edhe trupore mes gjanash që s'janë kurrëgja, as unë tue mos qenë kurrëgja. Re... Sa shqetësi po ndijova, sa siklet po mendova, sa kotsi po dëshrova! Re... Ato përherë kalojnë, do-do ma se të mëdha, dhe duket, (mbasi shtëpitë nuk po lejnë me pa në janë ma pak të mëdha se ç'duken) se duen me e zaptue krejt qiellin; të tjera përmasash të paqarta, munden me qenë dy ngjitë ose një që do të ndahet dysh, të paudha ajrisë së naltë kundruell qiellit të kapitun; e do të tjera, të vogla, duken lodra gjasendesh të fuqishme, topa të çrregullt loje të përçudshme, sall në një anë, në veçim të plotë, të ftohta.

Re... Më pyes por nuk më njoh. Kurrëgja s'kam ba të dobishme as sdo të baj gja t'arsyetueshme. E kam shpenzue pjesën e jetës që nuk e bora në çanësimin e hutueshëm të kurrëgjeve, tue u thurë vargje në prozë ndijeve të pakumtueshme me të cilat e baj timen gjithësinë e panjohun. M'asht ndye vetvetja, objektivisht e subjektivisht. M'asht ndye gjithçka, dhe gjithçkaja e gjithçkasë. Re... Janë gjithçka, nxjerra të naltësive, të vetmet gjana të vërteta sot anames tokës së patokë dhe qiellit të paqenë; rreca të papërshkrueshme të mërziisë që ua ngarkoj; mjegull e langëzue me në kanosje ngjyrash të mungueme; pufka të pista pamuku të një spitali pa mure. Re... Janë sikurse unë, një shteg i shkëputun midis qiellit edhe tokës, nën mëshirën e ndonji hovi të padukshëm, tue vetue o tue mos vetue, tue gazmue të bardha e tue u mrrolë të zeza, trille të ndërkohës e të rravgimit, larg zhurmave të tokës e pa me e pasë qetësinë e qiellit. Re... Vazhdojnë me kalue, vazhdojnë përherë tue kalue, do të kalojnë përherë tue vazhduet, në pëshqjelljen me ndërpreme të lamshit ngjyrëzbehtë, në zgjatimin e shkriftit të të rrejshmit qiell të shpërbamë.

\*

Rilexoj qartas, shtruet, pak nga pak, krejt ç'kam shkruetë. Dhe vërej se janë krejt kot dhe se kish me qenë ma mirë sikur fare të mos i kisha shkruetë. Gjanat e arrituna, perandori a fjali qofshin, përmbajnë, tue qenë t'arrituna, njetë ma të keqen e gjanave reale – dijeninë tonë se zhbahen. Po nuk asht kjo, megjithatë, ajo çka ndiej e që më dhemb për ato sa i kam ba, tek ngeshëm i rilexoj. Më dhemb që s'ia ka vlejte barra qiranë, dhe se nga kohë e humbun për t'i shkruetë, s'kam përfitue gja veç vetëmashtrimit, tashma të shuem, se ia paskish vlejte me i shkruetë.

Çkado që kërkujmë, e kërkujmë për një ambicie, po kjo ambicie, o nuk arrihet, e na len të vobektë, o mejtujmë se e kemi arritë, e kthehemi thjesht në pasanikë të rrokutun.

Më dhemb edhe ma të mirat pjesë janë të këqija, e se tjetri, të ekzistonte, e që unë e androoj, do t'i kish ba ma mirë. Gjithë ç'bajmë, në art a në jetë, asht kopje e mangët e asaj që duem me e ba. E mohon jo veç përsosjen e jashtme, po edhe përsosjen e mbrendshme; i mungojnë jo veç rregullat si do të duhej me qenë, po edhe rregullat që të vlerësojmë si do të mundej me qenë. Jemi të zbrazët, jo veç përjashta, po edhe përmbrenda, të leçitun të pritisje e të premtimit.

Me ç'stithi të shpirtit vetmitar shkruetja faqe mbas faqes së vetmueme, tue e jetue rrokje për rrokje magjinë e rreme, jo të asaj që kisha shkruetë, po të asaj që pandehja ta kisha shkruetë! Nga ç'shitim shtrignie ironike e kujtova veten për poet të prozës sime, në vrik të çastit kur m'u ngjall, ma e shpejtë se lëvizjet e lapsit, porsit hakmarrje dredhake ndaj poshtnimeve të jetës!

Së mbrami, sot, tue rilexue, shoh të më dërrmohen kukullat, t'u dalë kashta prej gavrash, të zbrazen kurrë pa pasë qenë...

\*

Krejt më shlyhen. E tanë jeta, kujtimet, fytyrësimi me përmbajtjet e tij, krejt më shlyhen. Vazhdimisht mendoj se kam qenë tjetër, se jam ndie tjetër, se kam mendue tjetër. Kjo që e kqyr asht një shfaqje realizue me pamje tjetër. E ky që e kqyr jam vetë.

Gjej herë-herë, në tollovinë e sirtarëve të mi letrarë, fletë që i kam shkruetë para



dhetë, pesëmbëdhjetë, a ma shumë vjetësh. Shum prej tyre më duken të tjerakujt; s'më njoh ma në to. Dikush i kishte shkruajtë, e ai isha unë. Unë i pata ndijue, po në ndoj tjetër jetë, nga e cila tashti u zgjova si nga andërr e tjetërkuajt.

Shpesh gjej gjana që i kam shkruajtë tue qenë fort i ri – fletë të hartueme kur kam qenë shtatëmbëdhjetë a njëzet vjeç. E do prej tyre kanë një fuqi shprehëse që s'më kujtohet ta kem pasë në atë moshë. Ka do fjali e fragmente të shkrueme sapo kisha ba hapat e parë prej adoleshence, që më bahen se janë fryt i atij që jam sot, shkollue prej motmotesh e sendesh. E kuptoj se qenkam sikur kisha qenë. Tue pasë ndie se sot kam përparue goxha prej ç'kam qenë, pyetem ku asht përparimi, në asht se atëbotë paskam qenë i njejtë me ç'jam sot.

Ka në krejt këtë një msheftësi që më përlu e më bren.

Sall para do ditësh, u tranda mahnie me një shkrim të shkurtë që kisha pasë ba dikur. Më kujtohet fort mirë se ky skrupull i imi, të paktën i pjesshëm, ndaj gjuhës, daton prej pak vjetësh. E hasa në sirtar në këtë shkrim timin, shumë ma të motshëm, ku ky i njejtë skrupull ish fort i theksuem. S'e paskisha kuptue veten pozitivisht në të kaluemen.

Qysh paskam përparue drejt asaj që paskisha qenë? Qysh m'e njohë veten sot kur s'e njihja dje? Tanë kjo më tollovit në një labirinth ku, me mue, përhumbem prej vetes.

Tretem në mendime, dhe jam i sigurtë se këtë që po e shkruaj, e kam shkruajtë tashma. Më kujtohet. Dhe e pyes atë që mbrenda meje pandeh me qenë, a nuk ka në platonizmin e ndijue ndonji tejkujtesë ma depërthuese, tjetër mbamendje të jetës së këntunijshme, që mezi asht e njëkësaj jete...

O Zoti im, o Zot, kë po vështroj? Sa jam? Kush asht unë? Ç'asht kjo hapësi mes meje dhe meje?

Qielli i zi teandej kah jugu i Tagut ishte ogurzishti i zi përkundrejt flatrave, për kundërshti, zbritshëm të bardha të pulëbardhave në flattrim të trazuem. Dita, qyshdoqoftë, me shtrëngatë ma s'ish. E gjithë masa e kanosjes së shiut kishte vojte përmatanë tjetrit breg, e qyteti i ulët, ende i lagësht prej ç'kish reshë, i buzëgazej prej platforme një qielli, të cilit veriu po i kaltërsohej, ende bardhazi këtu-aty. Fresku i pranverës ish një fice i ftohtë.

Në kohë si kjo, boshe e të paparashikueshme, sa më kandet me e drejtue mendimin vullnetshëm kah një meditim që të jetë kurrnjigja, po që të përmbajë, në hiçin e vet të kulluet, një diçka nga të ftohtit vetmitar të ditës së kthjellueme, me sfondin e zi në largësi, dhe ndosa vrojtime – cok si pulëbardhat – që ndërmendin për kundërshti misterin e gjithçkasë në zezni të thellë.

Por, sakaq, përkundër synimit tim letrar ma të përbrendshëm, sfondi i zi i qiellit në jug ma ndërmend, nëpërmjet kujtimeve a të njimendta a të rreme, një tjetër qiell, me gjasë pá në tjetër jetë, në njëfarë veriu lumi të vockël, krejt me do kallame të trishta e pa qytet kund. Pa marrë vesh tek a qysh, një visore për pata të egra më shpalohej në përfytyrime, e me qartësinë e një andrre të rrallë ndjehem krejt ngjat hapësinës që e fytyroj.

Kallamishte anës lumejve, terren për gjahtarë e ankthe; ledhet e çrregullta i zhyten, porsi kepa të vegjël të llangosun, n'ujnat ngjyre të verdhë të plumbtë, e lakohen nëpër gji të lytmë, për barka gati sa lodra, në brigje që kanë ujë me ia vizëllue syprinën baltës së mshefuen mes kërcëjeve të blertë e të zij të kallameve, kah nuk shkelet dot.

Asht një të shkretuem qielli të murrëte të vdekun, rruhdë tek-tuk në re ma të zeza se qielli vetë. Erë nuk ndej, por ka, e tjetra anë del se a' një ujëdhësë e zgjatun, përmbraja të cilës venerohet – lum i madh i braktisun! – tjetri breg i vërtetë, shtri në largësinë e padallueshme.

Kush atje shkelë s'ka, as me shkelë nuk ka. Edhe sikur, me farë të ikuni kundërshtues të kohës e të hapësinës, unë të mundesha me u arratisë bote për te ajo visore, kurrë kurrkush atje me shkelë s'kish. Kisha me e pritë kot njate që s'do të dija se

po e prisja, e nuk do të kish, krejt në fund, veç një të lëshuemi të ngadalte nate, e tanë hapësinë tue e marrë, ngadalalalë, ngjyrën e reve ma të zeza, që pak e pak do të treteshin në tanësinë e qiellit të shuem.

Prejnijherë, të ftohtit prej atje e ndej njikëtu. Ma ngjeth mishin, në palcë më hyn. Marr frymë thellë e përmendem. Njani, me të cilin kryqëzohemi nën Harknajë mu te Bursa, më kqyr me mosbesimin e atij që nuk din me spjegue. Qielli i zi, tue u tkurrë, asht ulë edhe ma kah jugu.

\*

25 prill 1930

Po meditoja sot, në një pushim prej ndijmësh, për trajtën e prozës që shkruaj. Me gjithë mend, si shkruaj? Kam pasë, siç kanë pasë të shumtë, një djegë perverse për ta pasë një sistem e një normë. Po dihet se kam shkruajtë pa pasë normë a sistem; po në këtë, qyshdoqoftë, nuk jam ndryshe prej tjerësh.

Tue më analizue këtë mbasdite, zbulova se sistemi i stilit m'u mbështetka në dy parime, prandaj fill, mbas shprehisë së mirë të klasikëve të mirë, i naltova këto dy parime në shtylla të përgjithshme të tanë stilit: 1. me thanë njatë që ndjehet cok njashtu si ndjehet – qartas, në asht e qartë; çuditshëm, në asht e çuditshme; koklavitshëm, në asht e koklavitun; 2. me kuptue se gramatika asht vegël, e jo ligj.

Po e zamë se shohim para nesh një vajzë me sjellje mashkulli. Një qenie e zakonshme njerëzore kish me thanë: «Njajo vajzë qenka si djalë». Një tjetër qenie e zakonshme njerëzore, po ma afër vetëdijes se me folë asht me thanë, kish me thanë: «Njajo vajzë qenka djalë». Ndonji tjetër, po i vetëdijshëm për detyrimet e të shprehunit, po ma i prekun nga dashja për t'u shprehë ngjeshun, e që asht afshi i të menduemit, kish me thanë: «Njai djalë». Unë kisha me thanë: «Njajo djalë», tue e thye ma themeloren e rregullave gramatikore, që kërkon pëlqimin e

gjinisë, sikurse të numrit, ndërmjet përmnit e emnit. Kisha me e thanë mirë; kisha me folë tanësisht, fotografikisht, përtej të zakonës, normës, të përditshmes. S'kisha me folë; kisha me thanë.

Gramatika, tue i përcaktue rregullat, ban ndamje të përligjuna e të rreme. I ndan, po e zamë, foljet në kalimtare dhe jokalmimtare; megjithëqë, njeriut që din me folë, shpeshherë i duhet m'e kthye foljen kalimtare në jokalmimtare për m'e fotografue atë që ndjen, e jo, sikur kafshët e rëndomta njerëzore, me e pa në terr. Ba me dashtë me thanë se ekzistoj, kisha me thanë «Jam». Ba me dashtë me thanë se ekzistoj si shpirt më vete, kisha me thanë «Jam unë». Por me ba me dashtë me thanë se ekzistoj si tanësi që njëherazi vetëprijhet e formësohet, e që ushtron krahas detyrë hyjnore për me u krijue, si mundem me përdorë foljen «me qenë» për pa e ba përnijherë kalimtare? E atëherë, ngadhnyeshëm, zhgramatikisht kulmueshëm, kisha me thanë: «Më jam». Kisha m'e thanë një filozofi në dy fjali të vockla. A s'asht ma e pëlqeshme kjo sesa mos me thanë gja në katërdhetë fjali? Ç'më u pritë ma shumë nga filozofia e gjuha?

Le t'i bindet gramatikës kush nuk din me e mendue atë që ndjen. E le t'i shërbejë atij që din me e urdhnuet ndër shprehje të veta. Thuhet për Sigismundin,<sup>3</sup> mbret i Romës, se mbasi paskish ba, në fjalim publik, një gabim gramatikor, iu paskish gjegjë njatij që ia kish qortue: «Jam regj i Romës, prandaj sipër gramatikës». E historia thotë se u ba i njohun mbaskëndej si Sigismund «*super-grammaticam*». Simbol i mrekullueshëm! Çdo njeri që din me thanë ç'ka me thanë, asht, në mënyrën e vet, mbret i Romës. Titulli nuk asht i keq, e shpirti i tij asht me u qenë.<sup>4</sup>

\*

<sup>3</sup> Me gjasë, i referohet Sigismundit, Perandorit të Romës së Shejtë në periudhën 1433-1437

<sup>4</sup> variant: Titulli asht mbretor e arsyeja e titullit [...]

1 dhetor 1931

Pata sot, krejt gand, një ndije të çuditshme e të drejtpërdrejtë. E kuptova, nga një shkretimë e përbrendshme, se s'jam kurrkushi. Kurrkushi, bash kurrkushi. Kur më shkretiu kjo vetimë, ajo që e kujtoja qytet më doli fushë, e shkretueme; e drita e mnershme që ma tregoi veten time, qiell nuk shfaq sipër saj. Më asht vjedhë mundësia me qenë ma parë se t'ish bota. Me u pasë ringjallë, do t'isha ringjallë pa mue, pa qenë unë i ringjallun.

Jam rrethina e një qyteti të paqenë, parathania e mërztishme e një libri të pashkruem. S'jam kurrkushi, kurrkushi. Nuk di me ndijue, nuk di me mendue, nuk di me dashtë. Jam personazh i romanit ende të pashkruem, jam pezull në ajri, i zhamë pa pasë qenë, midis andrrave t'atij që nuk diti me më tanësue.<sup>5</sup>

Përherë mendoj, përherë ndej; por mendimet nuk më përmbajnë arsye, ndijet ndjenja nuk më kanë. Jam rrëzue, nga ai kataraf njaty nalt, nëpër tanë hapësinën e pafundme, në ramje pa kahje, të pafundfishtë<sup>6</sup> e të zbrazët. Shpirti masht shakullinë e zezë, marramendje gjigante që sillet në vakuum, lëvizje e një oqeani të paanë përreth gavrës së kurrjasë, e nëpër ujna, që ma janë sillje sesa ujna, lundrojnë gjithë pamjet e ç'kam pa e ndie në botë – shtëpi, fytyra, libra, arka, copëza muzike e rrokje zanesh, në një vorbull të mnershme pa mbarim.

E unë, pikërisht unë, jam qendra që nuk asht, e dalë pos nga gjeometri e humnerës; jam hiçi rreth të cilit kjo lëvizje sillet, e veç pse sillet, i jam qendra që ekziston pos pse çdo rreth një e ka. Unë, pikërisht unë, jam pusi pa mure, po me ngurtësi muresh, qendra e të tanave me kurrngjanë përreth.

E, në mue, as me qenë vetë ferri tue qeshë, po pa ngjasimin njerëzor të djajve tue qeshë, ka një trenim gargaritës të gjithësisë së vdekun, kufomë rrotulluese të hapësinës fizike, fund të të tana botëve tue fërfëllue zishëm nëpër erë, të shkapërdamë e të pakohshëm, pa Zot që do ta ketë krijue, pa vetveten që sillet në terrin e terreve, të pamundshëm, të vetëm e të pashoq, të tanë.

Me mujtë me ditë me mendue! Me mujtë me ditë me ndijue!

Nana më vdiq shumë herët, e nuk mbërta as me e njohë...

\*

24 mars 1930

I rilexoj në amulli, tue e ndijue njate që e vetëjetoj si frymëzim e shlirim, ato vargje të thjeshta të Caeiro-s, rrjedhë e natyrshme dalë nga vogëlsia e katundit të vet. Prej tij, thotë ai, ma mundet me u pa botë se prej qytetit; e për këte katundi asht ma i madh sesa qyteti...

«Se kam përmasat e asaj që shoh s'më mbërthejnë përmasat e shtatit»

Vargjet e kështushme, që ngazëllejnë për pa u dashtë me u recitue, më spastrojnë nga metafizika që vetiu ia mvësh jetës. Mbasi t'i kem lexue, avitem te dritarja që kqyr kah rruga e ngushtë, e kundroj paanësinë qiellore e plymsinë e yjeve, dhe jam i lirë me shkëlqim të flatruem, drithëtima e të cilit ma rrënoqeth krejt kurmin.

«Kam përmasat e asaj që shoh!» Sa herë e kujtoj këtë varg me tanë vëmendjen e nervave, më bahet ma i denjë m'e rryzue krejt gjithësinë. «Kam përmasat e asaj që shoh!» Ç'pasuni e madhe mendore shtjellat që nga pusi i ndijeve të thella e deri te yzjit e largët që në te pasqyrohen, e që kështu, njëfarësoj, janë në te.

Dhe qe tashti, i vetëdijesuem se di me pa, e vrojtoj metafizikën e gjanë objektive të tanë qiellit me një siguri që ma ngjall dëshirën me vdekë tue këndue. «Kam përmasat e asaj që shoh!» Dhe hanimi i zbehtë, krejt i imi, me zbehtësinë e vet nis m'e zbutë kaltërsinë e mugëtue me horizontit.

Ndej dëshirë me i çue duert e me britë gjana egërsie të pandieme, fjali me u thanë msheftësive të nalta, me i pohue një agor të ri, vigan, hapësisë së paanë të landës së

<sup>5</sup> me më formësue

<sup>6</sup> Pessoa këtu shpik neologjizmin *infinitu*, të cilin e formon prej fjalëve *infinita* dhe *multipla* (e pafund dhe e shumfishtë)





zbrazët.

Mirëpo përmbledhem e qetohem. «Kam përmasat e asaj që shoh!»! Ky varg më bahet shpirti i tanë, mbështes në te krejt ndjenjat që ndjej, e mbi mue, përmbrenda, si mbi qytetin përjashtë, lëshohet paqja e pazbërthyeshme e hanimit të fortë që shtrihet gjatë përmbi muzgun që po erret.

\*

Ndjehem herë-herë, nuk di pse, i prekun nga një parathanie e vdekjes... qoftë kjo nga ndoj sëmundje e zbehtë, që nuk asht landëzue në dhimbë dhe pranë shpirtëzohet së fundmi, qoftë nga ndoj kapitje që kërkon gjumë aq të thellë sa të fjetunit vetë mos me i mjaftue – ajo që e di asht se ndjehem pors i sëmuni që, në fund të keqësimit, së mbrami qetas e pa pendesë i lëshon duert e plogështa jashta butësisë së shtratit.

Pyes atëherë ç'është njajo që i thomë vdekje. Nuk po mendoj e mshefta e vdekjes, të cilës nuk mund t'i futem, porse ndija fizike e shuemjes së jetës. Njerëzimi i friget vdekjes, porse paqartësisht; njeriu i thjeshtë, del mirë n'ushtrime, njeriu i thjeshtë, kur sëmunet a plaket, rrallëherë e shikon i tmerruem greminën e hiçit, të cilin, sido me qenë, ia njuh kësj greminë. E tanë kjo asht mungesë fytyrësimi. As ka gja ma të kotë me mendue sesa me e kujtue vdekjen gjumë. Pse kish me qenë, nëse vdekja nuk i ngjan gjumit? Ma qenësorja e gjumit asht se zgjohemi prej tij, kurse prej vdekjes, pandehim, nuk ka zgjim. E sikur vdekja t'i ngjante gjumit, duhet ta kishim parandijen e zgjimit prej saj. Nuk asht kjo, megjithatë, ajo që njeriu i rëndomtë kujton: ai e kujton vdekjen gjumë prej të cilit nuk zgjohet, gja që nuk ka kuptim. Vdekja, thashë, nuk i ngjan gjumit, mbasi në gjumë je i gjallë e i fjetun; as nuk di si mundet dikush t'ia përngajë vdekjen diçkasë, tue mos pasë as përvojë të saj, as me se ta krahasojë.

Për vete, gjithasaherë shoh ndonji të vdekun, vdekja më ngjajet largim. Kufoma më jep përshtypjen e rrobave të zdashuna. Dikush asht largue dhe s'ka pasë nevojë me e marrë veshjen e vetme që ka pasë veshë.

\*

Hyna te berberi si zakonisht, me njetë kënaqësinë e të hymit lehtësisht e pa ndrojtje vendeve të njohuna. Ndjeshmëninë ndaj risisë e kam t'ankthshme: i qetë jam veç ku tashma kam qenë.

Sa u lëshova në ulëse, e pyeta, mbasi m'u kujtue gand, çunin berber që po ma vinte rreth qafe një cohë të freskët e të pastër, si e ka pasë kolegun këndej kah ulësja e djathtë, ma i motshëm e tanë gjallni, që ka pasë qenë sëmutë. E pyeta pa e ndie detyrimin me pyetë: më ra në mend prej vetë rrojtores e kujtesës. «Vdiq dje!», u gjegj zani pa ngjyrë që ish mbrapa meje e peshqirit, të cilin gishtat po i hiqeshin prej ndërfutjeve të mbrama në qafë, mes meje e jakës. E gjithë qejflesja e paarsyeshme më vdiq përnjirend, sikur berberi përjetësisht i munguem i ulëses përbri. Bante ftohtë në gjithçka që po mendoja. Nuk thashë kurrëgj.

Përmallime! I ndjej madje edhe për kend s'e kisha kurrëgj, prej farë angështie për ikjen e kohës e n'jfarë sëmundjeje për tinëzinë e jetës. Fytyrat që i shihja rëndom rrugëve të mia të rëndomta – në mos i pafsha ma, trishohem; e s'i kam pasë asnjigja, përpos simbol të mbarë jetës.

Plaku i tërhequn me gjunjake të pista me të cilin kryqëzohesha shpesh në nantë e gjysë të mjezitet? Shitësi i çalë i biletave të llotarisë që më bezdiste kot e kot? Plakushi rrondokop e faqekuq që tymoste te pragu i duhantores? Pronari fytyrëzverdun i duhantores? Ç'bahet me tanë këta, që, mbasi i kam pa dhe vazhdoj t'i shoh, më janë ba pjesë e jetës? Nesër edhe unë kam me u zhdukë nga Rua da Prata, Rua dos Douradores, Rua dos Fanqueiros. Nesër edhe unë – shpirti që ndjen e mendon, gjithësia që jam për vetveten – po, nesër edhe unë kam me qenë ai që reshti së ecuni këtyne rrugëve, ai që të tjerët zbehtas e ndërmen-din me një «A thue mor ç'u ba?». Tanë ç'bah, tanë ç'ndej, tanë ç'jetoj, s'ka me qenë veçse një kalimtar ma pak në përditën e rrugëve të një aksh qyteti.

«Shihemi në gusht» është një roman Si botuar pas vdekjes së Gabriel García Márquez-it, një prej shkrimtarëve më të admiruar të shekullit njëzet, veprat e të cilit kanë mbërthyer miliona lexues anembanë botës. Ky roman vjen si një dhuratë e papritur nga laureati kolumbian i Nobelit, një dekadë pas vdekjes së tij, dhe vazhdon të magjepsë me përzjerjen e realizmit magjik me humanizmin e thellë.

«Shihemi në gusht» sjell një rrëfim intim dhe gjithëpërfshirës. Subjekti prek problemet e dashurisë, dëshirave dhe bashkëveprimin e padukshëm ndërmjet realitetit dhe fantazisë, tematika që e kanë mahitur gjithnjë shkrimtarin. Në këtë rrëfim, García Márquez analizon thellësitë e emocionit njerëzor dhe lidhjet e ndërlikuara që na çojnë drejt njëri-tjetrit dhe drejt së shkuarës.

Ngjarja kryesore në romanin «Shihemi në gusht», flet për një takim në dukje të thjeshtë, i cili zbulon dalëngadalë shtresa të thellësisë emocionale dhe të njohurive filozofike. Aftësia e García Márquez-it për ta bërë të zakonshmen të jashtëzakonshme, shkëlqen teksa ai zhytet në jetët e personazheve të tij, duke zbuluar peizazhe të gjera të botëve të tyre të brendshme. Ky roman është dëshmi e aftësisë së tij të pasohet për të ndërtuar ngjarje të cilat jehojnë të vërteta universale, por që njëkohësisht janë të rrënjësura në detajet e vendit dhe të kohës.

Proza e García Márquez-it në romanin «Shihemi në gusht» është, si gjithmonë, e pasur dhe e gjallë. Çdo fjali ka jetë dhe ndërthur një panoramë të gjerë të imazheve dhe emocioneve, të cilat e çojnë lexuesin në një botë ku mrekullia e realja bashkekzistojnë. Përdorimi i realizmit magjik në këtë vepër është i padukshëm e njëkohësisht intensiv, duke theksuar nocionin se magjika nuk është arratisje nga realiteti, por një përfshirje më e thellë brenda tij.

Botimi i romanit «Shihemi në gusht» nuk është thjesht një ngjarje letrare, por një moment kulturor që ripohon trashëgiminë jetëgjatë të García Márquez-it. Veprat e tij kanë qenë gjithmonë më shumë sesa ngjarje. Ato janë entitete plot energji e të gjalla, që sfidojnë dhe ripërcaktojnë kuptimin tonë të artit të rrëfimit. Ky roman, ashtu si kryeveprat e tjera të tij, fton lexuesit të mendojnë për misteret e jetës dhe fuqinë e rrëfimit për të hedhur dritë mbi to.

«Shihemi në gusht» shërben gjithashtu si një kujtesë prekëse e shqetësimeve tematike të García Márquez-it: këmbëngulja e kujtesës, dhimbja e humbjes dhe potenciali shpëtues i dashurisë. Përmes faqeve të këtij romani, përballemi me personazhe që luftojnë me peripecitë e fatit, me dëshirat dhe frikërat e tyre të paraqitura me një qartësi të dhembshur, gjë që është tipar dallues i stilit të García Márquez-it.

Në një botë të dominuar gjithnjë e më shumë nga vëmendja e kufizuar dhe lidhjet sipërfaqësore, romani «Shihemi në gusht» ofron një strehë reflektimi. Na nxit të ngadalësojmë, të shijojmë

## JEHONAT E PËRJETËSISË: zbulimi i magjisë në romanin «Shihemi në gusht»

Nga Manuel Marino

Përktheu David Hudhri


bukurinë e gjuhës dhe të mendojmë për misteret e pazbuluara të zemrës njerëzore. Vepra e García Márquez-it na fton ta shohim botën jo ashtu siç është, por ashtu siç mund të jetë, e mbushur me habi, shpresë dhe magji.

Për ata që nuk e njohin García Márquez-in, «Shihemi në gusht» është një hyrje e përsosur në veprën e tij. Ky roman përmbledh shqetësimet e tij tematike dhe gjeninë stilistike, në një formë kompakte. Kurse për admiruesit e tij, sjell sërish gëzimin e leximit të veprës së tij, duke sjellë njohuri të reja dhe kënaqësinë e ribashkimit me një mik të vjetër.

«Shihemi në gusht» është më shumë se një kryevepër letrare. Është një urë që lidh të shkuarën me të tashmen, shkrimtarin me lexuesin e tij, realitetin me imagjinatën. Në këto faqe, Gabriel



García Márquez vërteton sërish se pse konsiderohet një nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës sonë. Ky roman është një shtesë e ndritshme për veprën e tij, një fener për ata që besojnë në fuqinë transformuese të letërsisë.





BASHKIM HOXHA

Dëshmitari  
i  
shkretëtirës

Onufri Roman

